Q3.01 O1. Shërbime të deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre.

Është realizuar në vazhdimësi prodhimi i dokumentave në shërbim të qytetarëve dhe mbështetja e funksionimit të Gjendjes Civile përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Realizimi i buxhetit të planifikuar:


| Programi 01110 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | 000/leke |
|-------------------|--------------------|------------------------|------------|-----------|----------|
| | | | | | Totali |
| PBA 2023 | 280,673 | 57,746 | 5,516 | 14,100 | 358,035 |

| | | | | | |
|------------------------|---------|---------|--------|--------|---------|
| Plani fillestar 2023 | 363,556 | 101,082 | 11,933 | 16,357 | 492,928 |
| Plani i rishikuar 2023 | 366,060 | 93,434 | 9,190 | 18,593 | 487,277 |
| Realizimi viti 2023 | 161,901 | 33,638 | 4,436 | 12,437 | 212,412 |
| % e realizimit | 44.2% | 36.0% | 48.3% | 66.9% | 43.6% |



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 43.6 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|--------------------|-------|
| Shpenzime korente | 42.7% |
| Shpenzime kapitale | 66.9% |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e disa fondeve të planifikuara:

Faktor kryesor janë edhe fondet e trashëguara nga vitet e kaluara, të cilat kanë rritur planin e vitit 2023 , pjesa tjetër janë parashikuar të realizohen gjatë vitit.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 8 Mujori 2023

| Kodi i Programit | 1110 | Emertimi i programit: | Planifikim, menaxhim dhe administrim | | | | | | Komente |
|------------------|---|--|--|----------------------------------|--------------------------------------|------------------------------------|---|---|---------|
| Qellimi 1 | Përfshirja e qytetarëve, grupeve të interesit, komunitetit në përgjithësi, në proceset vendimmarrëse me qëllim krijimin ose përmirësimin e politikave publike, procedurave dhe praktikave lokale në favor të krijimit mirëqenies së qytetarëve. | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| | *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhës | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli i faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| Objektivi 1.1 | Organe përfaqësuese vendore të mbështetura për funksionimin e tyre. | | | | | | | | |
| | | 1 | Vendimarrje bashkiake e konsultuar me publikun. Numri i konsultimeve të realizuara kundrejt totalit te vendimeve për të cilat konsultimi parashikohet me ligj (në %) | 417% | 167% | 167% | 167% | 100% | |
| | | 2 | Numri total i mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë | 13 | 12 | 12 | 6 | 50% | |



| | | | | | | | | | |
|------------------|--|---|---|-------|---------|---------|----|----|--|
| | | 3 | Rritja e konsultimit me publikun. Numri i vendimeve bashkiake që janë marrë mbas konsultimit me publikun kundrejt numrit total të vendimeve(në %) | 8% | 14% | 14% | 0% | 0% | |
| | | 4 | Numri i akteve ligjore të konsultuara nga Shoqata e Bashkive | 6 | 6 | 6 | 0 | 0% | |
| | | 5 | Shërbime/investime të përfutuara nga Këshilli i Qarkut në lekë | 1,000 | 100,000 | 100,000 | - | 0% | |
| <i>Qellimi 2</i> | <p>I. Struktura menaxhuese cilësore, duke krijuar mundësinë dhe lehtësinë për perthithjen e burimeve njerëzore profesionale dhe në funksion të zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për orfrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. II. Dixhitalizmi i administratës publike do të jetë gjithmonë një nga prioritetet tona në kuadër të programit të administratës vendore. Shtimi dhe promovimi i shërbimeve elektronike për qytetarët, biznesin dhe administratën. III. Rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike vendore ku qytetarët të kenë mundësinë që të aplikojnë dhe përfitojnë shërbimin në çdo Njësi Administrative, lagje dhe Bashki qendër dhe përmes web-it për të gjitha shërbimet që sot ofrohen nga Bashkia e Shkodrës.</p> | | | | | | | | |



| | | | | | | | | | |
|----------------------|---|---|---|-----|------|-----|-----|------|--|
| Objektivi 2.1 | Burime Njerezore të trajnuara dhe të kualifikuara për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi. | | | | | | | | |
| | | 6 | Rritja e qëndrueshmërisë së administratës civile. Numri i punonjësve që kanë qëndruar në punë kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %) | 80% | 105% | 97% | 77% | 80% | |
| | | 7 | Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë. Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë (raporti kundrejt totalit të punonjësve të bashkisë) (raporti në %) | 2% | 0% | 0% | 0% | | |
| | | 8 | Rritja e kapaciteteve / burimeve njerëzore të bashkisë. Raporti i personave të trajnuar kundrejt totalit të punonjësve të bashkisë (raporti në %) | 13% | 16% | 23% | 24% | 105% | |
| | | 9 | Dite/dieta për person në vit udhëtime brenda dhe jashtë vendi | 22 | 183 | 127 | 27 | 21% | |
| Objektivi 2.2 | Shërbimet mbështetëse për administratën vendore sigurimi planifikimi e zhvillimi të njësisë, menaxhimi e financave të administratës vendore dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|--|--|----|--|--------|--------|--------|--------|------|--|
| | | 10 | Buxheti për shërbimet mbeshtetëse për Bashkinë qendër, NjA dhe Lagje në mijë leke | 11,336 | 17,100 | 27,345 | 20,160 | 74% | |
| | | 11 | Ndërtesave administrative të siguruara (NjA , Bashkia Qendër dhe Lagje) në numër | 11 | 12 | 12 | 12 | 100% | |
| | | 12 | Siperfaqe në m2 ndërtesa të mirëmbajtura (NjA , Bashkia Qendër dhe Lagje) - ndryshimi në % kundrejt vitit paraardhës | 16% | 23% | 23% | 0% | 0% | |
| | | 13 | Buxheti i shpenzuar për mjetet e transportit (karburant , mirembajtje ,taksa dhe siguracione) në mijë lekë/ numrin e automjeteve | 644 | 671 | 691 | 97 | 14% | |
| | | 14 | Persona përfaqesues të institucione vendase dhe të huaja | 610 | 250 | 480 | 348 | 73% | |
| | | 15 | Numri i njësive administrative me akses në internet | 27 | 28 | 27 | 27 | 100% | |
| | | 16 | Pajisje TIK të reja dhe të mirëmbajtura kundrejt numrit total të punonjësve (raporti në %) | 23% | 14% | 17% | 0% | 0% | |
| | | 17 | Numri i shërbimeve administrative elektronike | 100 | 69 | 101 | 101 | 100% | |
| | | 18 | Numri i sistemeve teknologjise së informacionit Web Based me aksesueshmeri kombetare dhe | 8 | 8 | 8 | 8 | 100% | |



| | | | | | | | | | |
|--|--|----|--|--------|--------|--------|-------|------|--|
| | | | vendore në Bashkinë Shkodër | | | | | | |
| | | 19 | Numri i moduleve elektronike online në shërbim të qytetarëve | 11 | 11 | 10 | 10 | 100% | |
| | | 20 | Numri i kërkesave të procesuara për shërbime administrative elektronike gjatë vitit | 20,702 | 21,000 | 21,000 | 5,944 | 28% | |
| | | 21 | Numri i njërive administrative që ofrojnë shërbime elektronike | 11 | 11 | 11 | 11 | 100% | |
| | | 22 | Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive | 0 | 1 | 1 | 0 | 0% | |
| | Objektivi 2.3 Përbushje detyrimesh për ndjekje dhe përfaqësim procese gjyqësore, shlyerje e detyrimesh që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës së prerë. Rregjistrim i pronave transferuara me VKM për transferimin në pronësi ose pëdorim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore dhe rregjistrim pronave që fitohen nga shpronësimet. Zbatimi i ligjit për transferimin e komisionit për agjentin tatimor | | | | | | | | |
| | | 23 | Prona të rregjistruara pranë ASHK në raport me pronat gjithsej të transferuara në pronësi të Bashkisë | 34% | 30% | 30% | 34% | 112% | |



| | | | Shkodër në % | | | | | | |
|---------------|---|----|--|-------|-------|-------|-------|------|--|
| | | 24 | Numri i pronave të përfituara nga shpronësime me VKM etj | 1 | 20 | 20 | 14 | 70% | |
| | | 25 | Numri i pronave derguar ne ASHK për konfirmim statusi juridik, kartela pasurie+HTR | 179 | 310 | 310 | 55 | 18% | |
| | | 26 | Numri i aplikimeve për regjistrim të pronave referuar VKM | 3 | 220 | 220 | 0 | 0% | |
| | | 27 | Numri i proceseve gjyqësore në ndjekje | 195 | 121 | 121 | 93 | 77% | |
| | | 28 | Vendime gjyqësore të formes së prerë me efekte financiare në numër | 3 | 0 | 2 | 3 | 150% | |
| | | 29 | Numri i kërkesë padive në lidhje me vlerën e debitorëve në zbatim të rekomandimeve të KLSH | 3 | 5 | 5 | 1 | 20% | |
| | | 30 | Numër biznesesh dhe individë bllokim i pasurive të palujtshme dhe të luajtshme | 0 | 500 | 500 | 0 | 0% | |
| | | 31 | Shuma për pagesën e agjenteve tatimore në mijë lekë | 21 | 3500 | 6900 | 3815 | 55% | |
| Qellimi 3 | Sigurimi i një shërbimi sa më cilësor ndaj komunitetit për funksionet e deleguara | | | | | | | | |
| Objektivi 3.1 | Shërbime të deleguara të mbështetura për funksionimin e tyre. | | | | | | | | |
| | | 32 | Numri i dokumenteve të prodhuara / lëshuara | 29300 | 56000 | 30000 | 11900 | 40% | |



| | | | | | | | | | |
|--|--|----|---|-----|-----|-----|-----|------|--|
| | | 33 | Të ardhurat nga dokumentat e prodhuar (mijë lekë) | 197 | 371 | 371 | 107 | 29% | |
| | | 34 | Numër shërbimesh (lindje, martese, vdekje) si dhe të shërbimeve tjera të ofruara nga Gjendja Civile | 10 | 10 | 22 | 22 | 100% | |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblendës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| | | | |
|----------------------|--------------------------------------|-------------------------|------|
| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
| Programi | Planifikim, menaxhim dhe administrim | Kodi i Programit | 1110 |

| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2022) | Shpenzimet (sipas vitit 2022) | I | | II | | III | | IV | | Luhatjet në Koston për Njësi | | | Komentet | | |
|------|---|---|----------------------------------|-------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|--|---|--|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------|----------|-------------|--------------|
| | | | | | Kosto për Njësi (sipas vitit 2022) | Sasia (sipas planit të vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2023) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2023) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Kosto për Njësi (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2023) | V = IV - I | | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Vendimmarrje nga Këshilli Bashkiak | numri i konsultimeve me publikun; numri i vendimeve të Këshillit të Bashkisë; numri i mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë | 113 | 15,758 | 139.5 | 92 | 17,952 | 195.1 | 92 | 19,253 | 209.3 | 65 | 10,840 | 166.8 | 27.3 | -28.4 | -42.5 | |
| 2 | Mbeshetje financiare e organeve përfaqësuese vendore për funksionimin e tyre. | numër pagesash në vit | 2 | 1,500 | 750.0 | 3 | 1,500 | 500.0 | 3 | 2,000 | 666.7 | | | | -750.0 | -500.0 | -666.7 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|--|---|--------|---------|---------|--------|---------|---------|--------|---------|---------|-------|---------|---------|---------|---------|----------|
| 3 | Menaxhimi efektiv, trajnimi i punonjësve dhe rekrutimi i burimeve njezore në mënyrë transparente | numri i punonjësve; numri i personave të trajnuar | 271 | 194,119 | 716.3 | 330 | 264,457 | 801.4 | 349 | 264,875 | 759.0 | 324 | 151,099 | 466.4 | -250.0 | -335.0 | -292.6 |
| 4 | Ditë/dieta për person në vit udhetime brenda dhe jashtë vendi | ditë/dieta | 22 | 295 | 13.4 | 183 | 700 | 3.8 | 127 | 700 | 5.5 | 27 | 279 | 10.3 | -3.1 | 6.5 | 4.8 |
| 5 | Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave të institucionit Bashkia Shkodër , Nj.A dhe Lagje | numër godina administrative | 12 | 16,077 | 1,339.8 | 12 | 22,060 | 1,838.3 | 12 | 32,305 | 2,692.1 | 12 | 13,268 | 1,105.7 | -234.1 | -732.7 | -1,586.4 |
| 6 | Menaxhimi i mjeteve në pronësi të Bashkisë Shkodër | në numër | 7 | 4,505 | 643.6 | 7 | 4,700 | 671.4 | 7 | 4,834 | 690.6 | 7 | 676 | 96.6 | -547.0 | -574.9 | -594.0 |
| 7 | Persona, përfaqesues të institucioneve vendase dhe të huaja | në numër | 610 | 1,328 | 2.2 | 250 | 1,500 | 6.0 | 480 | 1,500 | 3.1 | 395 | 985 | 2.5 | 0.3 | -3.5 | -0.6 |
| 8 | Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punës për administratën vendore | numër procesesh | 28,979 | 8,533 | 0.3 | 21,089 | 21,956 | 1.0 | 21,120 | 24,623 | 1.2 | 5,944 | 13,823 | 2.3 | 2.0 | 1.3 | 1.2 |
| 9 | Regjistrimi i pronave të Bashkisë Shkodër pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës | numër Pronash të derguara në ASHK për konfirmim statusi juridik, kartela pasurie+HTR, nr. pronash për regjistrim referuar VKM,nr. pronash të miratuara me VKM për shpronësime | 180 | 729 | 4.1 | 330 | 1,000 | 3.0 | 330 | 1,000 | 3.0 | 69 | 318 | 4.6 | 0.6 | 1.6 | 1.6 |
| 10 | Përbushje e detyrimeve , që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formës së prerë | numër procesesh gjyqësore të likuiduara | 3 | 3,535 | 1,178.3 | 5 | 978 | 195.6 | 5 | 23,683 | 4,736.6 | 1 | 4,597 | 4,597.0 | 3,418.7 | 4,401.4 | -139.6 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|--|---|--------|--------|------|--------|--------|---------|--------|--------|---------|--------|--------|---------|---------|-------|----------|--|
| 11 | Numër biznese dhe individë bllokim i pasurive të palujtshme dhe të luajtshme | numër biznese dhe individë | | | | 500 | 700 | 1.4 | 500 | 700 | 1.4 | | | | 0.0 | -1.4 | -1.4 | |
| 12 | Përmbushje e detyrimeve ndaj agjentit tatimor | numër pagesash në vit | 2 | 21 | 10.5 | 2 | 3,500 | 1,750.0 | 2 | 6,900 | 3,450.0 | 2 | 3,815 | 1,907.5 | 1,897.0 | 157.5 | -1,542.5 | |
| 13 | Shërbime të ofruara nga Gjendja Civile | Numri i dokumenteve të prodhuara / lëshuara | 29,300 | 15,339 | 0.5 | 56,000 | 17,032 | 0.3 | 30,000 | 20,492 | 0.7 | 11,900 | 12,712 | 1.1 | 0.5 | 0.8 | 0.4 | |

Për 8- mujorin e vitit 2023 në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2023 nga Administrata e Bashkisë janë parashikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë :

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I Aktiviteteve | Plani fillestar 2023 | Plani i rishikuar 2023 | Realizimi i 8M 2023 |
|---|--|-----------------|--|----------------------|------------------------|---------------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Vendimarrje nga Këshilli Bashkiak (numër) | P01110.Q1.O1.A1. Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshillit Bashkiak dhe Kryetareve të fshatrave) & te trashguara | Bashkia Shkodër | në vazhdimesi | 17,952 | 19,253 | 10,840 |
| Mbështetje financiare e organeve përfaqësuese vendore për funksionimin e tyre (numër) | P01110.Q1.O1.A2. Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë | Bashkia Shkodër | gjate vitit | 500 | 500 | - |
| | P01110.Q1.O1.A3. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut | Bashkia Shkodër | Akt marrveshje nr 1252/1 date 08.09.2023 | 1,000 | 1,000 | - |
| | P01110.O1.A4. Mbeshtetje e bashkepunimit me Universitetin e Shkodres " Luigj Gurakuqi" te trashguara | | gjate vitit | | 500 | |
| Menaxhimi efektiv, trajnimi i punonjësve dhe rekrutimi i I burimeve njerëzore në mënyrë transparente (numër punonjësish) | P01110.Q2.O1.A1. Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve & te trashguara | Bashkia Shkodër | realizuar e ne vazhdimesi | 264,157 | 264,157 | 150,491 |
| | P01110.Q2.O1.A2. Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. | Bashkia Shkodër | realizuar | 200 | 200 | 190 |
| | P01110.Q2.O1.A3. Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës & te trashguara | Bashkia Shkodër | realizur e vazhdimesi | 100 | 518 | 418 |

| | | | | | | |
|--|---|-----------------|---------------------------|-------|--------|-------|
| Ditë/dieta për person në vit udhetime brenda dhe jashtë vendi (dite dieta) | P01110.Q2.O1.A4. Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë | Bashkia Shkodër | realizuar e vazhdimesi | 700 | 700 | 279 |
| Menaxhimi dhe mireadministrimi i strukturave të institucionit Bashkia Shkodër, NjA dhe Lagje (numër godina administrativ e) | P01110.Q2.O2.A1. Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë së Shkodrës & te trashguara | Bashkia Shkodër | realizuar e ne vazhdimesi | 9,900 | 11,461 | 6,311 |
| | P01110.Q2.O2.A2. Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për Administratën e Bashkisë së Shkodrës & te trashguara | Bashkia Shkodër | realizuar e ne vazhdimesi | 5,400 | 11,584 | 6,442 |
| | P01110.Q2.O2.A3. Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale hidraulike, elektrike etj) | Bashkia Shkodër | realizuar | 800 | 800 | 515 |
| | P01110.Q2.O2.A4. Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës | Bashkia Shkodër | derguar ne nj.prokurimit | 1,000 | 3,500 | - |
| | P01110.Q2.O2.A5. Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës. | Bashkia Shkodër | muaji tetor | 960 | 960 | - |
| | P01110.Q2.O2.A6. Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës | Bashkia Shkodër | gjate vitit | 4,000 | 4,000 | - |
| Menaxhimi i mjeteve në pronësi të Bashkisë Shkodër (në numër) | P01110.Q2.O2.A7. Mbështetja dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës & te trashguara | Bashkia Shkodër | realizuar e në vazhdimsi | 4,700 | 4,834 | 676 |
| Persona, përfaqesues të institucioneve vendase dhe të huaja (në numër) | P01110.Q2.O2.A8. Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja . | Bashkia Shkodër | realizuar e në vazhdimsi | 1,500 | 1,500 | 985 |
| Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve të punes për administratën vendore (numër procesesh) | P01110.Q2.O2.A9. Shërbim Interneti për Institucionin e Bashkisë së Shkodrës & te trashguara | Bashkia Shkodër | në vazhdimesi | 2,100 | 2,363 | 1,182 |
| | P01110.Q2.O2.A10. Mirëmbajtje pajisje Informatike & te trashguara | Bashkia Shkodër | gjatë vitit | 600 | 1,062 | 204 |
| | P01110.Q2.O2.A11. Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) | Bashkia Shkodër | realizuar | 6,000 | 6,000 | 5,605 |

| | | | | | | |
|--|--|-----------------|---|-------|--------|-------|
| | P01110.Q2.O2.A12. Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të bashkisë Shkodër | Bashkia Shkodër | gjate vitit | 4,056 | 4,056 | - |
| | P01110.Q2.O2.A13. Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj | Bashkia Shkodër | realizuar kontrata 10715/b port datë 11.08.2023 | 800 | 800 | - |
| | P01110.Q2.O2.A14. Informimi I qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër | Bashkia Shkodër | gjatë vitit | 500 | 500 | - |
| | P01110.Q2.O2.A15. Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive & te trashguara | Bashkia Shkodër | gjatë vitit | 800 | 2,743 | - |
| | P01110.Q2.O2.A16 Rikonstruksion i Dhomës së Serverave | Bashkia Shkodër | realizuar | 7,000 | 7,000 | 6,832 |
| | P01110.Q2.O2.A17 Blerje vegla pune | Bashkia Shkodër | gjate vitit | 100 | 100 | - |
| Regjistrimi I pronave të Bashkisë Shkodër pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (numri vjetor i pronave të rregjistruara në ASHK) | P01110.Q2.O3.A1. Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër | Bashkia Shkodër | realizuar e ne vazhdimesi | 1,000 | 1,000 | 318 |
| Përmbushje e detyrimeve , që rrjedhin nga vendime gjyqësore të formes së prerë. (në numër) | P01110.Q2.O3.A2. Detyrime dhe kompensime legale & te trashguara | Bashkia Shkodër | realizuar e ne vazhdimesi | 200 | 22,670 | 4,597 |
| | P01110.Q2.O3.A3.Shlyerja e detyrimeve te prapambetura | Bashkia Shkodër | gjate vitit | 778 | 1,013 | - |
| Nr biznese dhe individë bllokim i pasurive te palujtshme dhe te luajtshme (ne numer) | P01110.Q2.O3.A4 .Pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore | Bashkia Shkodër | gjate vitit | 700 | 700 | - |



| | | | | | | |
|--|---|-----------------|---------------------------|----------------|----------------|----------------|
| Përbushje e detyrimeve ndaj agjentit tatimor (në numër) | P01110.Q2.O3.A5. Pagesa e komisionit si agjent tatimor & te trasheguara | Bashkia Shkodër | realizuar e ne vazhdimesi | 3,500 | 6,900 | 3,815 |
| Shërbime të ofruara nga Gjendja Civile (në numër) | P01110.Q3.O1.A1 Shërbimet e deleguara Gjendja Civile | Bashkia Shkodër | | 17,032 | 20,492 | 12,712 |
| 01110+1170 Planifikim , menaxhim dhe administrim+Gjendja Civile | | | | 358,035 | 402,865 | 212,411 |
| Te trasheguara | | | | 134,894 | 84,412 | - |
| Totali | | | | 492,929 | 487,277 | 212,411 |

Aparati i Bashkisë ka si objekt formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës.

Për 8 mujorin e vitit 2023 në programin “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2023 nga administrata e Bashkisë janë analizuar si më poshtë aktivitetet:

P01110.Q1.O1.A1 Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryetarët e fshatrave).

Është siguruar mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore. Realizohet shpërblimi mujor në mënyrë sistematike dhe me korrektësi për anëtarët e Këshillit Bashkiak dhe kryetarëve të fshatrave të Njësive Administrative.

P01110.Q1.O1.A2 Anëtarësimi në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë

Pagesa e kuotës së anëtarësisë është një detyrim që ka Bashkia Shkodër, parashikuar në Statusin e Shoqatës, neni 14 dhe në ligjin organik nr.139/2015 “Për vetqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1.5(c). Kjo do të realizohet pasi të nënshkruhet aktmarrëveshja midis Shoqatës së Bashkive dhe Bashkisë Shkodër.

P01110.Q1.O1.A3 Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të qarkut

Në zbatim të udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” të ardhurat e qarqeve nga kuota e njësive vendore, kuotat e miratuara nga këshilli i qarkut bëhen pjesë e buxhetit të njësive të qeverisjes vendore. Mes njësive të qeverisjes vendore dhe këshillit të qarkut mbahet një akt- marrëveshje për detyrimin vjetor ndaj këshillit të qarkut. Mbi bazën e titullit për arkëtim që lëshon këshilli i qarkut bëhet transferim i brendshëm nga njësia vendore në favor të këshillit të qarkut nëpërmjet strukturës përgjegjëse për thesarin në sistemin informatik financiar të qeverisë. Është realizuar marrëveshja me Këshillin e Qarkut .Në proces likuidimi.

P01110.O1.A4. Mbështetje e bashkëpunimit me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” te trasheguara

Bashkia Shkodër do të jetë e gatshme për të mirëpritur studentët e regjistruar në programet studimore për të konsultuar materialet e ndryshme të institucionit dhe institucioneve e ndërmarrjeve në varësi të Bashkisë, me qëllim kërkimin shkencor dhe praktikën profesionale sipas rregullave.

Gjatë vitit do të realizohet shkëmbimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucioneve në aktivitete didaktike, projekte të kërkimit shkencor me interes të përbashkët si: konferenca, seminare bashkëbisedime me studentë e pedagogë.

P01110.Q2.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë së Shkodrës në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Kemi realizuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të administratës së Bashkisë Shkodër përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas VKM nr. 113 dt.01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi" ;VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike" ;VKM nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike" ; VKM nr. 241, datë 20.4.2023 Për disa ndryshime në vendimin nr. 175, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, " Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar", të ndryshuar ;VKM nr. 240 dt. 20.04.2023 Për një ndryshim në VKM nr. 350, datë 19.4.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" të ndryshuar ; VKM nr. 328 dt. 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" ;

P01110.Q2.O1.A2 Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve

Ky aktivitet synon rekrutimin e burimeve profesionale për të qënë pjesë e administratës vendore përmes procedurave të përcaktuara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve. Këto rekrutime realizohen me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë realizohet përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive". Është realizuar rekrutimi për vendet vakante të shpallura.

P01110.Q2.O1.A3 Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shkodrës.

Ky aktivitet synon që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryejnë trajnime në institucione të tjera trajnuese me iniciativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Për 8 mujorin e vitit 2023 janë realizuar disa trajnime për punonjësit me status nëpunësi civil nga ASPA, trajnimet e detyrueshme për punonjësit në periudhë prove si edhe trajnime të tjera si: Trajnimi për Integrimin Evropian në Nivel Vendor dhe Menaxhimi i Strukturave të Integritit Evropian, Menaxhimi i Strukturave të Integritit Evropian, Menaxhimi, Komunikimi dhe Marrëdhënia me Median organizuar nga projekti Bashkë për ne Evropë ; Zhvillimi i Qëndrueshëm i Sistemeve Ushqimore në Shqipëri organizuar nga FAO në Shqipëri; Qeverisja e migracionit në nivel vendor: sfidat dhe mundësitë e një qasje multisektoriale, organizuar nga Terre Des Home Trajnim për kapitullin 42 të negociatave (Organizuar nga AMVV), Adresimi i boshllëqeve sistematike , mbështetje për reformat e sistemit të mirëqenies së fëmijëve; Menaxhimi i rasteve të dhunës e familje në nivel vendor, përmes mekanizimit të koordinuar të referimit të dhunës ; Rritja e kapaciteteve për profesionistët në nivel vendor për ofrimin e ndihmës për riintegrimin e migrantëve të kthyer; Fuqizimi dhe aftësimi i të rinjve, Strategji praktike në menaxhimin e mirëqenies të profesionistëve përgjatë punës me të rikthyerit nga migracioni dhe riintegrimin e tyre; Lufta kundër krimit kibernetik; Buxheti Gjini si instrument i menaxhimit të buxhetit publik etj për nëpunësit e administratës sipas konfirmimeve të eprorëve direkt.

Eshtë realizuar trajnimi i punonjësve TIK për nevojat të realizimit të funksioneve në këtë sektor konform marrëveshjes së nënshkruar me operatorin Tech 01 ShPK , dt.29.12.2022 me objekt aktiviteti Akademi Mësimdhënie, Programe dhe trajnime të ndryshme, mentorim dhe konsultim në fushën e sipërmarrjes dhe reklamave dixhitale, programe të formimit profesional .

P01110.Q2.O1.A4 Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë.

Tek ky aktivitet realizohet shërbimi sipas nevojave për udhëtime për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë, i cili është i domosdoshëm në rritjen e standartit të plotësisht të kushteve të punës ndaj administratës si dhe anasjelltas, në rritjen e eficiencës së administratës për dhënien e kontributit dhe përfaqësimin e duhur të institucionit në takime pune etj. Për realizimin e këtyre lëvizjeve është bërë gjatë vitit rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon. Për arsye pune jashtë vendit janë mbulur shpenzimet e udhëtimit për 6 persona për takime pune dhe pjesëmarrje në panairin e turizmit BTM i zhvilluar në Bari Itali etj.

P01110.Q2.O2.A1 Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës.

Është përmirësuar dhe realizuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shkodrës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie dhe shërbime të tjera.

P01110.Q2.O2.A2 Shërbimi me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë së Shkodrës.

Është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj. sipas kërkesave të drejtorive. Sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, dhe bojëra për printera

e fotokopje dhe shtypshkrime i mundëson punonjësve përmbushjen e detyrave dhe objektivave. Është realizuar blerja e shpenzimeve për shtypshkrime, libërlidhje etj. Është realizuar dhe në vazhdimësi.

P01110.Q2.O2.A3 Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale elektrike, hidraulike etj)

Janë siguruar dhe realizuar në vazhdimësi mbështetja për shërbimet mbështetëse bazë për mirëmbajtjen dhe furnizimin me materiale elektrike, hidraulike.

P01110.Q2.O2.A4 Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës.

Është bërë identifikimi dhe klasifikimi i kërkesave për pajisje të reja zyre të nevojshme dhe është realizuar blerja për kondicionerë, tavolina, rafte, karrige etj. Parashikuar të realizohet gjatë vitit.

P01110.Q2.O2.A5 Sigurimi i ndërtesave administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe inventarit të tyre ekonomik.

Bashkia Shkodër ka detyrim ligjor për sigurimin nga zjarri dhe rreziqet e tjera të pronave dhe inventarit të saj ekonomik. Ky shërbim u krye për 10 objekte bashkë me inventarin ekonomik të tyre si ndërtesa e Bashkisë Qendër, magazinave dhe Njësive Administrative. Sigurimet e ndërtesave reduktojnë barrën financiare dhe lehtësojnë vazhdimësinë e institucionit duke ulur kostot publike në rast të ndodhjes së fatkeqësive dhe është parashikuar të realizohet në muajin Tetor.

P01110.Q2.O2.A6 Shërbim i mirëmbajtjes për godinat administrative të Bashkisë së Shkodrës.

Ndërtesa e Bashkisë Qendër dhe e Njësive Administrative duhet të jetë në kushte fizike normale të pranueshme për administratën, me qëllim kryerjen e detyrave të përditshme si edhe për qytetarët të cilët paraqiten në ato ambiente për të marrë shërbimin e nevojshëm. Është realizuar mirëmbajtja e këtyre ambienteve, e cila është një nevojë e domosdoshme për të mbajtur në kushte normale të pranueshme në vazhdimësi këto ndërtesa. Parashikuar të realizohet gjatë vitit.

P01110.Q2.O2.A7 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shkodrës.

Janë siguruar në vazhdimësi furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë Shkodër sipas nevojave në Bashkinë qendër, Njësi Administrative etj. shlyerja e të gjitha taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës.

P01110.Q2.O2.A8 Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja.

Është realizuar shërbimi për organizimin e pritje- përcjelljeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja. Në kuadër të bashkëpunimit me shtete të tjera, në nivel lokal, rajonal dhe më gjërë, në vendosjen dhe nxitjen e mëtejshme të bashkëpunimit midis qyteteve dhe partnerëve lokal, rajonal dhe ndërkombëtar në të gjitha fushat, për zhvillimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe në kuadër të eksperiencave për arritjen dhe zhvillimin e kontakteve të krijuara nga përfaqësuesit tanë, kemi synuar arritjen e standarteve në nivele të përafërta me qytetet e tjera evropiane. Janë zhvilluar takime të ndryshme me qëllim forcimin e partneritetit. Bashkinë Shkodër e kanë vizituar delegacione të shumta, përfaqësues të institucioneve homologe të nivelit lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, pjesëmarrës nga

institucionet kulturore të ftuar për organizimin e aktiviteteve kulturore të ndryshme etj. Për 8 mujorin viti 2023 janë realizuar shpenzime për pritje percjellje për dreka, darka pune si: pritje për nder të artisteve të teatrit Migjeni, pritje të Parlamentit Europian të të rinjve, pritje në kuader të aktivitetit konferencë mbi spektrin e autizmit, darkë për nder të delegacionit të Federatave Kombëtare të atletikës Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni dhe Itali etj Gjithashtu është shtruar Iftar për komunitetin mysliman dhe qytetarëve të Shkodrës me rastin e Muajit të Madhnueshëm të Ramazanit.

P01110.Q2.O2.A9 Shërbim interneti për institucionin e Bashkisë së Shkodrës & te trashëguara.

Është realizuar prokurimi dhe ofrimi i shërbimit të internetit në të gjithë Bashkinë Shkodër (Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative dhe Lagje). Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem të qendëruar të marrjes së shërbimit të internetit në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative, Lagje dhe Qendra Komunitare. Zgjidhja e implementuar ofron 99.99% shërbimin në çdo kohë në çdo pikë të tij. Sistemi siguron konfidencialitetin dhe sigurinë e informacionit që transmetohet në linjat e komunikimit. Të gjithë pikat e furnizuara të Bashkisë Shkodër kanë akses në internet 24/7 pa kufizim në komunikim. Ky shërbim ka rritur shpejtësinë në komunikim të të dhënave, ka ulur kostot operative për komunikimin e informacionit, ka garantuar mirëfunksionimin e sistemeve të bazuara në platforma web që Bashkia ka implementuar dhe ka shtrirë në të gjithë njësitë e saj administrative, si: Sistemi i Integruar i Zyrës me Një Ndalesë (SiZ1N), Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore (SiTTV), Sistemi i qendëruar kombëtar i shërbimeve të Ndihmës Ekonomike, e- Lejet, Sistemi AFMIS, portali i Transparencës së Buxhetit, sistemi i integruar i menaxhimit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit, faqja zyrtare e internetit www.bashkiashkoder.gov.al, menaxhimi i dokumentacionit dhe punës së përditshme të administratës vendore në rrugë elektronike, transparente dhe në kohë, etj. Realizohet në vazhdimësi.

P01110.Q2.O2.A10 Mirëmbajtje pajisje informatike. & te trashëguara.

Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Është bërë vazhdimisht një rivlerësim i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative të saj, Lagjeve dhe Qendrave Komunitare, ku janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI. Ky shërbim i siguar sistematikisht çdo vit nga buxheti i Bashkisë Shkodër, ka mbështetur administratën vendore me një infrastrukturë optimale pajisjesh të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Do të realizohet gjatë vitit .

P01110.Q2.O2.A11 Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Nevoja e administratës për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) ka qenë dhe është e domosdoshme. Është bërë sistematikisht një rivlerësim i pajisjeve ekzistuese TIK në Bashkinë Qendër, Njësitë Administrative të saj, Lagjet dhe Qendrat Komunitare, ku janë kryer procedura kalimi në inventar nga njëra drejtori në tjetrën, janë nxjerrë jashtë përdorimi pajisjet që nuk plotësojnë specifikimet teknike minimale të miratuara nga AKSHI. Pajisje të reja TIK janë prokuruar nga buxheti i Bashkisë gjatë vitit 2023, pasi nevoja për ripërtëritje të pajisjeve ekzistuese TIK ka qenë vazhdimisht dhe është e nevojshme për t'u bërë gradualisht nga viti në vit. Kjo nevojë vjen si rezultat i programeve të licensuara që duhet të përdorim në zbatim të Rregulloreve të AKSHI- t për Komunikimet Elektronike,

asaj të Blerjeve të Pajisjeve TIK dhe plotësimit të standarteve minimale teknike, si dhe asaj të ofrimit të Shërbimeve të Përqendruara në Administratën Publike.

Bashkia ka mundësuar pajisje të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në gjendje optimale funksionimi në mbështetje të punës së administratës vendore dhe në mbështetje të sistemeve të informacionit të implementuara dhe që do të implementohen në të ardhmen në Bashkinë Shkodër.

P01110.Q2.O2.A12 Mirëmbajtje e Sistemeve të Integruara të Informacionit të Bashkisë Shkodër.

Një tjetër iniciativë inovative e Bashkisë Shkodër është ajo e përfshirjes së qytetarëve në buxhetin përmes përdorimit të platformës online Transparenca e Buxhetit, një instrument Open Data i realizuar për herë të parë dhe të vetme në Shqipëri. Ky instrument online informon publikun për të ardhurat vjetore të saj, shpenzimet dhe investimet, si dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vjetore të qytetarëve dhe bizneseve, si dhe i fton ato të shprehen online për kërkesa apo pakënaqësi të mundshme t'i drejtohen zyrave përkatëse përgjegjëse në Bashki për zgjidhjen.

Bashkia Shkodër ka implementuar një sistem informacioni për Shërbimet Sociale. Qëllimi kryesor i implementimit të këtij sistemi është ofrimi i mundësisë për të populluar një bazë të dhënash të saktë me informacione mbi institucionet që ofrojnë shërbime sociale, si dhe mbi përfituesit që janë të regjistruar pranë këtyre institucioneve, në nivel vendor.

Bashkia Shkodër ka arritur ofrimin e shërbimeve administrative elektronike aty ku qytetari dhe biznesi ndodhet, duke mundësuar që qeverisja vendore të shkojë drejt qytetarit në kohë të shkurtër, në mënyrë cilësore dhe transparente. Kjo ka rritur llogaridhënien financiare dhe ka mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

P01110.Q2.O2.A13 Mirëmbajtje e faqes zyrtare web www.bashkiashkoder.gov.al dhe moduleve të integruara të saj.

Ky aktivitet realizohet në vazhdimësi. Bashkia Shkodër zotëron faqe zyrtare interneti nën domain-in www.bashkiashkoder.gov.al. Kjo faqe është 24/7 online dhe aktualisht është një faqe e nivelit të 3 në përputhje me rregulloren e AKSHI- t për faqet zyrtare në administratën publike. Në faqe janë të integruar disa module që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe demokracinë vendore në kuadër të mirëqeverisjes elektronike vendore. Moduli i Librisë Ligjore i implementuar dhe i integruar në faqe, bën të mundur që Bashkia të ndajë me qytetarët të gjithë projekt- vendimet dhe vendimet e Këshillit të Bashkisë përmes një moduli të menaxhueshëm në web nga Sekretaria e Këshillit të Bashkisë. Moduli e-Pjesëmarrje i implementuar dhe i integruar në faqe, mundëson krijimin e vazhdueshëm të sondazheve me tematika të ndryshme dhe marrjen e mendimeve nga qytetari, lehtësisht i menaxhueshëm nga punonjësit e Bashkisë. Moduli i SiZIN, i integruar në faqen web, bën të mundur gjurmimin e kërkesave për shërbim të qytetarëve (tregon se në cilin status të aplikimit ndodhen shërbimet) që aplikohen në Zyrën e Integruar me Një Ndalesë në Bashkinë Qendër apo Njësitë Administrative, direkt nga portali zyrtar online. Shkarkimi i formularëve online, informacioni i detajuar i regjistrit të kërkesave, raportet e auditimit, raportet financiare, buxheti dhe realizimi i tij, paketa fiskale, transparenca e buxhetit, raportimi online, forumi online, etj. në kuadër të programit të transparencës janë një tjetër mjet i përfshirjes së qytetarit përmes këtij portal web. Është realizuar kontrata e shërbimit me nr.10715/b ,datë 11.08.2023.

P01110.Q2.O2.A14. Informimi i qytetarëve përmes mediave vizive për përfitimin e shërbimeve nga Bashkia Shkodër.

Bashkia Shkodër është institucioni i parë i qeverisjes vendore në Shqipëri që në respektim të parimit “qytetari në qendër” ka implementuar një model për ofrimin e Shërbimeve Administrative të Integruara të shtrirë tashmë në të gjithë territorin përmes hapjes Zyrove të Integruara me Një Ndalesë (Zi1N) në Bashkinë Qendër, në të gjitha njësitë administrative dhe së fundmi është në proces shtrirja e sistemit në 5 Lagjet e qytetit.

Informimi mbi këto shërbime dhe mbi procedurat e përfitimit të tyre vazhdimisht i prezantohet qytetarëve në takime të tematikave të ndryshme, në dëgjesa publike, përmes afishimeve të bëra dhe fushatave informuese me fletëpalosje në të gjitha Zyrat me Një Ndalesë. Njëkohësisht kemi vlerësuar si të domosdoshëm informimin e qytetarëve për këto shërbime dhe mënyrën e përfitimeve të tyre përmes mediave vizive lokale si një mjet tjetër i domosdoshëm komunikimi qytetar- qeverisje vendore. Ky aktivitet do të realizohet gjatë vitit.

P01110.Q2.O2.A15 Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve të Varësive &te trashguara

Është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik “*Infosoft Software Developer*” dhe janë kryer disa nga pikat kryesore të saj, si instalimi i sistemit në postet e punës, konfigurimi i planit kontabël apo i artikujve të ndryshëm të magazinës, trajnimet bazë mbi disa nga modulet kryesore të saj. Duke qenë se nuk janë plotësuar specifikimet teknike sipas kërkesës nga Drejtoria e Financës, operatori ekonomik ka kërkuar shtyrjen e afateve për përmbushjen e të gjitha kërkesave të autoritetit kontraktor .

P01110.Q2.O2.A16 Rikonstruksion i Dhomës së Serverave

Ky rikonstruksion ishte i domosdoshëm, meqenëse ambienti fizik i dhomës së serverave nuk ishte në përputhje me standardet e përcaktuara në Rregulloren për ndërtimin e dhomës së serverave (Versioni 1.0, datë 02.12.2008) miratuar nga AKSHI (Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit), përkatësisht: ruajtja e pajisjeve fizike, kontrolli i aksesit fizik mbi pajisjet, kontrolli mbi personat që kanë akses fizik: Ambienti ku ishin të lokalizuar serverat e bashkisë dhe network-u nga karakteristika ka qenë një zyrë ekzistuese e cila ishte përshtatur për tu përdorur si dhomë serverash. Nuk kishte pajisje të sigurisë fizike të aksesit dhe sistem *intrusion detection* për të kufizuar personat e paautorizuar.

Aksesi në ambientin e dhomës së serverëve nuk ishte i kontrolluar me teknologji të tilla si: skanime, lexues karte, etj.

Dhoma duhet të ishte e pajisur me një sistem të përshtatshëm kundër zjarrit; dhe rezistente ndaj zjarrit nëse kabllot dhe sistemet e ftohjes kombinohen në të njëjtën hapësirë sipër tavanit ose nën dyshe.

Sa i përket sistemit elektrik. Instalimi elektrik i dhomës së serverave nuk ishte veçmas instalimit të përgjithshëm dhe mungonte sistemi i alarmit. Përsa me sipër ishte i domosdoshëm rikonstruksioni i dhomes së serverit, për të arritur standartete e kërkuara dhe ky aktivitet është realizuar.

P01110.Q2.O2.A17 Blerje vegla pune

Në vijim të përmbushjes së kushteve fizike normale të punës për punonjësit e administratës vendore dhe për arsye të mungesës së veglave të punës për punonjësit e IT si për mirëmbajtje, printera, fotokopje etj duhet të parashikohet blerja e veglave të punës që do t i shërbejë këtyre punonjësve për të përmbushur detyrat e tyre funksionale. Ky aktivitet do të realizohet gjatë vitit.

Drejtoria Juridike për 8- mujorin e vitit 2023 ka realizuar veprimtaritë si më poshtë:

P01110.Q2.O3.A1 Shërbimi për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë Shkodër

Ky aktivitet përfshin rregjistrimin e pronave të transferuara me VKM për transferimin në pronësi ose përdorim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore dhe rregjistrimi i pronave që fitohen nga shpronësimet, dhe aplikimi të bëra pranë ASHK për konfirmime statusi juridik, kartela pasurie+HTR aktivitet që realizohet nga Drejtoria Juridike (sektori i aseteve)

Për 8 mujorin e parë të vitit 2023, janë bërë 4 aplikime për 69 prona (14 për prona që fitohen nga shpronësimet, 55 për prona për konfirmim statusi juridik, kartelë pasurie + HTR

Numri i pronave që fitohen nga shpronësimet është 14 , Aplikime të statuseve juridike 55

Jane realizuar shpenzimet për pagesa të komisioneve të shpronësimit sipas VKM për vitin 2023

P01110.Q3.O3.A2 Detyrime dhe kompensime legale & të trashëguara

1. Sektori juridik gjatë 8 mujorit të vitit 2023, ka ndjekur 93 proçese gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit. Nga ky total i çështjeve gjyqësore 14 jane proçese me efekte financiare në ndjekje.
2. Janë likuajduar 3 vendime gjyqësore të formës së prerë
3. Janë realizuar shpenzimet për njoftime/tërheqje vendime/depozitim padie/depozitim ankimi
4. Janë ngritur 2 kërkesë padi me palë paditëse : Bashkia Shkodër.
5. Vendime gjyqësore të formës së prerë me efekte financiare për vitin 2023 janë 3 vendime gjyqësore.

Janë zbatuar me rigorozitet dispozitat ligjore në fuqi, sa i takon ndjekjes së të gjitha shkallëve të gjykimit për të gjithë proçeset gjyqësore me efekte financiare.

P01110.Q2.O3.A3.Shlyerja e detyrimeve te prapambetura

Ky fond është me transfertë sektoriale sjellë nga Ministria për të paguar detyrimet e prapambetura

Nuk është realizuar për shkak se nuk kemi detyrime që mund të paguajmë me dokumentacion të rregullt financiar dhe ligjor.

Drejtoria e të Ardhurave për 8- mujorin e vitit 2023 ka realizuar veprimtaritë si më poshtë:

P01110.Q2.O3.A4 .Pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore

Për të ulur vleren debitore, që subjektet dhe individët familjar kanë ndaj Bashkisë Shkodër, bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nga Drejtoria e të Ardhurave vazhdon marrja e masave shtrënguese "urdhër bllokim i llogarive bankare" si dhe "urdhër ekzekutim i llogarive bakare" të tatimpaguesit. Vetëm për vitin 2022, janë bllokuar 350 llogari bankare, si dhe janë lëshuar 77 urdhëra ekzekutimi. Për 8 –mujorin 2023 janë lëshuar 77 urdhëra ekzekutimi dhe për vitin 2023 janë bllokuar 146 llogari bankare, si dhe janë lëshuar 19 urdhëra ekzekutimi. Marrja e masave shtrënguese, për vendosjen e barrës siguruese dhe/ose barrë hipotekore, nuk

është realizuar, sepse është në proces dhënia e aksesit për nëpunësit që do të merren me vendosjen e barrës hipotekore.

P01110.Q2.O3.A5. Pagesa e komisionit si agjent tatimor& te trasheguara. (Transferim komisioni 1%) Sipas Akt marrëveshjes lidhur mes Bashkisë Shkodër dhe "Ujësjetës Kanalizime" sh.a, Shkodër është realizuar në zbatim të ligjit për transferimin e komisionit për agjentin tatimor, që llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe transferuar në buxhetin e Bashkisë Shkodër për llogari të Administratës Tatimore Qendrore. (Drejtorisë Rajonale Tatimore) Synimi është pagesa e tarifës për vendosje barre siguruese dhe hipotekore me anë të zbatimit të masave shtrënguese, respektivisht vendosjes së barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore, synohet ulja e borxhit për taksat dhe tarifatat vendore, që subjektet dhe individët kanë ndaj Bashkisë Shkodër.

Sipas akt marrëveshjes nr. 1725 prot, datë 01.02.2022 (afati deri me 31.12.2022), akt marrë veshje per shtyrje afati kohor nr.1296 prot . datë 26.01.2023 (Afati deri me 31.03.2023), Akt Marrëveshjes nr. 4603 prot. datë 31.03.2023 (Afati nga 01 .04.2023 deri me 31.12.2023), Urdhërit nr. 492, datë 26.04.2023, faturës Nr. 333/2023, datë 31.03.2023 , VKB nr.71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar; është bërë transferim fondi për pagesë të agjentit tatimor UKSH në vlerën prej 3.815 mijë lekë.

P01170.O1.A1 Shërbimet e deleguara Gjendja Civile.

Është realizuar në vazhdimësi prodhimi i dokumentave në shërbim të qytetarëve dhe mbështetja e funksionimit të Gjendjes Civile përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Njësia e Auditit

Për 8 mujorin e vitit 2023 Njësia e Auditit ka realizuar aktivitetet si më poshtë:

| Nr | Subjektet | Niveli vlerësimit të riskut | Llojet e auditimeve | Objektet të pa audituara mbi 2-vjet | Realizimi |
|----|--------------------------------|-----------------------------|-----------------------------|-------------------------------------|-----------|
| 1. | Përfunduar 5 subjekte auditimi | I mesëm/lartë | Përputhshmëri/ Kombinuar | | ✓ |
| | Ne process 1 Subjekt auditimi | I larte | Perputhshemri | | |

Njësia e Prokurimit

Gjatë periudhës 01.01.2023–31.08.2023 në Njësinë e Prokurimit Publik është punuar për zhvillimin dhe realizimin e të gjitha procedurave të prokurimit publik të ardhura pranë Njesisë së Prokurimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha drejtoritë përkatëse dhe dërgimin e tyre për likuidim pranë Drejtorisë së Financës dhe Degës së Thesarit brenda afateve ligjore.

Bashkia Shkodër ka realizuar në total 97 procedura prokurimi si më poshtë:

| Lloji i procedurës | Numri |
|---------------------------|--------------|
| E hapur, e thjeshtuar | 41 |
| Procedurë të hapur | 11 |
| Shërbim konsulence | 0 |
| Negocim pa botim paraprak | 1 |
| Blerje dinamike | 2 |
| Blerje me vlerë të vogël | 42 |
| Totali | 97 |

FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

Programi 03140: Shërbimet Policore Vendore

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

Policia Bashkiake

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Policisë Bashkiake është:


Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të Bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të Bashkisë dhe këshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 8 -mujin e parë të vitit 2023 kanë qenë:

O1. Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi.

O2. Rritja e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.


| Programi 03140 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|--------------------|------------------------|------------|-----------|--------|
| PBA 2023 | 19,397 | 3,088 | 18 | | 22,503 |
| Plani fillestar 2023 | 26,634 | 3,336 | 36 | 5,000 | 35,006 |
| Plani i rishikuar 2023 | 26,584 | 3,336 | 86 | 5,000 | 35,006 |
| Realizimi viti 2023 | 11,293 | 185 | 50 | 4,918 | 16,446 |
| % e realizimit | 42.5% | 5.5% | 58.1% | 98.4% | 47.0% |



Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 47 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

Shpenzime kapitale

98.4%



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

Në 8-mujorin e I të vitit 2023, janë realizuar 47 % te shpenzimeve . Pjesa e mbetur e fondeve janë planifikuar të realizohen në vazhdim.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 8 Mujori 2023

| Kodi i Programit | 3140 | Emertimi i programit: | Shërbimet e Policisë Vendore | | | | | | Komente |
|-------------------------|--|---|--|---|---|---|--|--|----------------|
| Qellimi 1 | Shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore. Parandalimin e kundërvajtjeve admini-strative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe keshillit bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| | *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances | Emertimi i Treguesit te Performances | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances | |
| Objektivi 1.1 | Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar për kryerjen e funksioneve dhe përgjegjësi. | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|----------------------|---|---|---|-----|------|------|------|------|--|
| | | 1 | Punonjësit e policisë bashkiake gëzojnë statusin sipas ligjit · Raporti midis punonjësve me status të oficerit të policisë bashkiake kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake | 9% | 8% | 8% | 13% | 156% | |
| | | 2 | Punonjësit e policisë bashkiake janë të kualifikuar - Numër punonjësish të trajnuar, kundrejt numrit total të punonjësve të policisë Bashkiake | 78% | 100% | 100% | 100% | 100% | |
| Objektivi 1.2 | Rritja e qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi | | | | | | | | |
| | | 3 | Shpenzimet buxhetore për shërbimet e policisë bashkiake kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara (mije/Lekë të shpenzuara për 1 rast të menaxhuar) | 56 | 59 | 84 | 42 | 50% | |
| | | 4 | Numri i rasteve problematikave të menaxhuara | 374 | 380 | 415 | 395 | 95% | |
| | | 5 | Numri i akteve të ekzekutuara | 279 | 350 | 350 | 165 | 47% | |
| | | 6 | Numri i kamerave të vendosura në pika strategjike të qytetit | 41 | 71 | 71 | 81 | 114% | |

Realizimi i produkteve te programit

[ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"](#)

| | | | |
|---------------|-----------------|---------------|-----|
| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
|---------------|-----------------|---------------|-----|

| | | | |
|----------|-------------------|------------------|------|
| Programi | Policia Bashkiake | Kodi i Programit | 3140 |
|----------|-------------------|------------------|------|

| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2022) | Shpenzimet (sipas vitit 2022) | I | | II | | III | | IV | | Luhatjet në Koston për Njësi | | | Komente | | |
|------|---|---------------------------|----------------------------------|-------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|---|--|---|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------|---------|-------------|--------------|
| | | | | | Kosto për Njësi (sipas vitit 2022) | Sasia (sipas planit të vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2023) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2023) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2023) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2023) | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2023) | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2023) | V = IV - I | | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar | numri i punonjësve | 18 | 17,147 | 952.6 | 24 | 19,415 | 809.0 | 24 | 19,415 | 809.0 | 24 | 11,343 | 472.6 | -480.0 | -336.3 | -336.3 | |
| 2 | Performancë dinjtoze e Policisë së Bashkisë në shërbim të qytetareve nëpërmjet mjeteve të nevojshme në dispozicion për zbatimin e ligjit. | numër raste të menaxhuara | 374 | 3,667 | 9.8 | 380 | 3,088 | 8.1 | 415 | 8,151 | 19.6 | 395 | 5,103 | 12.9 | 3.1 | 4.8 | -6.7 | |

Për vitin 2023 në Programin "Shërbimet e Policisë Vendore" në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, janë parashikuar keto aktivitete :

Aktivitetet për 8-mujorin janë :

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucioni | Statusi I Aktiviteteve | Plani fillestar 2023 | Plani i rishikuar 2023 | Realizimi i 8M 2023 |
|---|--|-----------------|------------------------|----------------------|------------------------|---------------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Polici vendore e trajnuar dhe e kualifikuar (numër punonjësish) | P03140.Q1.O1.A1 Vazhdimësia e menaxhimit efektiv të Policisë Bashkiake në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shkodrës për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve & të trashguara | Bashkia Shkodër | Ne proces | 19,415 | 19,415 | 11,343 |
| | P03140.Q1.O2.A1 Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake & të trashguara | Bashkia Shkodër | Ne proces | 800 | 809 | 9 |
| | P03140.Q1.O2.A2 Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e policisë Bashkiake& të trashguara | Bashkia Shkodër | Ne proces | 1,540 | 1,594 | 176 |
| | P03140.Q1.O2.A3 Blerje dokumentacioni shtypshkrime në funksion të policisë bashkiake | Bashkia Shkodër | Ne proces | 40 | 40 | - |
| Performancë dinjotoze e Policisë së Bashkisë në shërbim të qytetareve nëpërmjet mjeteve të nevojshme në dispozicion për zbatimin e ligjit.(numër raste të menaxhuara dhe të raportuara) | P03140.Q1.O2.A4.Kamera sigurie(CCTV) për ambiente publike dhe mirembajtja e tyre& të trashguara | Bashkia Shkodër | Ne proces | 708 | 5,708 | 4,918 |
| | 03140 Sherbimet e policisë vendore | | | 22,503 | 27,566 | 16,446 |
| | Te trashguara | | | 12,503 | 7,440 | - |
| | Totali | | | 35,006 | 35,006 | 16,446 |

Programi. 03280: Emergjencat Civile

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. MZSH

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

-Qëllimi i programit të Emergjencave Civile është:

Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile.

-Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për 8-mujorin e vitit 2023 kanë qenë:

O1. Strukturat për planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile.

Me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 14 datë 20.07.2023 “Shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me “Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 71 datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”, janë miratuar shpenzimet për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme si më poshtë:

- “Shërbime emergjente për riparimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë si rezultat i fenomeneve natyrore”. Në proces hartimi i dokumentacionit për realizimin e procedurave të mëtejshme.

- “Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësive Administrative, Bashkia Shkodër” i ndarë:

- **Loti I-rë:** “*Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësive Administrative, Bashkia Shkodër*”.

- **Loti i II-të:** “*Shërbime për mirëmbajtje emergjente të segmentit Ura Mesit - Prekal - Kir - Mali Shoshit - Breglumi - Ndërllysaj - Theth*”.

Në proces hartimi i dokumentacionit për realizimin e procedurave të mëtejshme.

- “Dispozicion karrotrec për nevoja emergjente” me vlerë. Në proces hartimi i dokumentacionit për realizimin e procedurave të mëtejshme.

- “Blerje produkte ushqimore dhe detergjentë për familje në nevojë”. Në proces hartimi i dokumentacionit për realizimin e procedurave të mëtejshme.

- “Blerje koncentrat për blegtorinë”. Në proces hartimi i dokumentacionit për realizimin e procedurave të mëtejshme.

- “Blerje thasë rëre për mbrojtje nga përmytjet”. Në proces hartimi i dokumentacionit për realizimin e procedurave të mëtejshme.


O2. Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve.

Është realizuar pagesa e pagave, energjisë dhe ujit dhe shpenzimeve të tjera. Këto shpenzime janë në vazhdim gjatë gjithë vitit.

Realizimi i Buxhetit të planifikuara

mijë lekë

| Programi 03280 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|-----------------|---------------------|------------|-----------|---------|
| PBA 2023 | 41,808 | 8,097 | 111,434 | 1,000 | 162,339 |
| Plani fillestar 2023 | 55,062 | 26,660 | 125,468 | 17,041 | 224,231 |
| Plani i rishikuar 2023 | 55,062 | 27,045 | 62,712 | 34,149 | 178,968 |
| Realizimi viti 2023 | 26,836 | 5,470 | 4,907 | 149 | 37,362 |
| % e realizimit | 48.7% | 20.2% | 7.8% | 0.4% | 20.9% |



Realizimi i shpenzimeve për paga, shpenzime operative, transferime dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është 20.9%, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|--------------------|-------|
| Shpenzime korente | 25.7% |
| Shpenzime kapitale | 0.4% |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara:

- Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe certifikimi për MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë është në proces gjatë gjithë vitit e përgatitjes së dokumentacionit.
- Blerja dhe rimbushje e fikseve të zjarrit është në fazën e përgatitjes së dokumentacionit.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 8 Mujori 2023

| Kodi i Programit | 3280 | Emertimi i programit: | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | | | | | Komentet |
|--|---|---|---|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|----------|
| Qellimi 1 | Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimi i tyre, duke siguruar mbrojtjen e jetës së njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit, nëpërmjet sistemit të mbrojtjes civile. Perafrimi me standartet europiane të organizimit të mbrojtjes civile. Sigurimi I mbrojtjes civile në të gjithë territorin. Parandalimi. Informim public për reziqet dhe aktivitetet e organeve vendore përgjegjëse për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve në nivel lokal dhe administrimi i strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; | | | | | | | |
| **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit të Performancës/Produktit | Emertimi i Treguesit të Performancës***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhës | Niveli i planifikuar në vitin korent | Niveli i rishikuar në vitin korent | Niveli faktik në fund të vitit korent | % e Realizimit të Treguesit të Performancës/Produktit | |

| | | | | | | | | | |
|----------------------|--|----|--|-------|-----|-----|-----|------|--|
| Objektivi 1.1 | Strukturat per planifikimin, menaxhimin dhe përballimin e emergjencave civile | | | | | | | | |
| | | 1 | Numri i famljeve perfituese qe mbareshtojne blegtorine ne zonat e prekura nga permbytjet | 90 | 500 | 500 | 50 | 10% | |
| | | 2 | Numri i familjeve të trajtuara me shpërblim për fatkeqësi natyrore | 13 | 37 | 52 | 3 | 6% | |
| | | 3 | Numri i kontroleve sistematike vjetore për certifikimin për MZSH i objekteve të Bashkisë. | 120 | 145 | 145 | 108 | 74% | |
| | | 5 | Numri i projekteve teknike për masat e MZSH në institucione | 97 | 70 | 70 | 41 | 59% | |
| Objektivi 1.2 | Shërbim i përmirësuar i MZSH me prioritet parandalimin e ngjarjeve. | | | | | | | | |
| | | 6 | Numri i stacioneve të shërbimit te MZSH-së | 1 | 1 | 1 | 1 | 100% | |
| | | 7 | Zona e mbuluar nga shërbimi i MZSH në % | 29% | 29% | 29% | 29% | 100% | |
| | | 8 | Të ardhurat nga tarifat për shërbimin ndaj të tretëve (pajisja me çertifikata, etj) në mijë Lekë | 1,257 | 860 | 860 | 619 | 72% | |
| | | 9 | Reagim më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarre/Koha e daljes nga stacioni në sekonda | 60 | 60 | 60 | 50 | 83% | |
| | | 10 | Eficienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH/ lekë/rast të menaxhuar | 82 | 80 | 80 | 96 | 120% | |
| | | 11 | Numri i thirrjeve nga popullata drejt Shërbimit Zjarrfikës | 925 | 508 | 508 | 480 | 94% | |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmblledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| | | | |
|----------------------|---|-------------------------|-------------|
| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
| Programi | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | Kodi i Programit | 3280 |

| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2022) | Shpenzimet (sipas vitit 2022) | I | | II | | III | | IV | | Luhatjet në Koston për Njësi | | | Komente | | |
|------|---|------------------------------------|----------------------------------|-------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|--|---|-------------------------------------|--------------------------------|------------------------------|-------------|--------------|---------|----------|--|
| | | | | | Kosto për Njësi (sipas vitit 2022) | Sasia (sipas planit të vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2023) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2023) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | | | |
| 1 | Familje të trajtuara me ndihmë për blegtorinë në zonat e prekura nga përmbytjet | numër | 90 | 19,819 | 220.2 | 500 | 108,164 | 216.3 | 500 | 79,270 | 158.5 | 50 | 4,464 | 89.3 | -130.9 | -127.0 | -69.3 | |
| 2 | Familje të trajtuara me shpërblim për fatkeqësi natyrore | numër | 13 | 1,440 | 110.8 | 37 | 3,000 | 81.1 | 52 | 4,540 | 87.3 | 3 | 300 | 100.0 | -10.8 | 18.9 | 12.7 | |
| 3 | Pajisje për fikje zjarri funksionale | numër | 1,517 | 166 | 0.1 | 1,517 | 1,000 | 0.7 | 1,517 | 1,834 | 1.2 | 1,517 | 0 | 0.0 | -0.1 | -0.7 | -1.2 | |
| 4 | Ndihmë financiare për fatkeqësinë natyrore të shkaktuar nga termeti në Turqi | ndihma | | | | | 0 | | 1 | 3,477 | 3,477.0 | 1 | 3,477 | 3,477.0 | 3,477.0 | 3,477.0 | 0.0 | |
| 5 | Permirësimi i kushteve për kapacitetet teknike të MZSH | numri i ndërtesave të rikonstruara | | | | | 0 | | 1 | 2,298 | 2,298.0 | | | | 0.0 | 0.0 | -2,298.0 | |
| 6 | Projekte teknike për masat e MZSH | numër | 97 | 0 | 0.0 | 70 | 1,000 | 14.3 | 70 | 3,000 | 42.9 | | | | 0.0 | -14.3 | -42.9 | |
| 7 | Raste të menaxhuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi | numri i rasteve të menaxhuara | 546 | 44,505 | 81.5 | 615 | 49,175 | 80.0 | 615 | 49,240 | 80.1 | 303 | 29,121 | 96.1 | 14.6 | 16.1 | 16.0 | |

Sipas planifikimit për vitin 2023 në Programin “Mbrotjtja nga zjarri dhe mbrotjtja civile” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, situata e aktiviteteve për 8 mujorin 2023 paraqitet si më poshtë:

P03280.Q1.O1.A1. Struktura e mbrotjtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër & të trashëguara. Ky aktivitet është në proces gjatë vitit.

P03280.Q1.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëherëshme për familjet me raste fatkeqësie & të trashëguara. Ky aktivitet është në proces gjatë vitit.

P03280.Q1.O1.A3. Plotësimi dhe certifikimi për MZSH i pajisjeve për fikje zjarri i të gjithë institucioneve të Bashkisë & të trashëguara. Ky aktivitet është në proces gjatë vitit.

P03280.Q1.O1.A4. Ndihmë financiare për fatkeqësinë natyrore të shkaktuar nga tërmeti në Turqi. Ky aktivitet është realizuar.

P03280.Q1.O1.A5. Rikonstruksion godina ekzistuese e MZSH & të trashëguara. Për këtë aktivitet është hartuar projekti.

P03280.Q1.O2.A1. Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH i të gjitha objekteve në varësi të Bashkisë. Ky aktivitet është realizuar pjesërisht.

P03280.Q1.O2.A2. Shërbimi i Mbrotjtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Ky aktivitet është realizuar pjesërisht dhe vazhdon gjatë vitit.

| Produktet | Aktivitete /Projekte | Institucioni | Statusi I Aktiviteteve | Plani fillestar 2023 | Plani i rishikuar 2023 | Realizim i 8M 2023 |
|--|--|-----------------|-------------------------|----------------------|------------------------|--------------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Familje te trajtuara me ndihme per blegtorine ne zonat e prekura nga permbytjet (numer) | P03280.Q1.O1.A1. Struktura e mbrotjtjes civile dhe organizimi i strukturave vullnetare në Bashkinë Shkodër. & te trasheguara | Bashkia Shkodër | Realizuar dhe ne proces | 108,164 | 62,849 | 4,464 |
| | P03280.Q1.O1.A1 / 1 Fatkeqësi natyrore të menaxhuara "Reduktim i pasojave të përmbytjes në zonën e nën Shkodrës" | Bashkia Shkodër | Ne proces | - | 16,421 | - |

| | | | | | | |
|---|--|--|-------------------------|--------|--------|--------|
| Familje te trajtuara me shperblim per fatkeqesi natyrore (në numër) | P03280.Q1.O1.A2. Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie & te trashaguara | Bashkia Shkodër | Realizuar dhe ne proces | 3,000 | 4,540 | 300 |
| Pajisje për fikje zjarri funksionale (në numër) | P03280.Q1.O1.A3. Plotësimi dhe certifikimi për MZSH i pajisjeve për fikje zjarri i të gjithë institucioneve të Bashkisë & te trashaguara | Bashkia Shkodër | Ne proces gjate vitit | 1,000 | 1,834 | - |
| Mbeshtetje financiare per solidaritet - fatkeqesi natyrore | P03280.Q1.O1.A4 Ndhmë financiare për fatkeqësinë natyrore të shkaktuar nga termeti në Turqi | Bashkia Shkodër | E realizuar | - | 3,477 | 3,477 |
| Permiresimi i kushteve per kapacitetet teknike te MZSH | P03280.Q1.O1.A5. Rikonstruksion godina ekzistuese e MZSH- TE TRASHEGUARA | Bashkia Shkodër | Ne proces | - | 2,298 | - |
| Projekte teknike per masat e MZSH (në numër) | P03280.Q1.O2.A1. Plotësimi I dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH i të gjitha objekteve të varësi të Bashkisë. & te trashaguara | Bashkia Shkodër | Ne proces gjate vitit | 1,000 | 3,000 | - |
| Raste të menaxhuara për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (në numër) | P03280.Q1.O2.A2. Shërbimi I Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit & te trashaguara | Drejtoria e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit | Ne proces gjate vitit | 49,175 | 49,240 | 29,121 |

| | | | | | | |
|--|--|--|--|----------------|----------------|---------------|
| | | | | | | |
| | 03280 Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile | | | 162,339 | 143,659 | 37,362 |
| | Te trasheguara | | | 61,892 | 35,309 | - |
| | Totali | | | 224,231 | 178,968 | 37,362 |

FUNKSIONI 4: ÇËSHTJET EKONOMIKE

Programi 04130: Mbështetja për zhvillim ekonomik

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit ka për qëllim rritjen ekonomike nëpërmje tërheqjes së investitorëve të huaj dhe zhvillimi i NVM-ve. Kjo arrihet nga forcimi i bashkëpunimit ndërmjet pushtetit vendor, bizneseve dhe punëkërkesve, me qëllim promovimin e forcës aktive të punës, promovimin e produkteve dhe shërbimeve të bizneseve sipas sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Në mbështetje të biznesit, si institucion realizojme një sërë aktivitetesh në mbështetje të sipërmarrësve, përmendim këtu dhe panairë të përvitshme si një mënyrë shumë efektive për të vendë përballë njëri tjetrit të gjithë aktorët e interesuar në proces. Qëllimi është krijimi i një network-u që lidh aktorët e interesuar, shkëmben informacionet me synim zbutjen e papunësisë.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2023 në programin 04130 “Mbështetja për zhvillim ekonomik” ka qëllim të programit të saj këto funksione zhvillimi:

- Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal
- Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë
- Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panairë e reklama në vende publike
- Publikimi i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik.
- Dhënia e granteve dhe ndihmave financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël dhe të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi.

Objektivat për përmbushjen e këtyre funksioneve për 8-mujorin e vitit 2023 janë:

O1. Hartimi i Strategjive, Planeve Zhvillimore lokale dhe monitorimi i tyre në bashkëpunim me institucionet e specializuara dhe aktorët e interesuar.

O2. Programimi dhe zbatimi eficient i financimeve të programeve të BE-së dhe donatoreve të tjerë si dhe forcimi i marrëdhënieve me diasporën.

O3. Përmirësimi i Klimës së Biznesit përmes panairëve, ofrimit të shërbimeve mbështetëse, publikimit të materjaleve promovionale si dhe incentivave financiare në mbështetje të biznesit të vogël.

O4. Pjesëmarrje në skema kombëtare financimi

Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Bashkia Shkodër gjatë vitit 2023 në programin 04130 “Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi” ka fokusuar përpjekjet e saj në 1 funksion zhvillimi

- Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi

Objektivat për përmbushjen e këtyre funksioneve për 08-mujorin e vitit 2023 janë:

O1. Sistemi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës

Zhvillimi i Turizmit

Turizmi, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike me ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

I. Përshkrimi i funksioneve dhe objektivave

F1. Zhvillimi i Turizmit

Objektivat për secilin funksion janë:

F1.O1. Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promovionale dhe informative.

F2.O2. Organizim dhe pjesëmarrje në panaire lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

F3. O3 Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.

F4. O4 Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për zhvillimin e turizmit.


F5. O5 Hartim i planeve dhe studimeve të zhvillimit të turizmit nga bashkëpunimi me struktura të interesuara dhe universitetin.

F6. O6 Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre.

F6. O7. Përmirësim i infrastrukturës turistike dhe i aksesit.

Realizimi i buxhetit të planifikuar

| Programi 04130 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|-----------------|---------------------|------------|-----------|--------|
| PBA 2023 | | 5,400 | 12,800 | | 18,200 |
| Plani fillestar 2023 | | 13,310 | 13,101 | 82 | 26,493 |
| Plani i rishikuar 2023 | 127 | 17,210 | 26,201 | 82 | 43,620 |
| Realizimi viti 2023 | 127 | 734 | 12,762 | | 13,623 |
| % e realizimit | 100.0% | 4.3% | 48.7% | 0.0% | 31.2% |



Realizimi i shpenzimeve korente dhe kapitale për kete program krahasuar me planifikimin është në total 31.2% sipas zerave me poshte:

Shpenzime korente 31.3 %

Shpenzime kapitale 0 %



Faktoret qe kane ndikuar ne mosrealizimin e fondeve te planifikuara

Procedurat per zbatimin e aktiviteteve jane ne proces dhe do te perfundojne sipas parashikimit buxhetor. Per sa i perket programit 4130 aktivitetet jane te shtrira ne kohe pergjate vitit kalendarik/ buxhetor . Bashkia Shkodër me vendimin nr. 15 datë 20.7.2023 ka krijuar Sh.A. Bio Strajca me funksion administrimin e tregjeve të Bashkisë Shkodër. Fondi i ketij programi eshte shtuar me 10 000 000 leke dhe do shpenzohet per kete vite buxhetor per te mbeshtetur Sh.A Bio Strajca. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë aksionare është:

- a) Ofrimi i shërbimeve në fushën e zhvillimit ekonomik për mirëfunksionimin e tregjeve publike dhe rrjetit të tregtisë.
- b) Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj komunitetit.
- c) Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, tregjeve të kafshëve të gjalla, thertoret etj.

| | | | | | | | | | |
|----------------------|---|----|---|-----|-----|-----|-----|------|--|
| | diasporen. | | | | | | | | |
| | | 3 | Projekte të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare | 16 | 6 | 6 | 7 | 117% | |
| | | 4 | Aktivite informuese | 40 | 45 | 45 | 30 | 67% | |
| | | 5 | Persona të informuar | 0 | 320 | 320 | 160 | 50% | |
| <i>Objektivi 1.3</i> | Permiresimi i Klimes se Biznesit permes panairove, ofrimit te sherbimeve mbeshtetese, publikimit te materjaleve promocionale si dhe incentivave financiare ne mbeshtetje te biznesit te vogel. | | | | | | | | |
| | | 6 | b2b me sipermarres evropian | 0 | 30 | 30 | 30 | 100% | |
| | | 7 | Publikime dhe botime | 0 | 5 | 1 | 0 | 0% | |
| | | 8 | Iniciativa të biznesit të mbështetura financiarisht | 200 | 120 | 120 | 120 | 100% | |
| | | 9 | Nxitja për zhvillim e bizneseve AGRO | 0 | 25 | 25 | 25 | 100% | |
| | | 10 | Biznese të asistuar për aplikime në programe dhe skema financiare | 25 | 25 | 25 | 25 | 100% | |
| | | 11 | Shërbimi pranë zyrës QKB | 4 | 4 | 0 | 0 | | |
| <i>Objektivi 1.4</i> | Pjesmarrje në skema kombëtare financimi | | | | | | | | |
| | | 12 | Të rinj të aftësuar | 0 | 50 | 0 | 0 | | |
| Qellimi 2 | Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë; | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|----------------------|--|----|---|------|------|------|-----|------|--|
| Objektivi 2.1 | Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës. | | | | | | | | |
| | | 13 | Numri i vendeve të shitjes në tregje publike të mirëmbajtura (paguese e shërbimeve utilitare dhe riparim vende shitjeje) | 120 | 120 | 120 | 120 | 100% | |
| Qellimi 3 | Nxitja e zhvillimit të turizmit të zonës dhe rritja e vlerës së territorit të Bashkisë Shkodër, si destinacion turistik, duke forcuar identitetin e saj unik kulturor, social, mjedisor dhe ekonomik. | | | | | | | | |
| Objektivi 3.1 | Promovim i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promovuese dhe informative. | | | | | | | | |
| | | 14 | Numri i materialeve promovuese të prodhuara. (harta dhe guida etj) | 1800 | 7000 | 7000 | 0 | 0% | |
| | | 15 | Numri i platformave promovuese të prodhuara | 0 | 2 | 2 | 2 | 100% | |
| Objektivi 3.2 | Organizim dhe pjesëmarrje në panairë lokale, kombëtare dhe ndërkombetare. | | | | | | | | |
| | | 16 | Numri panairëve të organizuara dhe ku është marrë pjesë | 1 | 2 | 2 | 2 | 100% | |
| | | 17 | Pjesëmarrës në festivalin e kulinare | | 45 | 45 | 0 | 0% | |
| Objektivi 3.3 | Organizimi i aktiviteteve për promovimin e ofertave dhe produkteve turistike të Bashkisë Shkodër. | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---------------|---|----|--|---------|---------|---------|---------|------|--|
| | | 18 | Numri i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Turizmit | 7 | 6 | 6 | 4 | 67% | |
| Qellimi 4 | Funksionimi i zyrave vendore turistike përmes koordinimit të aktorëve dhe strukturave përgjegjëse në industrinë turistike; Marketing i vlerave dhe potencialeve të komunitetit. | | | | | | | | |
| Objektivi 4.1 | Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave të dedikuara për zhvillimin e turizmit. | | | | | | | | |
| | | 19 | Numri i turistëve (i personave) të akomoduar në hotele. | 292,857 | 297,143 | 297,143 | 134,489 | 45% | |
| | | 20 | Të ardhura nga taksa e taksat vendore në 000/Lekë e realizuar | 364,037 | 364,326 | 364,326 | 198,440 | 54% | |
| | | 21 | Numri i turistëve që marrin informacion / shërbehen në zyrën e informacionit | 9,800 | 7,600 | 7,600 | 12,000 | 158% | |
| Objektivi 4.2 | Ngritje e kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre. | | | | | | | | |
| | | 22 | Biznese turistike të mbështetura (ide inovative për zhvillimin e turizmit të qëndrueshem) | | 5 | 5 | 1 | 20% | |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbljedhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| | | | |
|---------------|----------------------------------|------------------|------|
| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
| Programi | Mbështetja për zhvillim ekonomik | Kodi i Programit | 4130 |

| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2022) | Shpenzimet (sipas vitit 2022) | I Kosto për Njësi (sipas vitit 2022) | Sasia (sipas planit të vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2023) | II Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2023) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | III Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | IV Kosto për Njësi Faktike (viti 2023) | Luhatjet në Koston për Njësi | | | Komentet |
|------|---|----------------------------------|----------------------------------|-------------------------------|---|------------------------------------|---|--|--|---|---|---------------------------|--------------------------------|---|------------------------------|-------------|--------------|--|
| | | | | | | | | | | | | | | | V = IV - I | V = IV - II | V = IV - III | |
| 1 | Dokumenti i monitorimit të strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër | dokumenti | 1 | 0 | 0.0 | 1 | 0 | 0.0 | 1 | 0 | 0.0 | 1 | 0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | në proces |
| 2 | OSHC me kapacitete të forcuara | numër OSHC | 16 | 0 | 0.0 | 13 | 0 | 0.0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | në proces |
| 3 | Projekte të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare | numër projektesh | 16 | 371 | 23.2 | 6 | 900 | 150.0 | 6 | 900 | 150.0 | 7 | 0 | 0.0 | -23.2 | -150.0 | -150.0 | në proces |
| 4 | Aktivite informuese | numër aktivitetesh | 40 | 0 | 0.0 | 45 | 100 | 2.2 | 45 | 100 | 2.2 | 30 | 0 | 0.0 | 0.0 | -2.2 | -2.2 | në proces |
| 5 | Persona të informuar | numër personash | | | | 80 | 300 | 3.8 | 80 | 300 | 3.8 | 30 | 0 | 0.0 | 0.0 | -3.8 | -3.8 | në proces |
| 6 | B2B me sipërmarres evropian | numër panairesh | | | | 30 | 3,000 | 100.0 | 30 | 3,000 | 100.0 | 30 | 0 | 0.0 | 0.0 | -100.0 | -100.0 | në proces |
| 7 | Publikime dhe botime | numër botimesh | | | | 5 | 700 | 140.0 | 1 | 700 | 700.0 | 1 | 0 | 0.0 | 0.0 | -140.0 | -700.0 | në proces |
| 8 | Iniciativa të biznesit të mbështetura financiarisht | numër biznesesh | 200 | 1,524 | 7.6 | 120 | 1,600 | 13.3 | 120 | 1,662 | 13.9 | 120 | 62 | 0.5 | -7.1 | -12.8 | -13.3 | në proces |
| 9 | Nxitja për zhvillim e bizneseve AGRO | numër sipërmarrësish | | | | 25 | 1,500 | 60.0 | 25 | 1,500 | 60.0 | 25 | 0 | 0.0 | 0.0 | -60.0 | -60.0 | në proces |
| 10 | Biznese të asistuar për aplikime në programe dhe skema financiare | numri i bizneseve të asistuar | 25 | 0 | 0.0 | 25 | 300 | 12.0 | 25 | 300 | 12.0 | 25 | 0 | 0.0 | 0.0 | -12.0 | -12.0 | në proces |
| 11 | Shërbimi pranë zyrës QKB | numër shërbimesh | 4 | 1,606 | 401.5 | 4 | 0 | 0.0 | 4 | 127 | 31.8 | 4 | 127 | 31.8 | -369.8 | 31.8 | 0.0 | Realizuar |
| 12 | Të rinj të aftësuar | numër të rinjsh | | | | 50 | 0 | 0.0 | 0 | 7,000 | | 0 | 7,000 | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | Realizuar. Është kthyer fondi te Ministria përkatëse |
| 13 | Mirëmbajtja e tregjeve ekzistuese | numri i tregjeve të mirëmbajtura | 120 | 124 | 1.0 | 120 | 1,000 | 8.3 | 120 | 11,014 | 91.8 | 120 | 2,585 | 21.5 | 20.5 | 13.2 | -70.2 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|---|--|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|---|-------|---------|---------|--------|--------|--|
| 14 | Platforma të ndryshme elektronike të mirëmbajtura | numër | 0 | 0 | | 2 | 500 | 250.0 | 2 | 1,300 | 650.0 | 0 | 0 | | 0.0 | -250.0 | -650.0 | |
| 15 | Materiale promovionale te publikuara dhe te prodhuara. | copë | 1,800 | 572 | 0.3 | 7,000 | 1,400 | 0.2 | 7,000 | 1,950 | 0.3 | 0 | 0 | | -0.3 | -0.2 | -0.3 | |
| 16 | Organizim panairi | numri i qyteteve | 1 | 498 | 498.0 | 4 | 700 | 175.0 | 4 | 700 | 175.0 | 1 | 0 | 0.0 | -498.0 | -175.0 | -175.0 | |
| 17 | Pjesemarrje në panaire | numër | 1 | 150 | 150.0 | 2 | 600 | 300.0 | 2 | 700 | 350.0 | 2 | 649 | 324.5 | 174.5 | 24.5 | -25.5 | |
| 18 | Pjesemarrës Festivali i Kulinarisë " Shife" | numër | | | | 45 | 1,000 | 22.2 | 45 | 1,500 | 33.3 | 0 | 0 | | 0.0 | -22.2 | -33.3 | |
| 19 | Organizim i aktiviteteve | numër | 7 | 2,558 | 365.4 | 6 | 3,600 | 600.0 | 6 | 3,100 | 516.7 | 4 | 2,200 | 550.0 | 184.6 | -50.0 | 33.3 | |
| 20 | Vazhdimi i shërbimit të Zyrave të informacionit turistik | numri i zyrave te informacionit turistik | 2 | 168 | 84.0 | 2 | | 0.0 | 2 | | 0.0 | | | | -84.0 | 0.0 | 0.0 | |
| 21 | Iniciativa te reja te mbeshtetura të sektorit të biznesit të turizmit | numër | 0 | 0 | | 5 | 1,000 | 200.0 | 5 | 1,000 | 200.0 | 1 | 1,000 | 1,000.0 | 1,000.0 | 800.0 | 800.0 | |

Gjatë 08 mujorit të vitit 2023 është punuar për përmbushjen e objektivave nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të parashikuara në Buxhetin e Bashkisë Shkodër për Programin 04130.

Tabela e produkteve dhe realizimi i tyre nga pikpamja financiare.

| Produktet | Aktivitete /Projekte | Institucioni | Statusi I Aktiviteteve | Plani fillestar 2023 | Plani i rishikuar 2023 | Realizimi 8M 2023 |
|---|--|-----------------|--|----------------------|------------------------|-------------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Dokumenti monitorimit të strategjise territoriale të zhvillimit të Bashkise Shkoder (numër) | P04130.Q1.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër | Bashkia Shkodër | Ne proces | - | - | - |
| OSHC me kapacitete te forcuara (numër) | P04130.Q1.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve. | Bashkia Shkodër | Ne proces | - | - | - |
| Projekte të aplikuara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera nderkombëtare (në numër) | P04130.Q1.O2.A1. Pjesëmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi European, Organizata të tjera ndërkombëtare dhe kombetare si dhe anëtarësimi në shoqata ndërkombëtare. | Bashkia Shkodër | Pagesa e antarsimit behet ne muajin Tetor | 900 | 900 | - |
| Projekte të fituara sipas programeve të financuara nga BE dhe organizata të tjera nderkombëtare (numër) | | | | | | |
| Aktivite informuese (numër) | P04130.Q1.O2.A2. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit European nëpërmjet Këndit të BE Shkodër, | Bashkia Shkodër | Organizuar me 19 maj. Me fondet e Europe House | 100 | 100 | - |
| Persona të informuar (numër) | P04130.Q1.O2.A3.Diasp ora dhe migracioni | Bashkia Shkodër | Realizimi me 18 Dhjetor per ditën kombetare te Diaspores | 300 | 300 | - |
| b2b me sipërmarres evropian | P04130.Q1.O3.A1. Rrjeti european per sipërmarrjen rinore | Bashkia Shkodër | Ne proces | 3,000 | 3,000 | - |

| | | | | | | |
|---|--|-----------------|---|-------|--------|-------|
| Publikime dhe botime (numër) | P04130.Q1.O3.A2. Materiale / fushatë promovionale në funksion të promovimit të bizneseve të territorit | Bashkia Shkodër | Ne proces | 700 | 700 | - |
| Iniciativa të biznesit të mbështetura financiarisht (numër) | P04130.Q1.O3.A3. Bashkëpunimi me Zonën e permirësimit të biznesit ne Shkoder & te trasheguara | Bashkia Shkodër | realizuar pjeserisht, Ne proces per tu perfunduar marreveshja | 1,600 | 1,662 | 62 |
| Nxitja për zhvillim e bizneseve AGRO | P04130.Q1.O3.A4. Zhvillim I qëndrueshem / mbështetje e bizneseve Agro | Bashkia Shkodër | ne proces | 1,500 | 1,500 | - |
| Biznese të asistuar për aplikime në programe dhe skema financiare (numër) | P04130.Q1.O3.A5.krijimi I nje skeme garancie per bizneset eko-inovative | Bashkia Shkodër | ne proces | 300 | 300 | - |
| Sherbimi prane zyres QKB | P04130.Q1.O3.A6Shërbi met e deleguara të QKB | Bashkia Shkodër | Realizuar , tashme nuk ekzistojme me zyrat e qkb | - | 127 | 127 |
| Te rinj te aftesuar | P04130.Q1.O4.A1 Ndërtimi i një qendre rinore për zhvillimin e sipërmarrjes dhe inovacionit | Bashkia Shkodër | realizuar, kthyer fondi tek Min. perkatese | - | 7,000 | 7,000 |
| Mirëmbajtja e njësive të tregjeve publike ekzistuese (pagese e sherbimeve utilitare dhe riparim vende shitjeje) (në numër) | P04130.Q2.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese & te trasheguara | Bashkia Shkodër | Realizuar pjeserisht, likujdimi ne proces. Krijuar Bio Strajca sh.a me vkb 15 dt 20.07.2023 | 1,000 | 11,014 | 2,585 |
| Njësi në tregje publike të investuara (numër) | P04130.Q2.O1.A2. Tregu rajonal i peshkut | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| | P04130.Q2.O1.A3. Tregu I produkteve bujqësore Velipojë | Bashkia Shkodër | | - | - | - |

| | | | | | | |
|--|--|-----------------|-----------|-------|-------|-----|
| | P04130.Q2.O1.A4. Ndërtimi i tregut multifunksional të produkteve agro-ushqimore lokale | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| Platforma të ndryshme elektronike të mirembajtura (në numër) | P04130.Q3.O1.A1. Hostim, mirembajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për web sitin e turizmit. | Bashkia Shkodër | ne proces | - | - | - |
| | P04130.Q3.O1.A2.Hostim , mirëmbajtje , përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit & te trashëguar | Bashkia Shkodër | 1 | 500 | 1,300 | - |
| Materiale promovionale të publikuara dhe të prodhuara. (në numër) | P04130.Q3.O1.A3. Prodhim, publikim dhe botim I materialeve promovionale | Bashkia Shkodër | në proces | 1,400 | 1,400 | - |
| Organizim panairi (numër) | P04130.Q3.O2.A1.Stenda levizëse "Vizito Shkodren" | Bashkia Shkodër | në proces | 700 | 700 | - |
| Pjesëmarrje në panairë (numër) | P04130.Q3.O2.A2. Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës & te trashëguar | Bashkia Shkodër | realizuar | 600 | 700 | 649 |
| Materiale promovionale të publikuara dhe të prodhuara. (në numër) | P04760.O1.A3. Përditësim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër te trashëguar | Bashkia Shkodër | ne proces | | 300 | - |
| Materiale promovionale të publikuara dhe të prodhuara. (në numër) | P04760.O1.A4. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër te trashëguar | Bashkia Shkodër | ne proces | | 250 | - |
| Pjesëmarrës (numër) | P04130.Q3.O2.A3. Festivali I Kulinarise " Shife" | Bashkia Shkodër | në proces | 1,000 | 1,500 | - |

| | | | | | | |
|--|--|-----------------|--|---------------|---------------|---------------|
| Organizim I aktiviteteve (numër) | P04130.Q3.O3.A1. Festa e Liqenit | Bashkia Shkodër | realizuar | 600 | 600 | 600 |
| | P04130.Q3.O3.A2. Hapja e sezonit turistik Velipoje | Bashkia Shkodër | realizuar | 800 | 800 | 800 |
| | P04130.Q3.O3.A3. Festa e Alpeve | Bashkia Shkodër | realizuar | 800 | 800 | 800 |
| | P04130.Q3.O3.A4. Dita e biçikletave | Bashkia Shkodër | në proces | 400 | 400 | - |
| | P04130.Q3.O3.A5. Triathlon | Bashkia Shkodër | ne proces | 500 | 500 | - |
| | P04130.Q3.O3.A6. Lojra Popullore Fest | Bashkia Shkodër | transferuar fondi tek fisheP04130.Q3.O2.A3 | 500 | - | - |
| Vazhdimi i shërbimit të Zyrave të informacionit turistik (në numër) | P04130.Q4.O1.A1. Rrjeti i Zyrave të informacionit turistik Qyteti Shkodër, Velipojë, Theth | Bashkia Shkodër | në proces | - | - | - |
| Iniciativa te reja te mbeshtetura të sektorit të biznesit të turizmit të (ne numër) | P04130.Q4.O2.A1.Mbësh tetja e iniciativave të reja në mbështetje të zhvillimit të turizmit | Bashkia Shkodër | realizuar | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | 04130Mbeshtetja per zhvillim ekonomik | | | 18,200 | 36,853 | 13,623 |
| | Te trasheguara | | | 8,293 | 6,767 | - |
| | Totali | | | 26,493 | 43,620 | 13,623 |

Përshkrimi i aktiviteteve

P04130.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor realizohet në fund të çdo viti buxhetor.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021 - 2023, duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit me projektet e parashikuara në secilin nga programet buxhetore të Bashkisë Shkodër. Mbi bazën e këtij parimi është realizuar kuadri logjik i PBA-së dhe është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Prandaj monitorimi i ecurisë së zbatimit u bë mbështetur në informacionet për gjendjen e zbatimit dhe të financimit të projekteve të strategjisë deri në prill të vitit 2023.

Për të adresuar 5 objektivat strategjike të planifikuara në këtë plan janë parashikuar 198 projekte. Në përfundim të monitorimit të zbatimit të strategjisë territoriale Shkodër, deri në prill 2023 raportohen 16 projekte të zbatuara, 87 projekte në proces zbatimi dhe 95 projekte të pa nisura për zbatim. Pjesa më e madhe e projekteve të parashikuara në matricën e projekteve strategjike janë projekte infrastrukture.

Në kuptim të zbatimit të objektivave të strategjisë, objektivat 1, 2 dhe 3 vlerësohen me ecurinë më të mirë të zbatimit, Objektivat 4 dhe 5 vlerësohen ecurinë më të ulët të zbatimit.

P04130.O1.A3. Pjesmarrje në programet dhe projektet e financuara nga Bashkimi European dhe Organizata të tjera ndërkombëtare.

Procesi i integritimit evropian përkthehet në negocimin e 33 kapitujve të Acquis së BE dhe kërkon përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë, ku një rol të rëndësishëm luan edhe qeverisja vendore. Pothuajse 50-70% e kuadrit ligjor të BE-së duhet të zbatohet në nivel vendor prandaj acquis-i i BE-së ka një ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Duke e konsideruar integrimin në BE si perspektivën më të mirë të zhvillimit dhe si një sfidë e përbashkët e vendeve të rajonit, Bashkia Shkodër ka promovuar iniciativën e bashkëpunimit të zgjeruar rajonal, duke lidhur marrëveshje bashkëpunimi me disa qytete në rajon, me lidhje të hershme ndër shekuj dhe me vlera që na bashkojnë në fushën ekonomike, kulturore e njerëzore. Konsolidimi i këtij bashkëpunimi është i rëndësishëm së veçantë jo vetëm për gjenerimin e ideve për të intensifikuar bashkëpunimin rajonal por edhe në terheqjen e fondeve të Bashkimit European, në kuadër të programeve të ndryshme ndërkufitare.

Pjesë e kësaj fishe do të jetë edhe mbulimi i shpenzimeve për projektet e shpallura fituese në kuadër të programeve kombëtare, programeve të financuara nga BE dhe anëtarësimi në organizata ndërkombëtare. Momentalisht jemi në fazën e përfundimit të nënshkrimit të marrëveshjes për një projekt dhe në fazë vlerësimi të pesë aplikimeve të tjera. Përmbushja e detyrimeve do të realizohet rast pas rasti, brenda vitit buxhetor 2023.

P04130.O1.A4. Organizimi i aktiviteteve informuese dhe promovuese mbi programet dhe projektet e Bashkimit European nepermjet Kendit te BE Shkoder

Struktura e Integritimit Evropian ka për qëllim të organizojë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Integritimit Evropian. Të sigurojë programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia. Sa më sipër ky sektor do të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e parimeve të BE-së në nivel vendor duke organizuar aktivitete të ndryshme informuese dhe promovuese mbi politikën, programet dhe projektet e Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim çdo muaj sektori i integritimit evropian Shkodër organizon minimalisht 2 aktivitete në

muaj sipas tematikave të caktuara dhe sipas ditëve evropiane dhe ndërkombëtare. Këto aktivitete organizohen në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, shkollat 9 vjeçare, të mesme të përgjithshme dhe profesionale, Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi, etj. Numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete varion nga 20 pjesëmarrës, në rastin e takimeve me fokus grupet deri në 400 pjesëmarrës në rastin e aktiviteteve të mëdha promovuese. Fondi i parashikuar për realizimin e këtyre aktiviteteve të tilla si: java e europes 2023, dita e xhubletës, shetitje me biçikleta, europa ne syte e femijeve, photo exhibition, takime informuese ne kuader te projektit BSF, etj, gjatë 8 mujorit të vitit 2023 është mbuluar nga fondet e projektit Bashkitë për në Europe dhe Europe House. Aktivitetet janë të parashikuara të zhvillohen gjatë gjithë vitit 2023.

P04130.Q1.O2.A3.Diaspora dhe migracioni

Me funksionet e shtuara të pushtetit vendor në lidhje me çështjet e migracionit dhe diasporës, Bashkisë Shkodër i lind detyrimi dhe përgjegjësia që nga njëra anë të kontribuojë në ri-integrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të emigrantëve duke respektuar, mbrojtur dhe përbushur të drejtat e tyre njerëzore, dhe në të njëjtën kohë të krijojë kushte të favorshme, të cilat i mundësojnë diasporës, përmes kapaciteteve të tyre intelektuale, njerëzore, ekonomike dhe sociale, të pasurojë shoqërinë tonë, për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm në nivel lokal.

Në këtë kuadër lind nevoja e informimit të publikut mbi kompetencat, ndihmën dhe mundësitë që Bashkia Shkodër ofron për këto dy kategori: nga njëra anë emigrantet e kthyer, të cilët duan të rikthehen, të jetojnë dhe të kontribuojnë në vendin e tyre dhe nga ana tjetër diaspora, e cila ruan dhe kërkon të çojë përpara lidhjen shpirtërore me vendin e origjinës duke kontribuar në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike.

Aktiviteti do të zhvillohet ditën kombëtare të diasporës me 18 dhjetor 2023.

P04130.Q1.O3.A1. Rrjeti european per sipermarrjen rinore

Rrjeti european i sipërmarrjes rinore ka për qëllim të bashkojë vendin tonë me vendet e BE-së, si një model i suksesshëm dhe projekt i vetëm evropian me objektiv zhvillimin e përbashkët, duke besuar fort në rindërtimin ekonomik dhe tregjeve të përbashkëta, e cila mund të arrihet më mirë në nivel evropian sesa vetëm kombëtar. Hapja dhe zgjerimi gradual i tregjeve kreative të përbashkëta, do të rrisin investimet dhe në të ardhmen, do të përgatisin ekonominë tona më mirë për tregun e përbashkët evropian. Sektorët potencial që priten të takohen në këtë event të rëndësishëm janë Turizmi, Agro Produktet dhe punimet kreative tradicionale të vendit tonë. Ndërtimi i një rrjeti me sipërmarrës të rinj nga Shqipëria dhe vendet e Europës me qëllim shkëmbimin e eksperiencave, të ideve të suksesshme etj. Duke synuar modele suksesi evropiane besojmë se ky rrjet do të jetë një nxitje e mirë për të tërhequr investimet e huaja në vendin tonë. Sipërmarrës të rinj nga vende të ndryshme të europës të cilët kanë ide dhe mundësi financimi për biznese interesante dhe kreative në Shqipëri do të takohen në këtë forum që do të organizohet në territorin e Bashkisë Shkodër. Aktiviteti është i planifikuar të zhvillohet përgjate vitit buxhetor 2023, jemi ne faze testimi tregu per organizimin e aktivitetit.

P04130.Q1.O3.A2. Materiale/ fushatë promovionale në funksion të promovimit të bizneseve të territorit

Bashkia Shkodër vazhdon të jetë një nga kryeqendrat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, kjo për shkak të trashëgimisë, shpirtit sipërmarrës që karakterizon popullsinë si dhe vendndodhjes gjeografike. Qyteti i Shkodrës si qendër e zhvillimit të rajonit të veriut mban rolin e motorit të rritjes ekonomike edhe për njësitë e tjera administrative që e përbëjnë atë.

Për këtë qëllim synojmë hartimin e materialit informative i cili përcakton drejtimet që duhen ndjekur në të ardhmen, duke u fokusuar në burimet ekzistuese. Ndaj objektivi jonë është përkthimi i shumëllojshmërisë së avantazheve konkurruese në mundësi për investime vendase dhe të huaja, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Ne vazhdim do të zbatohet një fushatë promociionale në funksion të promovimit të bizneseve të territorit. Aktualisht sipërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme janë burimi kryesor i të ardhurave ekonomike. Kjo fushatë promociionale, që përmban video, infografi, gift, etj. do të realizohet nëpërmjet rrjeteve sociale, faqeve web si dhe në platformat digjitale

Aktiviteti është në proces dhe do të zhvillohet përgjatë vitit buxhetor 2023

P04130.Q1.O3.A3 Bashkëpunimi me Zonën e Përmirësimit të Biznesit në Shkodër

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro–Amerikan) vazhdon në mënyrë të suksesshme projektin e mbështetjes së përmirësimit të biznesit përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”. Në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e klimës së biznesit në zonë, Shoqata e bizneseve ka ofruar shërbime publike shtesë, ka zhvilluar një sërë aktivitetesh kulturore, argëtuese, disa prej të cilave edhe në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Ka ofruar konsulencë profesionale për bizneset e zonës me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Nga ana tjetër, është përmirësuar ndjeshëm cilësia e shërbimeve të ofruara nga bizneset në këtë zonë. Në këtë kuadër vazhdimi i bashkëpunimit me shoqatën e bizneseve në shërbim të përmirësimit të zonave të biznesit do të realizohet me anë të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe shoqatës egzistuese të bizneseve përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”.

Hapsira publike do të trajtohet me rigorozitet sipas vendimit të Këshillit të rregullimit të Territorit Qëllimi i këtij bashkëpunimi është mbështetja e biznesit të vogël për t’u konsoliduar, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së shërbimeve të zonës së përmirësimit të biznesit, për ta kthyer atë në një vend tërheqës për vizitorin.

Akoma nuk është dakordësuar marrëveshja. Aktiviteti është në proces.

P04130.Q1.O3.A4. Zhvillim i qëndrueshëm/mbështetje e bizneseve Agro

Territori i Bashkisë Shkodër, si nga morfologjia e territorit dhe burimet natyrore ashtu dhe nga mënyra e zhvillimit është një territor shumë i larmishëm dhe dinamik. Si i tillë përveç potencialeve të shumta natyrore, paraqet edhe potenciale të trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të zonës. Qyteti, zona fushore dhe malore e Bashkisë Shkodër janë dalluar për prodhimet artizanale si punimet prej thupre, bakri, argjendi e druri, qëndisimat, qilimat, etj. Gjithashtu e gjithë zona është karakterizuar nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale si një nga sektorët që i lidh të gjitha njësitë administrative. Fermerët e njësive administrative tashmë kanë filluar të zhvillojnë edhe sektorin agroturistik, mirëpo është parë e nevojshme të mbështeten nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit të sipërmarrësve të rinj mbi mënyrën e përpunimit, tregtimit, promovimit me anën e përfshirjes së tyre në rrjete të reja tregtare.

Po kështu promovimi i produkteve vendore të sipermarrjeve të reja dhe atyre egzistuese në njesite administrative do t'i shërbejë rritjes social-ekonomike të gjithë territorit dhe përmirësimin e jetës së komunitetit.

Po përgatiten materialet për tenderim për organizimin e aktiviteteve që do mbështesin iniciativat e reja Agro përgjate këtij viti.

P04130.Q1.O3.A5. Krijimi i një skeme garancie për bizneset eko-inovative.

Vendi jonë është tashmë pjesë e rrjetit evropian të NMV-ve. Zbatimi i politikave pro aktive për të mbështetur rritjen e kapaciteteve të NMV-ve mbetet një sfidë. Parë në këtë këndvështrim, inkurajimi i iniciativave që nxisin dhe zhvillojnë bizneset e reja dhe egzistuese është shumë i rëndësishëm për ndërtimin e një ekonomie të fortë, konkurruese dhe inovative. Kur këto iniciativa ndërthurin sëbashku konceptet e ekonomisë, ekologjisë dhe inovacionit, krijojnë një model të ri zhvillimi ekonomik, të aftë për t'ju përgjigjur sfidave të zhvillimit pa dëmtuar mjedisin. Një qasje e tillë quhet eko-inovacion dhe është termi më ri botëror. Eko-inovacioni i referohet të gjitha formave të inovacionit teknologjik dhe jo vetëm, produkteve dhe shërbimeve të reja që krijohen me qëllim zhvillimin e mundësive të reja të bërit biznes, duke parandaluar ose zvogëluar ndikimet negative në mjedis, ose duke optimizuar shfrytëzimin e burimeve natyrore

Qëllimi jonë është të promovojmë një model të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik, miqësor ndaj mjedisit, për t'i dhënë proceseve, produkteve dhe shërbimeve të NMV-ve një vlerë të shtuar në treg. Në këtë kontekst është shumë e rëndësishme të ndërtohen kapacitetet e të rinjve me aftësitë e nevojshme për një ekonomi të gjelbër.

Në këtë kuadër Bashkia Shkodër synon të mbështesë dhe nxisë inovacionin për ide biznesi të gjelbërta tek tek të rinjtë që dëshirojnë të krijojnë biznese të gjelbërta, të bazuara në shfrytëzimin e burimeve vendore, duke pasur një qasje miqësore ndaj mjedisit.

Një skemë granti do të hartohet në bashkëpunim me institucionet financiare dhe institucionet e tjera përgjegjëse në mbështetje të start up-eve, por edhe bizneseve të vogla dhe të mesme egzistuese. Përfitues do të jenë shtetasit shqiptarë të moshës 18- 30 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër të cilët kanë një ide apo kanë një biznes egzistues të vogël ose të mesëm dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese eko-inovative. Në rastin kur aplikimi i individëve është shpallur fitues, Bashkia Shkodër do të kërkojë regjistrimin e tij si një entitet ligjor përpara nënshkrimit të kontratës dhe disbursimit të fondeve.

Aktiviteti do realizohet përgjate vitit 2023 dhe po punohet për përgatitjen e skemes mbështetëse.

P04130.Q1.O3.A6 Shërbimet e deleguara të QKB

Me ane të këtij aktiviteti është kryer procesi i likuidimit të pagave dhe sigurimeve shoqërore për muajin Dhjetor për vitin 2022, për punonjësit që kanë qene pjesë e këtij shërbimi të ofruar për bizneset.

P04130.Q1.O4.A1 Ndërtimi i një qendre rinore për zhvillimin e sipërmarrjes dhe inovacionit

Bashkia Shkodër me Projektin: “Ndërtimi i një qendre rinore për zhvillimin e sipërmarrjes dhe inovacionit”, është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime të shpallur nga Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për mbështetjen e Startup-eve dhe Lehtësuesve të Startup-eve. Ky projekt parashikon krijimin e një akademie sipërmarrjeje dhe inovacioni për të rinjtë

dhe bizneset duke transferuar tek ato njohuri rreth teknikave të projektimit, gjenerimit të idesë, zhvillimit të idesë dhe shndërrimit në një startup si dhe njohuri mbi teknologjitë e reja ICT dhe aplikimin e tyre në biznese të ndryshme. Integrimi i zhvillimeve teknologjike dhe inovacionit, parë edhe moshën e personave që përfshihen në startup-e do të mundësojë krijimin e iniciativave të reja, për zhvillimin e bizneseve.

Projekti do të zbatohet me seli qendrën rinore “Atelie” si një HUB i cili tashmë ka shumë të rinj dhe të reja që e frekuentojnë dhe angazhohen në projektet e ndryshme.

Vendndodhja është e përkryer për të centralizuar në një vend unik aktivitetet operative të të gjithë aktorëve.

Qendra e Inovacionit Qendra Rinore “ATELIE” do të jetë selia ideale e projektit dhe e vijimësisë së tij në formë të qëndrueshme edhe për vitet në vazhdim. Mobilimi dhe krijimi i hapsirave të punës të plotësuara me kompjutera dhe pajisje digitale e informatike në shërbim të krijimit të mundësive për gjenerim të startup-ve. Qendra e inovacionit do të jetë lokacioni ideal për të pritur të gjithë stafin organizativ të projektit dhe vendi i përsosur për kurset e trajnimit.

“Zhvillimi i teknologjive dhe shërbimeve të integruara të komunikimit, për marketingun me një qasje inovatore” do të krijohet tërësisht nga pjesëmarrësit e kursit.

Përmbajtja do të prodhohet në të gjitha formatet e ndryshme të nevojshme për “Zhvillimin e teknologjive dhe shërbimeve të integruara të komunikimit, për marketingun me një qasje inovatore” Phygital në shërbim të bizneseve dhe aktiviteteve të ndryshme. Duke qënë se sektori i turizmit do të vijojë të jetë prioritar, krijimi i parakushteve infrastrukturore të teknologjisë inovative të marketingut dhe promovimit është shumë i rëndësishëm për të qëndruar një hap me kërkesat e turistëve dhe vizitorëve. Vendi ynë ka një numër gjithnjë e në rritje të turistëve të cilët përveç shijimit të bukurive natyrore duan të marrin edhe informacion për atraksionet e ndryshme përmes teknologjisë dhe inovacionit në mënyra sa më kreative.

Target grupet kryesore përfituese të projektit janë:

Të rinjtë dhe të rejtat që do të angazhohen në projekt, me një raport 60% me 40% gra kryesisht moshë 18-35 vjeç. Të gjithë të rinjtë e Shkodrës dhe njësisë administrative, të cilët kanë ide dhe dëshirë për të zhvilluar një biznes startup por nuk kanë hapsira pune, do të kenë akses në qendrën e inovacionit për të zhvilluar konkretisht idetë e tyre.

Buxheti i Projektit:

Buxheti total i projektit është 7,777,778 Lekë pa tvsh, nga të cilat financimi i Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes do të jetë në masën 90% të kostove të pranueshme në vlerën 7,000,000 Lekë.

Per arsye te afatit kohor te shkurter u hasen shume pengesa per realizimin e ketij aktiviteti dhe nuk qe i mundur perfundimi i tij. Per kete arsye fondi i fituar iu kthye ministrise perkatese brenda afateve te parashikuara ne projekt.

P04130.Q2.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve egzistuese

Tregjet ekzistuese dhe ato të rejtat që do ndërtohen e kanë të domosdoshme mirëmbajtjen e tyre sepse ato amortizohen. Më shumë duhet të bëhet në drejtim të përmirësimit të ambientëve fizike të tregjeve duke parashikuar riparime në infrastrukture e tezgave, banakeve, lyerje. Mirëmbajtje të hapësirave për automjetet dhe këmbësoret gjithashtu duhen parashikuar mirëmbajtje të vazhdueshme në banjo publike, elektricitet, uje etj. Riparime në ambjentet e magazinimit të mallit etj. I njejt model mirëmbajtje duhet të funksionojë pastaj edhe për tregjet e reja që do ndërtohen, në mënyrë që të qëndrojnë përherë brenda standarteve të mira të tregtimit. Per ketë arsye është planifikuar edhe aktiviteti në fjalë, i cili është i shtrire edhe në vitet në vazhdim. Konkretisht këtë vit me buxhetin e programit 04130 janë likujduar cdo muaj detyrimet e energjisë elektrike si dhe deri tani nuk është kryer asnjë riparim. Megjithate me ane te projektit te fituar nga AZHBR per ndertim tregu te ri pritet te filloje nje investim konkret ne kete zone.

Gjithashtu Bashkia Shkodër me vendimin nr. 15 datë 20.7.2023 ka krijuar Sh.A. Bio Strajca me funksion administrimin e tregjeve të Bashkisë Shkodër. Fondi i ketij programi eshte shtuar me 10 000

000 leke dhe do shpenzohet për këto vite buxhetor për të mbështetur Sh.A Bio Strajca. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë aksionare është:

- a) Ofrimi i shërbimeve në fushën e zhvillimit ekonomik për mirëfunksionimin e tregjeve publike dhe rrjetit të tregtisë.
- b) Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor dhe ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj komunitetit.
- c) Menaxhimi i tregjeve të produkteve bujqësore, tregjeve të kafshëve të gjalla, thertoret etj.

P04130.Q3.O1.A1. Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtesë për ëeb-sitin e turizmit.

Një ndër instrumentët më të rëndësishëm të marketingut territorial, është promovimi online. Promovimi online ofron avantazhe të shumta dhe është lehtësisht i arritshëm nga çdo pikë e globit, mund të përditësohet shpejt dhe nuk ka kosto të madhe. Mundësia unike që ka ëeb-i për të bashkuar shumë element në një dokument multimedia, kanë rritur përdorimin në një shkallë të lartë kundrejt mediave të tjera tradicionale, duke e kthyer atë në një media globale. Bashkia Shkodër ka një ëeb-site zyrtar që i dedikohet turizmit. Ky portal përmban materiale promocionale dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për vizitorët që dëshirojnë të vijnë në Shkodër. Gjatë vitit 2023, me përfundimin e kontratës së hostimit të ëeb-sitit, është parë e nevojshme rishikimi dhe rindertimi i një ëeb-site të ri kushtuar turizmit. Në kuadër të projektit “Tourism for Albania” është parashikuar realizimi dhe vënia në funksion të ëeb-sitit të ri dhe për këtë arsye nuk është parashikuar fondi për këtë zë buxheti.

P04130.Q3.O1.A2. Hostim , mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtesë per aplikacionin e turizmit

Për të promovuar territorin e Bashkisë Shkodër si destinacion turistik dhe përmirësuar cilësinë e shërbimit për turistët, krijimi i një aplikacioni për smartphone, me informacionet dhe orientimet e nevojshme drejt nevojave të vizitorëve, është i domosdoshëm. Ofrimi i informacionit online përmes rrjeteve socialeve, faqes së ëeb-it, aksesit për shkarkimin falas të gjithë materialeve promocionale të territorit përmes aplikacionit do të ketë një impakt pozitiv në rritjen e numrit të vizitorëve dhe do ndikojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Bashkia Shkodër ka parashikuar krijimin e një aplikacioni dedikuar turizmit. Duke qenë se fondi në dispozicion për këtë zë buxheti nuk është i mjaftueshëm për rimodelimin dhe pasurimin me module shtesë, janë duke u vlerësuar edhe vlerësuar mundësitë e financimit përmes bashkëpunimeve dhe rishikim të regjistrimit të prokurorimeve.

P04130.Q3.O1.A6. Prodhimi dhe publikim i materialeve promocionale

Zhvillimi i turizmit në territorin e Bashkisë Shkodër ka ardhur gjithnjë e më rritje. Duke parë fluksin në rritje të turistëve dhe me qëllim rritjen e kohëzgjatjes së qëndrimit në territorin tonë, Drejtoria e Turizmit çdo vit ka realizuar botime të ndryshme dhe ka prodhuar materiale promocionale (guidën turistike, hartën turistike të territorit të Bashkisë; harta të destinacioneve specifike- Shkodër; Theth dhe Velipojë; itinerare të ndryshme turistike, kalendarin e aktiviteteve kulturore dhe artistike; materiale të ndryshme promocionale si dosje, stilolapsa, çanta, çakmakë etj. Të gjitha materialet promocionale që do të realizohen do të jenë në dispozicion të zyrave të informacionit turistik të Bashkisë, falas. Proçedura e prokurimit është realizuar, jemi në pritje të përfundimit të afateve të ankimimit dhe lidhjes së kontratës me operatorin.

P04130.Q3.O2.A1.Stenda levizëse "Vizito Shkodren"

Territori i bashkisë Shkodër gjithnjë e më tepër po sheh një numër në rritje të turizmit të brendshëm. Një numër i madh turistësh vijnë jo vetëm nga vendet e tjera por edhe nga qytete të ndryshme të Shqipërisë. Edhe nga statistikat e zyrave të informacionit turistik në Shkodër, Velipojë e Theth vërehet një rritje e numrit të turistëve nga qytetet e tjera. Gjithashtu vihet re edhe një mungesë informacioni për atraksionet dhe për aktivitetet që kryhen në territorin e Bashkisë Shkodër. Si një mënyrë për të informuar mbi atraksionet dhe mundësitë që ofron territori i Bashkisë Shkodër do të ishte ngritja e një stende të lëvizshme që do të vendosej në qytete të ndryshme të Shqipërisë në ditë të caktuara. Kjo stendë do të përmbante materiale promocionale për Shkodrën duke bërë në këtë mënyrë të rritet interesi i qytetarëve të atij qyteti për të vizituar Shkodrën. Bashkë me stendën do të udhëtojë edhe një pjesë e stafit të drejtorisë të cilët do të kryjnë funksionin e informacionit turistik si edhe të promovimit të qytetit. Ky aktivitet është në proces. Është mbledhur Këshilli artistik prane bashkisë Shkodër, që ka vlerësuar projektet e paraqitura dhe është shpallur fitues për realizimin e këtij aktiviteti OJF ARKA. Aktiviteti është në proces realizimi gjatë muajit shtator.

P04130.Q3.O2.A2. Pjesëmarrje në panairë kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës

Për të promovuar ofertën turistike të territorit, Bashkia Shkodër ka marrë pjesë në dy panairë kombëtare/ndërkombëtare. Aktivitetet është realizuar dhe likujduar. Bashkia Shkodër ka marrë pjesë në Panairin e Ndërkombëtar të Turizmit dhe Mjedisit që u zhvillua në ExpoCity Albania.

Gjithashtu kemi marrë pjesë në Panairin Ndërkombëtar i Turizmit, (Busnes Turism Managment) të zhvilluar në Bari, ku patëm mundësinë përmes stendës sonë të promovojmë atraksionet e territorit të bashkisë Shkodër.

P04130.O1.A3. Përditesim dhe ribotim i guidës turistike të Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër ka potencial të madh për zhvillimin e turizmit. I gjithë territori karakterizohet nga një shumëllojshmëri atraksionesh turistike, që nga bukuritë natyrore të ndërtesat historike dhe identitetet kulturore. Pozita e favorshme gjeografike është pa dyshim një pasuri e rëndësishme për zhvillimin turistik të saj. Traditat njerëzore, kulturore dhe historike ia shtojnë më shumë vlerën këtij potenciali. Gjatë viteve të fundit, numri i turistëve që vizitojnë Shkodrën është rritur në mënyrë të vazhdueshme. Si rezultat i zgjerimit të territorit të Bashkisë Shkodër, një vëmendje e veçantë i është kushtuar pritjes së turistëve dhe marketingut të ofertës turistike. Në këtë kuadër Bashkia Shkodër ka përgatitur dhe botuar guidën turistike të territorit, material i cili kërkon përditësim të të dhënave dhe shtim informacioni të herëpashershëm. Me hapjen e zyrave të informacionit, interesimi i vizitorëve pranë këtyre zyrave është gjithnjë e në rritje dhe përgatitja e materialeve promocionale dhe shpërndarja e tyre, është shumë e rëndësishme. Për këtë arsye, është e nevojshme që ky produkt të ribotohet herë pas here. Për vitin 2023 janë parashikuar të botohen 1500 Guida turistike në gjuhën angleze. Proçedura është prokuruar dhe është në proces vlerësimi. Ky aktivitet në do të realizohet me fonde të trashëguara nga vitet e mëparshme.

P04130.O1.A4. Ribotim i hartave turistike të Bashkisë Shkodër

Zona e Shkodrës gjithnjë e më tepër po tërheq vizitorë nga shtete të ndryshme të botës. Këto vizitorë shpesh kanë nevojë për të marrë informacion për vendet me interes dhe mënyrën se si mund të arrihet atje. Gjatë vitit 2017 është realizuar botimi i disa materialeve promocionale të tilla si broshura e Thethit (1000 copë) dhe broshura e Velipojës (500 copë) të cilat përmbajnë hartën përkatëse dhe

informacionet e nevojshme për një vizitor në këto zona. Nevoja për të pasur një hartë turistike të gjithë territorit të Bashkisë Shkodër, për të plotësuar nevojat e vizitorëve potencial të Bashkisë, ka qënë i domosdoshëm. Në këtë kuadër, Drejtoria e Turizmit ka bërë përzgjedhjen e modelit dhe përmbajtjes së informacionit që do të ketë harta turistike e Bashkisë Shkodër dhe ka përcaktuar termat e referencës për shërbimin e konsulencës. Janë publikuar 1550 kopje të hartës në 2018 të të gjithë territorit të bashkisë Shkodër. Në 2021 janë printuar harta të destinacioneve të veçanta për qytetin e Shkodrës dhe për zonën e Thethit. Gjatë vitit 2022, duke qene se sasia e hartave ishte e mjaftueshme per perdorim/ shperndarje, fondi është trashëguar per 2023. Informacioni është përditësuar dhe procedura e prokurimit do të realizohet në muajt në vijim.

P04130.Q3.O2.A3. Festivali i Kulinarise " Shife"

Shkodra njihet jo vetëm për natyrën e bukur, por edhe historinë, kulturën, rrugicat karakteristike, si dhe artin e gatimit, që përcillet me aq finesë. “Shkodra International Food Event”, SHIFE do të jetë një udhëtim përmes trashëgimisë së pasur gastronomike, kulturore, artistike, historike dhe bukurive natyrore të Shkodrës. Ky festival syon t’i kthejë Shkodrës vendin që i takon në rang kombëtar dhe atë ndërkombëtar, si një qytet ku turizmi zhvillohet mbi rrënjët e forta të traditës dhe pasurive të pafundme të territorit, ndërthurur me elementet që koha i dikton. Ky aktivitet është realizuar në vitin 2022 dhe duke parë impaktin pozitiv që ka patur në komunitet, është menduar që të zhvillohet përsëri duke rialokuar fonde shtesë. Aktiviteti është parashikuar të zhvillohet në muajt në vazhdim.

P04130.Q3.O3.A1. 7. Festa e Liqenit

Ky është një aktivitet promovues social kulturor dhe sportiv që organizohet me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së pasur natyrore të qytetit si dhe promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës. Në vite janë organizuar gara të ndryshme noti (të rritur, të rinj & fëmijë), gara me kanoe, ski board, ndeshje vaterpoli me pjesëmarrjen e ekipeve të notit dhe fshatrave Zogaj dhe Shirokë dhe shkollave 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit. Me anë të organizimit të këtij aktiviteti Bashkia synon të ruajë dhe të forcojë këtë traditë me qëllim tërheqjen e vizitorëve dhe ndërgjegjësimin qytetar për vlerat ekoturistike, ekonomike dhe mjedisore të Liqenit të Shkodrës. Eshtë shpallur fituesi përmes procedurës së aplikimit të projekteve sipas shpalljes/ ftesës së hapur që ka publikuar Bashkia Shkodër. Për realizimin e këtij aktiviteti është shpallur fitues OJF Eëll Point. Aktiviteti është zhvilluar gjatë muajit qershor, i shtrirë në tre ditë, ku janë përfshirë aktivitete të ndryshme të sportit ujor, performanca artistike me qëllim promovimin e zonës dhe resurseve të saj. Ky aktivitet është likuiduar.

P04130.Q3.O3.A3. Hapja e sezonit turistik Velipoje

Velipoja është një ndër destinacionet e më të njohura të bregdetit shqiptar me vlera dhe potenciale të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit të diellit e rërës. Aktualisht frekuentohet nga një numër i madh pushuesish gjatë sezonit të verës të përqëndruar kryesisht vetëm në muajt korrik e gusht, por Velipoja zotëron potenciale të tilla, që ky sezon të jetë më masiv dhe më i shtrirë në kohë. Dita e hapjes së sezonit turistik është zhvilluar çdo vit këto vitet e fundit me pjesëmarrjen e banorëve të zonës dhe qytetarë nga Shkodra. Ky aktivitet konsiston në organizimin e një koncerti të madh festiv të mbajtur në qendër të plazhit të Velipojës në të cilin performuan live një rockband i përbërë nga artistë të qytetit të Shkodrës si edhe një grup valltarësh, lojra sportive (volejboll, futboll dhe hemboll dhe gara me varka me vela dhe kanoe. Aktiviteti është realizuar me datë 29 Prill dhe fitues për realizimin e këtij aktiviteti është shpallur shoqata MANIFESTO. Aktiviteti është likuiduar.

P04130.Q3.O3.A4. Festa e Alpeve

Festa e Alpeve është zhvilluar rregullisht vitet e fundit dhe ben pjese ne kalendarin e aktiviteve te pervitshme te bashkise Shkoder, me qellim promovimin e turizmit ne ate zone. Eshte shpallur fituesi permes procedures se aplikimit te projekteve sipas shpalljes/ fteses se hapur qe ka publikuar Bashkia Shkoder. Per realizimin e ketij aktiviteti eshte shpallur fitues nga keshilli artistik, OJF Eëll Point. Aktiviteti eshte realizuar me datë 9 korrik dhe ka patur rreth 100 pjesëmarrës të përfshirë në axhenden e parashikuar, ku përveç performancave artistike folklorike të zomës, të pranishmit patën mundësi të njihen edhe me atraksionet e kësaj zone përmes guidave të organizuar me këtë qëllim.

P04130.Q3.O3.A5. Dita e biçikletave.

Shkodra është qyteti numër një në Shqipëri për përdorimin e biçikletës me një traditë të hershme të përdorimit të saj që zë fill që në shekullin e 19. Gjithashtu Shkodra renditet në 10 qytetet që përdorin më shumë biçikletën në shkallë europiane. Gjatë periudhës së dikaturës biçikleta ishte mjete kryesor i transportit në Shkodër pasi numri i makinave ishte shumë i kufizuar. Me ardhjen e demokracisë dhe zhvillimin ekonomik numri i makinave ka ardhur vazhdimisht në rritje duke kërcënuar kështu zbehjen e kësaj tradite. Gjithashtu rritja e numrit të makinave rrezikon edhe ndotjen e ajrit nga gazrat dhe elementëve të tjerë të mjedisit nga mbetjet e tyre. Me organizimin e ditës së biçikletave dhe shndërrimin e saj në një festë të përvitshme synohet ripërtëritja e traditës si edhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës por synohet edhe gjallërimi i jetës kulturore të qytetit duke rritur atraktivitetin e tij.

Këtë vit dita e biçikletave do të zhvillohet në kuadër të Javës së Mobilitetit, 16-22 Shtator, ku janë të parashikuar disa aktivitete.

P04130.Q3.O3.A6. Triathlon

Triatlone është një aktivitet tre-garësh në tre disiplina sportive të ndryshme, si gara e notit, ciklizmi dhe vrapimi, për të cilat ne jemi shumë krenarë për traditën dhe rezultatet e shkëlqyera që sportistët tanë profesionistë dhe amatorë kanë dhene ndër vite. Aktiviteti zhvillohet në një nga zonat më të bukura të Bashkisë Shkodër, që shtrihet në të gjithë gjatësinë e bregut perëndimor të Liqenit të Shkodrës: Shirokë - Zogaj. Ky aktivitet, që zhvillohet gjatë muajit shtator, ngjall interes të shumtë për pjesëmarrje jo vetëm nga Shkodra, por dhe nga qytete të tjera të Shqipërisë. Interes të madh kishte vitin e kaluar dhe nga Kosova dhe nga shtete të tjera të Europës. Duke qenë se është një garë në 3 disiplina, u mendua që këtë vit të pranohen në garë jo më shumë se 55 persona, për arsye mirë organizimi dhe sigurie. Këtë vit aktiviteti u zhvillua me datë 3 Shtator dhe në të morën pjesë rreth 100 pjesëmarrës nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia dhe është në proces likuidimi.

P04130.Q3.O3.A8. Lojra Popullore Fest.

Lojra Popullore Fest është një aktivitet me karakter social kulturor Për të rinjtë i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve por edhe ti njohë ato me traditat tona kombëtare me anë të këngëve, valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit të promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes të trupave pjesëmarrësve. “Lojra Popullore Fest” gjithashtu synon të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzor, folklorike kombëtare dhe ndërkombëtare. Vetë të rinjtë

konkurrojnë me performaca dhe lojra popullore, këngë e valle tradicionale kombëtare dhe etnografike. Aktiviteti shërben edhe për promovimin e vlerave dhe potencialeve turistike. Vitin e kaluar u zhvillua muajin Tetor dhe në të morën pjesë rreth 150 pjesëmarrës nga të gjitha trevat shqipfolëse dhe u mbajt në sheshion Shirokë. Aktiviteti është parashikuar të realizohet në muajt në vazhdim.

P04130.Q4.O2.A1.Mbeshtetja e iniciativave të reja në mbështetje të zhvillimit të turizmit

Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të turizmit nënkupton reduktimin e varfërisë dhe gjenerimin e mundësive të reja për punësim dhe të ardhura në nivel lokal dhe rajonal. Turizmi sot është një nga sektorët prioritarë dhe me një impakt të madh në zhvillimin ekonomik të bashkisë Shkodër. Rritja e profesionalizmit të të punësuarve në industrinë e turizmit, si dhe ngritja e kapaciteteve menaxhuese do të hapin rrugën për përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve turistike, si dhe do ta mirëpozicionojnë Shkodrën në ofertën rajonale dhe ndërkombëtare. Të gjithë aktorët në industrinë e turizmit duhet të punojnë së bashku dhe të koordinojnë aktivitetet, në mënyrë që të eliminojnë pengesat që qëndrojnë mes tyre dhe të arrijnë qëllimet strategjike. Nisur nga sa më lart, për të garantuar një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të turizmit nëpërmjet vizionit që udhëheq punën e Bashkisë Shkodër për hartimin e projekteve-pilot, duke garantuar jetësimin e tyre dhe transformimin në modele zhvillimi me mundësi replikimi, parashikohet krijimi i platformave të bashkëpunimit për të garantuar realizimin e iniciativave të përbashkëta nëpërmjet partneritetit privat–publik, bashkëpunimit të ngushtë me donatorët dhe grupet e interesit, botën akademike dhe shoqërinë civile. Ky aktivitet është realizuar përmes thirrjes së haput të shpallur nga Bashkia për paraqitjen e projekteve. Keshilli artistik ka shpallur fituesin mbas vlerësimit të projekteve OJF MANIFESTO dhe aktiviteti është realizuar me datë 20 maj dhe është likuiduar.

Programi 04220: Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve

Ky program përfshin institucionet:

1. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit:

Qëllimi e programit të shërbimeve bujqësore është:

Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Mbështetja për menaxhimin e tokës dhe përmirësimin e saj nëpërmjet projekteve, që fuqizojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokave bujqësore si dhe të kategorive të resurseve të tjera . Mbështetja për përmirësimin e konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe të industrisë agroushqimore me masa të ndryshme investuese nëpërmjet projekteve.

Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e te kategorive te tjera te resurseve.

Nxitja, përmes financimit dhe këshillimit bujqësor të organizatave, shoqatave dhe kooperativave të prodhuesve bujqësore dhe ato të përpunimit e tregtimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, të ngritura në baza vullnetare.

Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural.

Krijimi dhe administrimi i skemave vendore te granteve per zhvillimin rural te financuara nga buxheti lokal dhe /ose me bashkefinansim nga te trete.

Objektivat e programeve buxhetore për përmbushjen e këtyre qëllimeve për vitin 2023 kanë qënë:


P04220.Q1.O1.A1-Krijimi dhe përditesimi i kadastrës bujqësore dhe arshives se saj dhe futja në sistem e zonave të parilevuara.

P04220.Q1.O2.A1-Krijimi i informacionit bujqësor.

P04220.Q1.O2.A2-Sigurimi i mbështetjes se fermerëve për agroindustrinë, treg dhe marketing.

P04220.Q2.O1.A1. Trajtimi i qenve të rrugës.

| Programi 04220 | ☒ Shpenzime operative | Investime | Totali |
|------------------------|-----------------------|-----------|--------|
| PBA 2023 | 6,000 | 4,500 | 10,500 |
| Plani fillestar 2023 | 6,909 | 5,670 | 12,579 |
| Plani i rishikuar 2023 | 10,260 | 18,483 | 28,743 |
| Realizimi viti 2023 | 4,846 | 2,877 | 7,723 |
| % e realizimit | 47.2% | 15.6% | 26.9% |



Realizimi i shpenzimeve operative ne programin P04220 duke e krahasuar me planin e rishikuar është 47.23 %. ndersa realizimi i investimeve eshte 15.56 %.

Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 26.9 %, sipas zërave kryesorë si më poshtë:

| | |
|--------------------|-------|
| Shpenzime korente | 47.2% |
| Shpenzime kapitale | 15.6% |

-Faktoret qe kane ndikuar ne mosrealizimin e fondeve te planifikuara:

Nuk kemi pasur faktore pengues per mosrealizimin e shpenzimeve te parashikuara.

Jane realizuar: trajtimi i 164 qenve te rruges (kapje, vaksinim, sterilizim, matrikullim, dehelmetizim si dhe trajtime të tjera të ndryshme antiparazitare). Realizuar ndertimi i strehezes se qenve faza e dyte si dhe prokurimi i ushqimit per qente dhe trajtimi veterinar ne strehez. Jane ne proces, fillimi i ndertimit te strehezes se re te qenve, trajtimi ushqimor ne strehez dhe kapja dhe trajtimi veterinar ne strehez.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 8 Mujori 2023

| Kodi i Programit | 4220 | Emertimi i programit: | Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve | | | | | | Koment e |
|--|---|--|---|----------------------------------|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|----------|
| Qellimi 1 | Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës , veprimtarive bujqësore dhe ekonomike. Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore, krijimi i informacionit kadastral dhe bujqësor. | | | | | | | | |
| **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhës | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| <i>Objektivi 1.1</i> | Krijimi dhe përditesimi i sistemit të informacionit për administrimin, përdorimin e tokës bujqësore. | | | | | | | | |
| | | 1 | Regjistri kadastral për të gjithë territorin e bashkisë, manual dhe elektronik(në numër progresiv) | 92 | 92 | 92 | 92 | 100% | |
| <i>Objektivi 1.2</i> | Krijimi dhe përditesimi i databazës së informacionit bujqësor. | | | | | | | | |
| | | 2 | Numri i njësive bujqësore aktive të përditësuara në database bujqësore | 360 | 380 | 380 | 220 | 58% | |
| | | 3 | Numër panairesh bujqësore që shërbejnë për promovim produktesh | 9 | 9 | 9 | 0 | 0% | |

| | | | | | | | | | |
|---------------|---|---|---|-----|-----|-----|-----|-----|--|
| | | | bujqësore dhe blegtorale | | | | | | |
| Qellimi 2 | Mbikqyrja dhe mbajtja nën kontroll e qenve endacakë | | | | | | | | |
| Objektivi 2.1 | Trajtimi veterinar i kafshëve të rrugës. | | | | | | | | |
| | | 4 | Qentë e rrugës që përfitojnë shërbime dhe trajtohen | 172 | 210 | 210 | 164 | 78% | |
| | | 5 | Numri i qenve të strehuar në strehëz | 110 | 110 | 574 | 274 | 48% | |

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| | | | |
|---------------|---|------------------|------|
| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
| Programi | Shërbimet Bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve | Kodi i Programit | 4220 |

| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2022) | Shpenzimet (sipas vitit 2022) | I | | II | | III | | IV | | Luhatjet në Koston për Njësi | | | Komente | | |
|------|--|---------------------|----------------------------------|-------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|---|--|---|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------|---------|-------------|--------------|
| | | | | | Kosto për Njësi (sipas vitit 2022) | Sasia (sipas planit të vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2023) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2023) | Sasia (sipas planit të rishikuar viti 2023) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar viti 2023) | Kosto per Njesi (sipas planit të rishikuar viti 2023) | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2023) | V = IV - I | | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Kadastri bujqësore dhe arshiva e saj | numri i regjistrave | 0 | 0 | 0.0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | |
| 2 | Njësitë bujqësore aktive të përditësuara në database bujqësore | numri i njësive | 360 | 0 | 0.0 | 380 | 0 | 0.0 | 380 | 0 | 0.0 | 97 | 0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|-----|-------|------|-----|--------|------|-----|--------|------|-----|-------|------|------|------|-------|--|
| 3 | Qentë e rrugës që përfitojnë shërbime dhe trajtohen | numri i qenve që përfitojnë shërbime dhe do të strehohen në strehëz | 172 | 5,151 | 29.9 | 320 | 10,500 | 32.8 | 574 | 28,743 | 50.1 | 274 | 7,723 | 28.2 | -1.8 | -4.6 | -21.9 | |
|---|---|---|-----|-------|------|-----|--------|------|-----|--------|------|-----|-------|------|------|------|-------|--|

| Produktet | Aktivite/Projekte | Institucioni | Statusi I Aktiviteteve | Plani fillestar 2023 Totali | Plani i rishikuar 2023 Totali | Realizimi i 8M 2023 Totali |
|--|--|-----------------|---|-----------------------------|-------------------------------|----------------------------|
| Kadastra bujqësore dhe arshiva e saj (numër rregjistrash) | P04220.Q1.O1.A1- Krijimi dhe përditesimi i kadastrës bujqësore dhe arshives se saj dhe futja në sistem e zonave të parilevuara | Bashkia Shkodër | e perfunduar | - | - | - |
| Fermerë, grupe fermeresh, agropërpunues të gatshëm për konkurim në treg (numër) | P04220.Q1.O2.A1- Krijimi i informacionit bujqësor | Bashkia Shkodër | Ne proces ne vazhdimi | - | - | - |
| | P04220.Q1.O2.A2- Sigurimi i mbështetjes se fermerëve për agroindustrinë, treg dhe marketing | Bashkia Shkodër | Ne proces ne vazhdimi | - | - | - |
| | P04220.Q1.O2.A3- Promovim produkte bujqësore dhe blegtorale nëpërmjet panairëve | Bashkia Shkodër | | - | - | - |
| Qentë e rrugës që përfitojnë shërbime dhe trajtohen (numër) | P04220.Q2.O1.A1. Trajtimi i qenve të rrugës. | Bashkia Shkodër | Perfunduar trajtimi I qenve te rruges. Perfunduar Ndertimi I strehezes Faza e II. Ne proces ndertimi I strehezes se re te qenve. | 10,500 | 28,743 | 7,723 |
| 04220 Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve | | | | 10,500 | 28,743 | 7,723 |
| Te trasheguara | | | | 2,079 | - | - |
| Totali | | | | 12,579 | 28,743 | 7,723 |

Bashkia Shkodër vazhdon trajtimin e problematikes se qenve endacake, në territorin e e saj, (këtu përfshihet kapja, vaksinimi, sterilizimi, matrikullimi, dehelmetizimi si dhe trajtime të ndryshme antiparazitare të këtyre kafshëve). Per vitin 2023 eshte lidhur dhe ka realizuar kontrata me “Best Friend” (Putrat) sh.p.k. e cila trajtoi problematiken kapjes, vaksinimit, sterilizimit, matrikullimit, dehelmetizimit si dhe trajtimeve të tjera të ndryshme antiparazitare. Po ashtu eshte realizuar faza e dyte e ndertimit se strehezes se qenve me nje vlere investimi prej

3,391,296 leke me TVSH. Në këtë strehez janë parashikuar të gjitha specifikimet e nevojshme që lidhen me mirefunksionimin dhe nevojat për administrimin optimal në kujdesjen ndaj këtyre kafsheve. Në projektin e realizuar, përveç dhomave ku këto kafshe do akomodohen janë parashikuar dhe hapësira të mbyllura për vizitat veterinarë që do kryhen, dy magazina si dhe gropë septike dhe kanale kullimi.

Pavarësisht nderhyrjeve, përfshirë dhe sterilizimin, vërehet që numri i qenve ende është i konsiderueshëm kjo për shkak të braktisjes së tyre në mënyrë të papërgjegjshme. Për këtë arsye, duke parë që problematika e qenve ende mbetet përseri është menduar ndërtimi i një streheze të re me një kapacitet akomodimi prej rreth 300 qen. Ndërtimi i kësaj streheze të re do bëhet në një godinë të ish-repartit ushtarak Rrenc. Parashikohen rreth 32 vendqendrimë (bokse) me kapacitet secili prej 8-10 qen.

Programi 04240: Menaxhimi i infrastruktures së ujitjes dhe kullimit

Ky program përfshin institucionet:

1. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve
2. Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore


Qëllimet e programit:

1. Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastruktures së ujitjes dhe kullimit.

Objektivat e programeve buxhetore për përmbushjen e këtyre qëllimeve për vitin 2023 janë:

P04240.O1 Permiresimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbajtjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit.

| Programi 04240 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|-----------------|---------------------|------------|-----------|--------|
| PBA 2023 | 14,458 | 23,405 | | | 37,863 |
| Plani fillestar 2023 | 20,663 | 34,389 | | 1,031 | 56,083 |
| Plani i rishikuar 2023 | 20,603 | 31,774 | 60 | 1,031 | 53,468 |
| Realizimi viti 2023 | 9,471 | 46 | 60 | 857 | 10,434 |
| % e realizimit | 46.0% | 0.1% | 100.0% | 83.2% | 19.5% |



Realizimi i shpenzimeve ne programin P04240 duke e krahasuar me planifikimin është si më poshtë:

| | |
|--------------------------------|--------|
| Shpenzime korente | 18.3 % |
| Shpenzime kapitale | 83.2 % |
| Totali i shpenzimeve realizuar | 19.5 % |



Faktorët e mos realizimit të fondeve të parashikuara për programin tek shpenzimet operative janë sepse: jemi akoma në procesin e tenderimit të fondeve sipas regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve publike për mirëmbajtjen e eskavatoreve, marrjen me qera të mjeteve të transportit për eskavatorët. Ka përfunduar prokurimi i karburantit (që përdoret për pastrimin e kanaleve kulluese dhe ujtesë në Nj.A.) dhe është në proces likuidimi. Po ashtu dhe aktiviteti i mirëmbajtjes së skemave ujtesë (Skema ujtesë Guri i Zi) është në përfundim të kontratës dhe në proces likuidimi.

Realizimi i produkteve te performances.

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 8 Mujori 2023

| Kodi i Programit | 4240 | Emertimi i programit: | Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit | | | | | | Komente |
|---------------------------|--|---|--|--------------------------------------|------------------------------------|---------------------------------------|---|------|---------|
| Qellimi 1 | Administrimi,shfrytezimi dhe mirembajtja e infrastruktures se ujitjes dhe kullimit | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhes | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | | |
| <i>Objektivi 1.1</i> | Permiresimi i sistemit te ujitjes dhe kullimit. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbajtjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, furnizim me uje për vaditje të fermave bujqësore | | | | | | | | |
| | | 1 | Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore Numri punonjësve: | 20 | 19 | 19 | 19 | 100% | |
| | | 2 | Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore Numri i automjeteve: | 2 | 2 | 2 | 2 | 100% | |
| | | 3 | Përmiresimi i rrjetit kullues. Km kanale kullues pastruar | 200 | 190 | 190 | 100 | 53% | |
| | | 4 | Sipërfaqe Ha përmirësuar kullimi | 4670 | 4780 | 4780 | 2200 | 46% | |
| | | 5 | Përmirësimi i rrjetit ujitës . km kanale ujitës mirëmbajtur | 16 | 40 | 40 | 0 | 0% | |

| | | | | | | | | | |
|--|--|---|---------------------------------|-----|-----|-----|-----|-----|--|
| | | 6 | Sipërfaqe Ha përmirësuar ujitja | 240 | 830 | 830 | 300 | 36% | |
|--|--|---|---------------------------------|-----|-----|-----|-----|-----|--|

Realizimi i produkteve

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| | | | |
|---------------|--|------------------|------|
| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
| Programi | Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit | Kodi i Programit | 4240 |

| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2022) | Shpenzimet (sipas vitit 2022) | I | | II | | III | | IV | | Luhatjet në Koston për Njësi | | | Koment e | | |
|------|---|------------------------------------|----------------------------------|-------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|---|--|--|---|--|---------------------------|--------------------------------|-------------------------------------|------------|----------|-------------|--------------|
| | | | | | Kosto për Njësi (sipas vitit 2022) | Sasia (sipas planit të vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të vitit 2023) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2023) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Shpenzimet (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Kosto për Njësi (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzimet Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2023) | V = IV - I | | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore | numri i punonjësve | 20 | 11,679 | 0.0 | 19 | 14,458 | 760.9 | 19 | 14,458 | 760.9 | 19 | 9,531 | 501.6 | 501.6 | -259.3 | -259.3 | |
| 2 | Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore | numri i mjeteve | 2 | 2,624 | 1,312.0 | 2 | 2,595 | 1,297.5 | 2 | 2,595 | 1,297.5 | 2 | 46 | 23.0 | - | - | - | |
| 3 | Pastrim kanalesh kulluese | kilometër | 200 | 9,688 | 48.4 | 190 | 9,688 | 51.0 | 190 | 9,688 | 51.0 | 100 | 0 | | -48.4 | -51.0 | -51.0 | |
| 4 | Pastrim dhe mirëmbajtje kanalesh ujitëse | kilometër | 16 | 2,646 | 165.4 | 40 | 11,122 | 278.1 | 40 | 18,450 | 461.3 | 0 | 0 | | -165.4 | -278.1 | -461.3 | |
| 5 | Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore | numri i ndërtesave të rikonstruara | | | | | | | 1 | 857 | 857.0 | 1 | 857 | 857.0 | 857.0 | 857.0 | 0.0 | |

Për vitin 2023 në programin Menaxhimi i infrastruktures së ujitjes dhe kullimit në funksion të veprimtarisë dhe përbushjes së objektivave të përcaktuara janë parashikuar aktivitetet:

| Produktet | Aktivitete /Projekte | Institucioni | Statusi I Aktiviteteve | Plani fillestar 2023 Totali | Plani i rishikuar 2023 Totali | Realizimi 8M 2023 Totali |
|---|--|---|------------------------|-----------------------------|-------------------------------|--------------------------|
| Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore Nr punonjësve: | P04240.Q1.O1.A1 - Menaxhimi dhe funksionimi i D.SH.B.P & të trashëguara | Drejtoria e shërbimeve bujqësore dhe pyjore | Ne proces | 16,101 | 16,101 | 9,576 |
| Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore Nr i mjeteve | | | | | | |
| Pastrim kanalesh kulluese (në km) | P04240.Q1.O1.A2- Pastrim kanalesh kulluese në Nj.A. | Drejtoria e shërbimeve bujqësore dhe pyjore | Ne proces | 9,688 | 9,688 | - |
| Pastrim kanalesh ujitëse (në km) | P04240.Q1.O1.A3- Pastrim kanalesh ujitëse. | Drejtoria e shërbimeve bujqësore dhe pyjore | Ne proces | 746 | 746 | - |
| Mirëmbajtje kanalesh dhe ujitëse (në ha) | P04240.Q1.O1.A4- Mirëmbajtje , rehabilitim i skemës ujitëse & te trashëguara | Drejtoria e shërbimeve bujqësore dhe pyjore | Ne proces | 7,328 | 14,656 | - |
| Përfitues të sistemeve të ujitjes (numër ferma) | P04240.Q1.O1.A5. Ofrimi i shërbimit të ujitjes në ferma | Drejtoria e shërbimeve bujqësore dhe pyjore | Ne proces | 4,000 | 4,000 | - |
| Fuqizimi i strukturave menaxhuese në funksion të ujitjes dhe kullimit të tokave bujqësore Nr i ndertesave | P04240.O1.A4. Rikonstruksion ambienteve të zyrave të DSHBP | Drejtoria e shërbimeve bujqësore dhe pyjore | Perfunduar | - | 857 | 857 |
| 04240 Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit | | | | 37,863 | 46,048 | 10,434 |
| Te trashëguara | | | | | | - |
| | | | | 18,220 | 7,420 | |
| Totali | | | | 56,083 | 53,468 | 10,434 |

Pastrim kanalesh ujitese dhe kulluese për NjA

Gjatë periudhes Janar-Gusht 2023 Drejtoria e Bujqësisë dhe, Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore (si institucion varësie) ka ushtruar veprimtarine në realizimin e qëllimit :Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit:

Hartimi i projekteve të ndërhyrjes për pastrim/reabilitim të Kanaleve Kullues bazuar në Planifikimin e miratuar në Planin e Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Kullimit , ndërhyrje pastrimi dhe vendosje në gjëndje funksionale të K.K. të dyta dhe të treta.

Sistemi i kullimit, si pjesë e rëndësishme e programit dhe objektivave dhe duke qënë nje nga prioritetet e Bashkisë Shkodër në fushën e bujqësisë, mbështetur në Planin e Veprimit për ndërhyrje në sistemin kullues për vitin 2023 dhe me hartimin e projekteve teknike është arritur te realizohet per pastrimin e 100 km Kanale kulluese nga te cilat pastrime me eskavator rreth 21 km dhe sperkatje per heqjen e bimesise 79 km .Keto nderhyrje jane kryer respektivisht ne Fshatrat Suka-Dajç dhe Mushan Nj.A. Dajç 12 km, fshatin Muriqan, Nj.A. Ana e Malit 1.3 km , fshatin Trush Nj.A. Berdice 4.2 km, fshatin Guri I Zi dhe Rrenc , Nj.A. Guri I Zi 3.4km. Ndersa per pastrimin e bimesise nderhyrjet jane kryer ne Njesite Administrative Ana e Malit, Berdice, Dajç, Guri I Zi, Rrethina dhe Velipoje. Keto nderhyrje kanë sjelle permiresimin e nje sipërfaqeje toke bujqesore me kullim te permiresuar prej 2200 Ha.

Programi 04260: Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Aparatin e Bashkisë
2. Drejtoria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

Qëllimi i këtij programi është:

- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;
- Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;
- Administrim i fondit pyjor dhe kullësor publik;
- Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e licencave për prerje pemësh.
- Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi i shërbimeve për operatorët pyjorë;
- Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;
- Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore;
- Shpërndarja e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes;

Përshkrimi i objektivave


O1: Sigurimi i mbrojtjes për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e mirëadministrimit të fondit pyjor dhe kullësor brenda territorit administrativ të bashkisë.

O2. Hartimi / Rishikimi i Planeve të mbarështimit për të gjithë sipërfaqen e fondit pyjor dhe kullësor 30668 ha.

O3. Rehabilitimi dhe pyllëzimi i sipërfaqeve pyjore/ kullësore, të degraduara, djegura si edhe mbrojtja e tokës nga erozioni (Projektim/Investim).


Realizimi i Buxhetit të planifikuar:

| Programi 04260 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Investime | 000/leke | |
|------------------------|-----------------|---------------------|-----------|----------|--|
| | | | | Totali | |
| PBA 2023 | 11,260 | 3,090 | 2,185 | 16,535 | |
| Plani fillestar 2023 | 17,833 | 3,375 | 7,084 | 28,292 | |
| | P08220.Q1.O1.A3 Mbështetje për funksionimin dhe shëbimin në vazhdimësi të muzeut historik. & te trasheguara | DEK | Realizuar pjeserisht (Prodhim bileta - likujduar korrik ,Mirmbajtje e nderteses eshte realizuar proc e specifikimeve teknike gusht,) | 900 | 992 | 150 |
| | P08220.Q1.O1.A4. Materiale promocionale për rrjetin muzeal. | DEK | Realizuar | 60 | 60 | 39 |
| | P08220.Q1.O1.A5 Publikime promocionale, fletepalosje e guidë për Vendin e Dëshmisë e Kujtesës | DEK | Realizuar | 150 | 150 | 98 |
| | P08220.Q1.O1.A6 . Cikël takimesh dhe bisedash mbi historinë dhe të kaluarën e Shqipërisë dhe Shkodrës në veçanti | DEK | Realizuar pjeserisht (Realizohen disa takime gjate vitit) | 70 | 70 | 10 |
| | P08220.Q1.O1.A7.Muze u I Arteve Pamore " Lin Delija " | Bashkia Shkodër | Parealizuar | - | - | - |
| | P08220.Q1.O1.A8.Muze u Etnografik në Shkodër | Bashkia Shkodër | Parealizuar | - | - | - |
| | Godina te rikonstruktura (numer) | P08220.Q1.O1.A9 Rikonstruksioni I ndertesës se Teatrit Migjeni | Bashkia Shkodër | Parealizuar | - | - |

| | | | | | | |
|---|---|--------------------|--|--------|--------|--------|
| | P08220.Q1.O1.A10 Rikonstruksioni I ndertesës së Qendres kulturore "Pjeter Gaci". | Bashkia Shkodër | Parealizuar | - | - | - |
| Fondi të bibliotekës Marin Barleti I ruajtur, i mirëmbajtur, i mirëadministruar dhe I pasuruar (numër i librave) | P08220.Q1.O2.A1 Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës & të trashëguara | DEK | Procedura realizohet gjatë 6-mujorit të II të vitit | 1,000 | 1,100 | 185 |
| Menaxhimi dhe mirëadministrimi i strukturave të institucionit Dega Ekonomike e Kulturës (numër godina) | P08220.Q1.O2.A2 Administrimi dhe menaxhimi i Degës ekonomike të kulturës & te trashëguara | DEK | Realizuar pjesërisht | 25,177 | 25,393 | 14,697 |
| Pjesëmarrje aktive e qytetarëve në aktivitetet kulturore (numri pjesëmarrësve) | P08220.Q1.O2.A3 Periodiku Gegnia | DEK | Realizuar (likujdohet në fund të cdo numri) | 480 | 480 | 152 |
| | P08220.Q1.O2.A4 Festivali letrar i Shkodrës | DEK | Planifikuar të realizohet në muajt tetor nëntor | 50 | 50 | - |
| | P08220.Q1.O2.A5 Të shkruajmë për të rinj. | DEK | Planifikuar të realizohet në shtator | 30 | 30 | - |
| Manaxhimi dhe mirëadministrimi I strukturave të institucionit Teatrit "Migjeni" (numër strukturave) | P08220.Q1.O3.A1 Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni" & të trashëguara | Teatri Migjeni | Pjesërisht i realizuar | 32,770 | 34,437 | 21,995 |
| Manaxhimi dhe mirëadministrimi I strukturave të institucionit Qendra kulturore Pjeter Gaci (numër strukturave) | P08220.Q1.O3.A2 Administrimi dhe Menaxhimi i Qendres Kulturore "Pjeter Gaci" & të trashëguara | DEK | Realizuar pjesërisht (likujduar gjatë muajit korrik- gusht, Procedurat e tjera janë proces prokurimi) | 4,902 | 5,654 | 1,899 |
| | P08220.Q1.O3.A2 Administrimi dhe Menaxhimi i Qendres Kulturore "Pjeter Gaci"- TE TRASHËGUARA | Teatri Migjeni | | - | 117 | 43 |
| | P08220.Q1.O3.A3 Orkestra Frymore Honorare vjetore | DEK | Realizuar (Likujdohet cdo muaj) | 5,181 | 5,181 | 3,277 |

| | | | | | | |
|--|--|-----------------|-------------------------------|-------|-------|-------|
| Aktivitete kulturore artistike përgjatë gjithë vitit në bashkinë Shkodër (numri i aktiviteteve kulturore) | P08220..O3.A2 Orkestra Frymore Honorare vjetore -TE TRASHEGUARA | Teatri Migjeni | | - | 56 | - |
| | P08220.Q1.O3.A4 Grupi orkestror i Qendrës Kulturore. | DEK | Pa realizuar | 600 | 600 | - |
| | P08220.Q1.O3.A4 Grupi orkestror i Qendrës Kulturore.-TE TRASHEGUARA | Teatri Migjeni | | - | 150 | - |
| | P08220.Q1.O3.A5 Çmimi “Pjetër Gaci” | DEK | Realizuar | 1,309 | 1,309 | 1,143 |
| | P08220.Q1.O3.A5 Çmimi “Pjetër Gaci” -TE TRASHEGUARA | Teatri Migjeni | | - | 137 | - |
| | P08220.Q1.O3.A6 “Ahengu Shkodran” | DEK | Planifikuar 29 Shtator | 520 | 520 | - |
| | P08220.Q1.O3.A6 “Ahengu Shkodran”-TE TRASHEGUARA | Teatri Migjeni | | - | 74 | - |
| | P08220.Q1.O3.A7 “Honorare " Grupi i Valleve” | DEK | Realizuar | 720 | 720 | 360 |
| | P08220.Q1.O3.A7 “Honorare " Grupi i Valleve”-TE TRASHEGUARA | Teatri Migjeni | | - | 85 | - |
| | P08220.Q1.O3.A8 Festivali i Këngës Qytetare “Luleborë”. | DEK | Planifikuar muaji Tetor | 4,565 | 4,565 | - |
| | P08220.Q1.O3.A9 “Koncert – Premierë e Orkestrës Frymore” | DEK | Realizuar | 392 | 392 | 370 |
| | P08220.Q1.O3.A10 “Festivali Folklorik Tipologjik Kombëtar i Këngës Qytetare” | DEK | Realizohet nje here ne 2 vite | - | - | - |
| | P08220.Q1.O3.A11 Festival burimor | DEK | Planifikuar ne Dhjetor | 200 | 200 | - |
| | P08220.Q1.O3.A11 Festival burimor-TE TRASHEGUARA | Teatri Migjeni | | | 30 | |
| | P08220.Q1.O3.A12 Dita ndërkombetare e Jazz-it | DEK | | - | - | - |
| | P08220.Q1.O3.A13 Dita e Luleve 6 Maj | Bashkia Shkoder | Realizuar | 500 | 500 | 500 |
| | P08220.Q1.O3.A13 Dita e Luleve 6 Maj -TE TRASHEGURA | Teatri Migjeni | | - | 116 | - |

| | | | | | |
|---|--------------------|--------------------------|-------|-------|-------|
| P08220.Q1.O3.A14 Ndërmendje & te trasheguara | Bashkia Shkoder | Realizohet ne dhjetor | 1,100 | 2,200 | 1,100 |
| P08220.Q1.O3.A15 Aktivitete me rastin e 2 Prillit | Bashkia Shkoder | Realizuar | 120 | 120 | 70 |
| P08220.Q1.O3.A16 Festival Jazz-i. | Bashkia Shkoder | Realizuar | 3,000 | 3,000 | - |
| P08220.Q1.O3.A17 Koncertet e Veres | DEK | Realizuar | 600 | 600 | 556 |
| P08220.Q1.O3.A17 Koncertet e Veres- TE TRASHEGUARA | Teatri Migjeni | | - | 184 | - |
| P08220.Q1.O3.A18 Karnalet | Bashkia Shkoder | Realizuar | 500 | 500 | 500 |
| P08220.Q1.O3.A19 Shkodra n'fest & te trasheguara | Bashkia Shkoder | | 590 | 1,180 | 590 |
| P08220.O3.A19 Dita ndërkombëtare e Muzikës.-TE TRASHEGUARA | Teatri Migjeni | | - | 34 | - |
| P08220.Q1.O3.A20 “Festa e Trashëgimisë Kulturore” | Bashkia Shkoder | Realizuar | 800 | 800 | 800 |
| P08220.Q1.O3.A21 Ditët e Kosovës. | Bashkia Shkoder | Parealizuar | - | - | - |
| P08220.Q1.O3.A22 Pjesë Teatrore 1 & te trasheguara | Teatri Migjeni | Realizuar pjeserisht | 1,500 | 3,760 | 2,168 |
| P08220.Q1.O3.A23 Pjesë Teatrore 2 & te trasheguara | Teatri Migjeni | i pa realizuar | 1,500 | 1,808 | - |
| P08220.Q1.O3.A23/1 Pjesë Teatrore 3 -TE TRASHEGUARA | Teatri Migjeni | i pa realizuar | - | 165 | - |
| P08220.Q1.O3.A24 Variete & te trasheguara | Teatri Migjeni | realizuar | 1,500 | 1,740 | 1,190 |
| P08220.Q1.O3.A25 Shfaqje për fëmijë+Teatri i kukllave & te trasheguara | Teatri Migjeni | realizuar | 1,000 | 1,150 | 850 |
| P08220.Q1.O3.A26 Pranverë me këngë . & te trasheguara | Teatri Migjeni | realizuar | 500 | 748 | 425 |
| P08220.Q1.O3.A27 Festival teatri me shkollat e mesme.& te trasheguara | Teatri Migjeni | realizuar | 500 | 575 | 425 |
| P08220.Q1.O3.A28 Honorare Aktoret | Teatri Migjeni | Realizuar pjeserisht | 500 | 575 | 298 |

| | | | | | |
|---|-----------------|-------------------------------------|----------------|----------------|---------------|
| eTeatrit teKukullave.& te trasheguara | | | | | |
| P08220.Q1.O3.A29 Lëvizja e Postribës | Bashkia Shkoder | Realizuar ne shtator | 30 | 30 | - |
| P08220.Q1.O3.A30 Ekspozita “Salloni i vjeshtës ” | DEK | Planifikuar te realizohet ne Nentor | 500 | 500 | - |
| P08220.Q1.O3.A31 Cmimi Idromeno. | DEK | Planifikuar te realizohet ne Tetor | 305 | 305 | 78 |
| P08220.Q1.O3.A32 “Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës. | DEK | Realizuar | 160 | 160 | 81 |
| P08220.Q1.O3.A33 Takimet publike -bisedat publike mbi artin dhe workshop me artistë të rinj | DEK | Realizohet ne fund muajit shtator | 50 | 50 | - |
| P08220.Q1.O3.A34 Programet të edukimit artistik në partneritet individe dhe shoqata kulturore. | DEK | Realizuar | 60 | 60 | 45 |
| P08220.Q1.O3.A35 Orkestra Simfonike | DEK | Realizuar | 4,990 | 5,666 | 3,592 |
| P08220.Q1.O3.A36 Takim nderkombetar I bandave frymore | DEK | Realizohet ne fund muajit tetor | 1,000 | 1,000 | - |
| P08220.Q1.O3.A37 Aktivitete artistike kulturore ne mbeshtetje te grupeve rinore artistike. | Bashkia Shkoder | Realizuar pjeserisht | 2,000 | 2,000 | 1,300 |
| P08220.Q1.O3.A38 Honorare Këshilli Arstistik I Bashkisë Shkodër. | Bashkia Shkoder | Realizuar pjeserisht | 200 | 200 | 63 |
| P08220.Q1.O3.A39 Ekran i artit : festivali i filmit ne Shkoder | Bashkia Shkoder | Realizuar | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| P08220.Q1.O3.A40 Idromeno film | Bashkia Shkoder | Realizuar | 500 | 500 | 500 |
| P08220.Q1.O3.A41 Ekspozite fotografike | DEK | Realizuar | 200 | 200 | 85 |
| 8220 Trashëgimia kulturore, monumentet, kopshtet zoologjike e | | | 104,391 | 114,088 | 60,663 |

| | | | | | | |
|--|---------------------------------|--|--|----------------|----------------|---------------|
| | botanike dhe bibliotekat | | | | | |
| | Te trasheguara | | | 23,088 | 13,391 | - |
| | Totali | | | 127,479 | 127,479 | 60,663 |

Përshkrimi i aktiviteteve:

P08220.Q1.O1.A2. Dita Ndërkombëtare e Muzeumeve.

Dita Ndërkombëtare e Muzeve zhvillohet çdo vit më 18 Maj, synon të rrisë ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e muzeve në zhvillimin e shoqërisë.

Në muzeun historik, banesa Oso Kuka u organizua aktiviteti me temë “ Muzetë, qëndrueshmëria dhe mirëqenia’ . Aktiviteti u zhvillua në bahskëpunim me shkollën 9-vjecare “Ismail Qemali”, ku u diskutua për potencialin transformues që kanë muzetë si institucione që nxisin ndryshime pozitive.

P08220.Q1.O1.A3: Mbeshtetje për funksionimin dhe shërbimin në vazhdimësi të muzeut historik

Kjo fische synon të realizojë shpenzime mirembajtje dhe /ose rutine për mirefunksionimin e muzeve.

Prodhimi dhe shtypja e biletave të muzeut është realizuar.

Mirembajtje e ndersese se Muzeve eshte ne proces te hatimeve te specifikave teknike per realizim e prokurimit

P08220.Q1.O1.A4 : Materiale promocionale për rrjetin muzeal.

Në vitin 2010, për herë të parë Muzeu Historik botoi guidën e vet prezantuese të një cilësie grafike dhe informuese të një niveli tërësisht profesional duke u kthyer në një element promovimi të denjë në prezantimin e kulturës së rajonit tonë. Në themel të punës së vet, muzeu ka edhe promovimin e vlerave që ruan me karakter lokal dhe përtej. Janë realizuar shtypja e materialeve promocionale për rrjetin muzeal Guidës dhe fletëpalosjes të Muzeut Historik.

Informacion shtesë:

Muzeu Historik: Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas realizuan një ekspozitë me disa elementë etnografik të pa ekspozuar më parë, me rëndësi në jetën e gruas dhe asaj çfarë ajo përfaqëson në shoqëri, objektet ishin të jetes se perditshme të gruas shkodrane.

Ky aktivitet kishte si synim primar edukimin e brezave të rinj për rëndësinë e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Aktiviteti është organizuar me praninë e disa klasave të shkollave “Ismail Qemali” “28 Nentori” dhe të studenteve të Departamentit të Arteve dhe të Departamentit të Turizmit Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkoder

Kjo ekspozitë do të jetë e vizitueshme në ambientet e brendshme të Muzeut Historik deri me datë 17 Mars.

P08220.Q1.O1.A5: Publikime promocionale, fletëpalosje e guide për Vendi e Dëshmisë e Kujtesës

Për këtë vit është realizuar printimi i broshurave informative mbi aktivitetin e muzeut Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës.

Info shtesë:

Vendi I Dëshmisë dhe Kujtesës. : Më datën 7 mars 2023 në "Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës", në kuadër të axhendës së aktiviteteve që Bashkia Shkodër organizoi me rastin e ditës ndërkombëtare të gruas, 8 marsit, u mbajt aktiviteti përkujtimor dhe informues "In Memoriam: Gratë e Persekutuara". Aktiviteti i realizuar nga stafi i muzeut pati në qendër të vëmendjes kalvarin e vuajtjeve të grave gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri. Duke u ndalur në biografitë e pesë grave të cilat u përdoqën, u përballën dhe disa syresh edhe u vranë nga autoritet komuniste. Figurat historike që u përcollën ishin disa personalitete të shquara të Shkodrës dhe të Shqipërisë. Gratë e marra në shqyrtim ishin: Agime Pipa, Terezina Pali, Laura Keçi, Marie Tuci dhe Sabiha Kasamati. Aktiviteti u ndoq nga të rinj dhe

zgjati 30 minuta, nga ora 11:00-11:30. Audiencia e të rinjve është e domosdoshme për VDK-në pasi ata janë e ardhmja e shoqërisë dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të ndërgjegjes kolektive të asaj çfarë ka ndodhur gjatë diktaturës komuniste. Aktivitetet u transmetua edhe nga mediumet lokale të qytetit të Shkodrës.

P08220.Q1.O2.A1: Zhvillimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës

Zhvillimi dhe pasurimi i bibliotekës është një nga synimet përcaktuese të institucionit tonë, i cili synon pasurimin me libra dhe shtypin e shkruar sa më bashkohorë dhe të rëndësishëm, tituj të cilët zgjedhen me kujdes nga stafi i bibliotekës, në baze të kërkesave të lexuesve dhe botimeve të fundit. Është nënshkruar kontrata e blerjes së shtypit të shkruar dhe vijon furnizimi periodik, por likuidimi bëhet një herë në fundvit.

Procedura e librave është parashikuar të realizohet në 6-mujorin e dytë të vitit.

P08220.Q1.O2.A2: Administrimi dhe menaxhimi i Degës Ekonomike të Kulturës.

Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore si dhe shpenzime për shërbime nga të tretë.

Është lidhur kontrata vjetore për shërbimin telefon dhe internet dhe është kryer pagesa për periudhën 8-mujore dhe do të vazhdojë deri në fund të vitit buxhetorë 2023.

Janë paguar pagat për 29 punonjës të DEK për periudhën 8-Mujore, gjithashtu janë paguar shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore.

Është realizuar procedura e siguracionit të ndertesave të DEK

Është realizuar procedura e materialeve kancelarike

Është realizuar /likuiduar shpërblimi për daljen në pension të dy punonjësve të DEK

Është realizuar blerja e kondicionereve për Galerine e Arteve Shkodër

P08220.Q1.O2.A3: Periodiku Gegnia

Është realizuar mbledhja e materialeve për botimin e parë të revistës. Redaksia është angazhuar në përzgjedhjen dhe klasifikimin e artikujve.

Është realizuar botimi i revistës "Pena e Shkodrës" në bashkëpunim me shoqatën e shkrimtarëve

Është realizuar procesi i prokurimit të shtypjes dhe publikimit të revistës "Gegnia".

Janë paguar honoraret për studiuesit

Info shtesë :

1. Me datën 6 mars 2023, në kuadër të ditës së Mësuesit dhe ditës së Gruas, Biblioteka "Marin Barleti" organizoi veprimtarinë "Magjia e leximit". Kjo veprimtari ishte konceptuar si bashkëbisedim ndërmjet lexuesve të bibliotekës të moshave dhe profesioneve të ndryshme të apasionuar pas librit të cilët ndanë biseda interesante. Pjesë e aktivitetit ishte dhe performanca e këngëtarit lirik Arben Mjetaj, shoqëruar në piano nga maestro Bardhyl Hysa. Morën pjesë rreth 45 persona.
2. Veprimtaria tjetër e zhvilluar në ambjentet e Bibliotekës "Marin Barleti" me datën 22.04.2023, ishte FESTIVALI I III MBARËSHQIPTAR I POETESHAVE. Ky Festival u organizua nga Lëvizja vullnetare "Grate Frymojnë Vlera". Në këtë Festival, ndër 52 poezi.
3. Promovimi i librit "PËR NJË DEMOKRACI TË VËRTETË SHQIPTARE" me autor Filip Guraziu u zhvillua në praninë e një audience të gjërë lexuesish dhe dashamirë të kulturës. Mësuesi i njohur Gjeto Voci paraqiti një analizë të hollësishme të librit duke theksuar rëndësinë për kujtesën historike të ngjarjeve që mbart libri. Shkrimtari i shquar Primo Shllaku e vlerësoi librin si kontribut në pasurimin e letërsisë memorialistike. Më tej ai trajtoi raportin që ka shkrimi në dialektin gegnisht, që është karakteristikë e këtij libri, me kulturën kombëtare të shkrimit të letërsisë.

4. Biblioteka "Marin Barleti" në bashkëpunim me "Aleancën Franceze" prezantuan librin "UILLIAM SHEKSPIR" të Viktor Hygoit. Veprimtaria u moderua nga drejtorja e "Aleancës Franceze" Dhurata Hoxha. Përkthyesja e librit Ermira Xhomaqi Godo foli për historinë e veçantë që ka patur procesi i përkthimit i cili ka filluar nga gjyshi i saj, intelektualit Abdulla Rami, në kushte të internimi nga diktatura. Këtë punë ajo e ka vazhduar në vitet e fundit duke finalizuar me botimin e librit.
5. Biblioteka "Marin Barleti" organizoi prezantimin e romanit "KOHË DASHURISH TË HARRUARA", të autorit Ardian Cerga.
Aktori i njohur i kinematografisë shqiptare, Ardian Cerga ka ardhur këtë herë para lexuesve dhe artdashësve shkodranë në një dimension të ri, në rolin e shkrimtarit.
Libri "Kohë dashurish të harruara", bazohet në jetën personale të tij nga vitet '80 deri më sot ku trajtohet një gamë e gjërë ngjarjesh nga jeta shoqërore e Shqipërisë së këtyre viteve.
6. Libri "NAIM FRASHËRI NË HISTORIOGRAFINË LETRARE SHQIPTARE" i autorës Irma Sokoli Bilali u promovua sot në ambientet e Bibliotekës Publike "Marin Barleti". Fjalën përshëndetëse e mbajti prof. Stefan Çapaliku. Prof. Evalda Paci dhe Prof. Ermira Alija mbajtën kumtesat e tyre rreth librit. Aktiviteti u moderua nga drejtori i bibliotekës z. Maxhid Cungu.
Libri trajton ndikimin e figurës së Naim Frashërit historiografinë letrare shqipe duke referuar shumë autorë të rëndësishëm shqiptarë dhe të huaj që kanë paraqitur studime për të. Ky libër është një burim i rëndësishëm i informacionit për studiuesit dhe studentët e letërsisë dhe të historisë shqiptare.

Veprimtari me rastin e 23 prillit, Dita Botërore e Librit.

Veprimtaritë dedikuar javës së librit në kuadër të Ditës Botërore të tij kulmuan me aktivitetin "LETËRSIA DHE QYTETI", organizuar nga Biblioteka publike "Marin Barleti" në oborrin e Muzeut "Oso Kuka" ku i ftuar ishte shkrimtari Stefan Çapaliku për të ligjëruar rreth marrëdhënies së hershme të Shkodrës me letërsinë. Ndër të tjera ai foli për kushtet historike të zhvillimit të kulturës si dhe të letërsisë në veçanti në qytetin e Shkodrës. Shkrimtari Çapaliku theksoi gjithashtu rëndësinë që ka letërsia në përmirësimin e jetës sociale e kulturore të qytetit.

Në këtë aktivitet u promovua edhe libri më i ri i autorit Stefan Çapaliku "DARKAVE, NGA NJI MBAS BUKE", një përmbledhje me tregime të shkurtëra.

P08220.Q1.O3.A1: Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit "Migjeni"

Institucioni i Teatrit "Migjeni" në strukturën e tij përbëhet prej 38 punonjësish. Janë realizuar pagesat për Pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore si dhe shpenzime për shërbime nga të tretë (Energji, ujë).

Është bërë prokurimi:

1. Pritje – përcjellje;
2. Printime dhe publikime;
3. Udhëtime brenda vendit;

P08220.Q1.O3.A2 Administrimi dhe Menaxhimi i Qendres Kulturore "Pjetër Gaci".

Qendra Kulturore "Pjetër Gaci" ka në strukturën e saj 4 punonjës dhe menaxhon trupa artistike që paguhet me honorare gjatë vitit siç janë: Orkestra Frymore, Grupi i Valleve, Grupin Orkestror, Orkestra simfonike. Janë realizuar pagesat për pagat e personelit dhe pagesat e sigurimeve shoqërore si dhe shpenzime për shërbime nga të tretë. Është lidhur kontrata vjetore për shërbimin telefon dhe internet dhe është kryer pagesa për periudhën 8-mujore dhe do të vazhdojë deri në fund të vitit buxhetore 2023. Është realizuar procedura e siguracionit të ndertesës. Është realizuar procedura e materialeve kancelarike.

P08220.Q1.O3.A3: Orkestra Frymore Honorare vjetore

Formacioni i Orkestrës Frymore është një nga vlerat e veçanta artistike unike që ka qyteti ynë. Janë mbështetur me honorare për 8 muajt e vitit ky formacion që përbëhet prej 40 muzikantëve.

P08220.Q1.O3.A4 Grupi orkestror i Qendrës Kulturore

Nuk është realizuar.

P08220.Q1.O3.A7: Honorare Grupi i Valleve

Grupi i Valleve përbëhet prej 12 personash, të cilët janë mbështetur me honorare për 8 muajt e vitit.

P08220.Q1.O3.A15: Aktivitete me rastin e 2 Prillit

“2 Prilli” është ngjarje e cila shënoi një ndër revoltat më të mëdha në vend duke i dhënë fund komunizmit në Shqipëri. Në kuadër të ditës përkujtimore të “2 Prillit” në sheshin që mban edhe emrin e kësaj revolte, u organizua ceremonia e vendosjes së kurorave në ndërim të dëshmorëve të demokracisë. Shoqëroi homazhet Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër.

Në këtë ceremoni morën pjesë, Kryetari i Bashkisë Shkodër z. Bardh Spahia, Prof.Dr. Sali Berisha, deputetë, antarë të shoqatës “2 Prilli”, familjarë të familjeve të Dëshmorëve të Demokracisë.

P08220.Q1.O3.A18: Karnavalet

“Karnavale 2023”, e titulluar “ Po lehim si qeni n’hanë”, u zhvillua në datën 19 shkurt 2023 dhe u projektua të zhvillohet brenda një dite. Organizimi i këtij festimi u mbështet mbi traditën e përhershme të prezantimit dekorativ ironizues dhe të bejtës karnavaleske ironizuese.

Këtë vit karvani lëvizës, filloi nisjen nga Teatri Migjeni. Gjatë rrugës pati ndalesa për performanca të vogla të grupit artistik të “Karnavale 2023” tek: Dugajtë e Reja, Sarreq, sheshi “Isa Boletini”, sheshi para Bashkisë Shkodër duke u drejtuar nga sheshi “Nënë Tereza”. Një element i veçantë, traditë e Karnavaleve të Shkodrës, ishte edhe shpërndarja e petullave për publikun pjesëmarrës.

Pas mbërritjes së karvanit në sheshin “Nënë Tereza”, u zhvillua spektakli i plotë tradicional duke përfunduar me djegien e dordolecit. Element tjetër që karakterizon Karnavalet e Shkodrës, janë edhe butaforitë e ndryshme. Vënia në dukje e dobësive dhe të metave të shoqërisë shqiptare në aspektin social dhe politik, përmes satirës të shfaqur në formën e karikaturës, është një element shumë interesant i cili përceptohet shumë shpejt dhe shumë thjeshtë nga çdo lloj publiku.

P08220.Q1.O3.A24: Variete

“Big Brother Shkodra Vip 2” u rikthye në Shkodër por jo siç jemi mësuar ta shohim si një "Reality Shoë", por në skenën e Teatrit Migjeni. Komedia u vendos në skenë nga regjizori Arian Çuliqi dhe trupa e aktorëve të teatrit “Migjeni” si: Fritz Selmani, Keltin Pjalmi, Aleksander Prenga, Nikolin Ferketa, Lusi Bregu, Savjana Vjerdha, Gerti Palali dhe Arber Bala. Nuk i munguan skenës aktoret e medhenj Zyliha Miloti, Besnik Qinari dhe Drande Xhai, duke i dhënë kësaj komedie një sukses të garantuar.

Si ne cdo variete, muzika ishte një komponent i rëndësishëm dhe në “Big Brother Shkodra Vip 2” morën pjesë këngëtarët : Rezarta Smaja, Laorjan Ejlli, Ademir Fresku, Glerdit Turmetaj.

“Big Brother Shkodra Vip 2” mbushi plot sallën e Teatrit “Migjeni” për 10 netë radhazi

P08220.Q1.O3.A25: Shfaqje për fëmijë+Teatri i kukllave

Teatri Migjeni prej disa vitesh ka si prioritet rikthimin e traditës së shfaqjeve për fëmijë dhe teatrin e kukllave, si mënyra më e mirë e afrimit të fëmijëve me teatrin.

Këtë vit teatri i kukllave shfaqti “ Festa ne pyll” e shkrimtarit Kolec Pepa dhe me regji të Drande Xhaj.

Në këtë premiere morën pjesë, 5 aktorë. Premiera u shfaq me 11 dhe 12 Mars .

Teatri i kukllave “ Festa në pyll” ka vazhduar shfaqjet pe tij edhe gjatë mujit maj dhe qershor, duke dhënë në total 11 shfaqje duke u ndjekur nga 1.226 fëmijë.

P08220.Q1.O3.A27: Festival teatri me shkollat e mesme

Festivali Teatror i shkollave të mesme u zhvillua në datat: 20-25 Shkurt. Morën pjesë 6 shkolla. Ato u paraqitën në këtë Festival me 6 tregime të dramatizuara dhe vënë në skenë nga 6 aktorë së trupës së teatrit. U aktivizuan 48 nxënës. Në fund të Festivalit, Juria vlerësoi si shfaqja me e mirë “ Riedukimi i Apolonit” interpretuar nga nxënësit e shkollës Jordan Misja. U vlersuan si aktorja me e mire, nxënësja e shkollës “28 Nëntori “ dhe si aktorët më të mirë nxënësit e shkollës “Oso Kuka ” dhe “At Gjon Karma”. Ky festival u ndoq nga 2200 nxënës.

P08220.Q1.O3.A28: Honorare Aktoret eTeatrit te Kukullave.

Janë kryer pagesat e honorareve për aktorët e teatrit te kukullave për 8 muajt e vitit.

P08220.Q1.O3.A32 “Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.

Nga data 12.04-10.05.2023 qëndroi e hapur ekspozita e artistit Aleksandër Filipi. Aleksandër Filipi, që pas diplomimit, ka marrë pjesë në të gjitha ekspozitat lokale të organizuara në qytetin e Beratit, si dhe në ekspozita të përbashkëta të artistëve të qyteteve Berat, Fier, Lushnjë.Tre vepra të artistit Filipi ndodhen në fondin e Galerisë Kombëtare të Arteve, Tiranë; por edhe në koleksionet e koleksionistëve në Shqipëri, Kosovë, Gjermani, Greqi, Itali, Francë, Venezuelë, Spanjë dhe SHBA.

Artisti Aleksandër Filipi ka marrë pjesë në konkurse të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Vlerësime artistike dhe tituj nderi.

Aleksandër Filipi I përket asaj plejade artistesh pas viteve 90’ I cili arriti të ruajë kodin piktorik të traditës shqiptare dhe duke e kthyer veprën e artit në funksion të një qëndrim disi kritik për fenomenet e shoqërisë shqiptare të periudhës së tranzicionit.

Info shitesë:

Galeria e Arteve : Ekspozita “Brickolage” nga Guri Çavdarbasha-25 janar 2023

Galeria e Arteve hapi vitin kalendarik me një ekspozitë prestigjioze në skulpturë me përmbajtje qeramike.Kjo ekspozitë u kurua nga Zef Paci.

Punimet rrekën drejt kapërcimit të skulpturës funksion të një mjedisi e një estetike veçse hedonistike dhe formale, duke synuar të nxjerrin në pah një urgjencë të përbrendshme.

Autori e shkëput tullën prej bashkëjetesës së saj të zakonit me ndërtesën e mjedisin përreth dhe, duke e izoluar e vendos në një akt autoriteti, në vendin e gjërave që soditen. Ai e merr këtë objekt të shtypur e palosur, për ta përkthyer në metaforë të lindur nga një marrëdhënie pasioni e drame.

90 vjetori I lindjes SE I.Lulani solli në retrospektive një galeri veprash të panjohura për publikun sidomos vizatimet dhe pjesën e veprave të papërfunduara të autorit dhe me disa të paekapozuara ndonjëherë.

Bashkë me veprat dolën në publik dhe detaje personale e shënime kujtimesh të mbajtura nga vet artisti gjatë rrugëtimit të tij artistik e jetësor.

Kjo ekspozitë shumë planëshe solli para publikut autorin ,mikun dhe pedagogun e shumë prej dashamirësve që ishin prezent në hapje.

Një pjesmarrje e gjërë e publikut shënoj rëndësinë e një prej artisteve më me zë që ka nxjerrë qyteti I Shkodrës.

Lulani në Shkodër ose Lulani në shtëpi të vet u kuruar nga artisti Helidon Haliti nën kujdesin e së bijës Ormira Lulani. Galeria e Arteve Shkodër dhe Bashkia Shkodër mbështetën eventin duke masivizuar vëmëndjen dhe jehonën e gjërë mediatike dhe publike që pasoi.Në këtë takim nuk munguan bidedat , rrëfimet e ndërjetë të bashkohësve dhe studentëve artistë që I dhanë një mundësi publikut gjatë vizitës në sfond të dëgjonin copëza kujtimesh që ndërliidhen shumë bukur veprën me origjinën e saj.

Ekspozita u përcoll me një vëmëndje të madhe.

DUARTROKITJE

EKSPOZITE PERSONALE E AUTORIT ARTAN DRAÇINI

Me datën 01.04.2023 ora 18 :00

Artan Draçini

Rënditet tashmë si piktor bashkëkohor shqiptar.

Ka kryer studimet e larta për grafikë në Institutin e Lartë të Arteve, Tiranë dhe jeton dhe krijon në qytetin e Shkodrës. Krijimtaria e Draçinit në vazhdimësi ka prirjen e një kërkimi artistik me motive nga qyteti i tij, nga jeta e përditëshme, duke preferuar krijimin e hapësirave dhe planeve që organizohen nga artisti sipas një bashkëpunimi të reales me jorealën.

Duke realizuar ciklet e tij grafikë, Draçini e shpalos fantazinë e tij kryesisht me mjete të natyrës grafike, duke ruajtur një gjuhë shprehëse të ekuilibruar me kontraste, por me elementë që shprehin fuqinë e fantazisë së artistit, ku ruhet poetika, ekspresiviteti dhe gjestualiteti i lirë i krijuesit. Artisti Draçini shprehet me gjuhën e simbolikës, duke përdorur elementë të së shkuarës (imazhe njerëzore, peizazhe) si një eko kambanë në të tashmen, për të pasqyruar faktin si një keqkuptim normal dhe ironik në të ardhmen. Një proces i tillë riciklimi i ndodhivë imagjinare krijon një pjesëz arti të qëndrueshëm në sistemin e vlerave të artit modern shqiptar të shekullit që jetojmë.

Ekspozita ITALIAE

Me rastin e se ciles publiku I Bashkisë Shkodër pat mundësinë e njohjes nga afër me një nga fondet me të rëndësishme botërore të fotografisë siç është Fondacioni Alinari erdhi si rezultat I bashkërendimit dhe vullnetit e kujdesit të Kryetarit të Bashkisë Shkodër Z. Benet Beci dhe Institutit Italian të Kulturës me qendër në Tiranë.Graviteti I kësaj ekspozite përtej bashkërendimit të eksperincave kulturore mes dy vendeve tradicionalisht mike, si Italia dhe Shqipëria e veçanërisht Shkodra si pritëse e radhës së këtij eventi bëri bashkë në Galerinë e Arteve Shkodër publikun vendas , anetarët të komunitetit Italian që jetojnë e punojnë në Shkodër dhe ekspert të fotografisë.

P08220.Q1.O3.A35: Orkestra Simfonike

Me 10 Prill 2023 u vu ne skenë premiera e parë ë orekstrës simfonike të Bashkisë Shkodër .

Orkestra Simfonike e Shkodrës nën drejtimin e maestro Jetmir Barbullushit na dhuroi një mbrëmje emocionuese në teatrin “Migjeni”, me kryeveprat e kompozitorëve shkodranë erdhën aq bukur të interpretuara nga artistët pjesëmarrës dhe kori polifonik “Prenkë Jakova” me drejtues Gjon Shllakun.

P08220.Q1.O3.A37:Aktivite artistike kulturore ne mbeshetje te grupeve rinore artistike.

Me datë 14 Prill, në teatrin Migjeni u organizua mbrëmje muzikore përkujtimore:

TONIN GURAZIU - Pianisti i zanafillës muzikore shqiptare, në 115 vjetorin e lindjes.

Ky aktivitet u organizua nga Bashkia Shkodër dhe Mjeshtri Zhani Ciko.

Interpretuan: Rudina Ciko- Piano;

Marjana Leka- Soprano;

Adela Muçallari- Korografe;

Solistë të baletit TKOB.

Me datë 16 Prill në teatrin Migjeni, u organizua koncert me këngë popullore , me orkestracione te reja, të interpretuar nga këngëtarët më të mirë të qytetit tonë. Ky aktivitet u organizua nga Bashkia Shkodër dhe Bujar Qamili.

P08220.Q1.O3.A12. Dita e Luleve 6 Maj:

“Dita e Luleve – 6 Maj”, u zhvillua në datën 6 dhe 7 maj 2023 në sheshin para Bashkisë Shkodër. Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër dhe Fondacionit “Arte”. “Dita e Luleve - 6 Maj”, e titulluar “Festa e Luleve” nga subjekti, u konceptua mbi tema të ndryshme:

“Ekspozita e luleve” – Data 6 Maj filloi me ekspoziten personale të piktores Greta Tahiraga. Ekspozita kishte tematike lulen dhe u hap në hollin e Bashkisë Shkodër, nga ora 11:00-19:00 . Ekspozita tërhoqi vemendjen e shumë qytetarëve të cilët ndalun për të shijuar veprat e artit të piktores Greta Tahiraga.

“Festivali i Luleve” - Një hapsirë e veçantë iu dedikua tërësisht shkollave 9-vjeçare të cilët sollën në skenën performaca vallëzimesh me ritme shqipëtare dhe moderne. Drejtorja e Kulturës, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, bashkëpunoi në mënyrë të suksesshme me Zyrën Vendore Arsimore, Shkodër, duke angazhuar fëmijët e sistemit parashkollor dhe shkollor parauniversitar në këtë aktivitet. Nuk mungoi kënga në këtë aktivitet, pasi në skenë kënduan edhe disa pjesëmarrës të “Bilbilat e vegjël të Shkodrës këndojnë”.

Data 7 Maj - “Koncerti i Ditës së Luleve” –Mbrëmja e 7 Majit ishte një nga netët më të veçanta dhe që do të mbahet mend gjatë nga publiku i Shkodrës. Përjetuam një natë magjike nën interpretimin e formacionit të Orkestrës Simfonike të Shkodrës dhe artistit Dren Abazi, me pjesëmarrjen e Korit Polifonik “Prenke Jakova”, në një nga koncertet më unike që është realizuar ndonjëherë në Shqipëri. Mbi 90 artistë në një skenë të hapur dhe një publik që kishte tejmbushur sheshin përpara Bashkisë Shkodër, dëshmuar edhe njëherë tjetër se arti dhe kultura në qytetin tonë i kanë rrënjët e forta dhe që aq bukur tradita ju trashëgohet brezave.

P08220.Q1.O3.A40: Idromeno Film

Idromeno Film është projekt i cili eksploron lidhjet mes artit bashkohorë dhe kinemasë, duke e vendosur atë përpara publikut shkodran dhe më gjërë. Në këtë edicion përveç dokumentareve rreth kinematografisë dhe artit, u organizuan edhe ëorkshope të ndryshme.

Datë 5 Maj 2023 - ora 20:00 - Tek Sheshi “Nënë Tereza” u mbajt ceremonia e hapjes së “Idromeno Independent Film Festival”, I cili kulmoi me koncertin e Symphony nga Metallica.

Datë 9-10 dhe 11 Maj 2023 - Ora 20:00 -24:00- Idromeno Afterparty: në rrugën “Gjuhador” u zhvilluan festa me artistë të ndryshëm. Idromeno film u organizua në datat 5 maj deri me 12 maj 2023.

P08220.Q1.O3.A22. Pjesë Teatrore 1.– Hekuba

Hekuba e Euripidit është një përrallë mizore e hakmarrjes së tmerrshme që ish-mbretëresha e Trojës i bëri mbretit trak Polimestor, i cili theri djalin e saj Polidorin, me qëllimin e vetëm të përfitimit. Mbi këtë lloj teleturgjie ballkanike autentike, Enke Fezollari dhe grupi i tij na ftojnë të shijojmë një shfaqje multikulturore, përmes këndvështrimit të tyre njerëzor, zakoneve e karakteristikave të tyre, me shtysë traditën e veriut të Shqipërisë.

Në shfaqje rolin e Hekubës interpretoi Rita Gjeka Kacarosi. Në këtë shfaqje mori pjesë aktorja e mirënjohur Vefi Redhi, e cila jeton dhe punon në shtetin helen si edhe aktori i madh dhe njëkohësisht Drejtor i Teatrit Shqiptar të Shkupit Adem Karaga. Interpretuan gjithashtu aktorët Jozef Shiroka, Krist Lleshi, Fritz Selmani, Rajmonda Marku, Merita Smaja, Nikolin Ferketa dhe Aleksander Prenga. Këndoi Rezarta Smaja, e shoqëruar nga muzikanti Bledi Doci. Kostumet e skenografia: Divni Gushta.

Premiera “Hekuba” u shfaq me datë 5 maj ne teatrin Migjeni.

Shfaqja “Hekuba” mori pjesë edhe në Festivalin Ndërballkanik të dramës në Athinë.

P08220.Q1.O3.A27. Pranverë me këngë.

Koncerti “Pranverë me këngë” u zhvillua me datë 12 Maj në Teatrin Migjeni.

Nën udhëheqjen e Maestro Ilir Zoga, ky koncert shfaq para publikut një repertor të larmishëm ku përfshinte këngë shqipëtare por edhe të huaja nën interpretimin e artistëve të afirmur dhe të rinj të qytetit.

P08220.Q1.O3.A37. Ekranet e artit: festivali i filmit në Shkodër.

Ekranet e Artit/ 2023, Edicioni i VI-të u realizua nga data 31 maj deri me 4 qershor 2023. Ky aktivitet synoi ruajtjen e fokusit mbi spektatorin e vëmendshëm ndaj filmit dhe video artit por duke e pasuruar festivalin me kontribute të tjera që e çojnë dialogun me qytetin në një stad të ri përfshirjeje edhe që e bëjnë atë tërheqës për një publik mbarëkombëtar e ndërkombëtar. Në këtë edicion të festivalit Ekranet e Artit, Shkodra mikpritë artistë e personalitete të artit, kulturës dhe mendimit intelektual shqiptar e ndërkombëtar.

Projektimi i filmave me metrazh të gjatë e të shkurtër, i filmave eksperimental dhe videoartit nga vendi e bota në netët e Ekranit të Artit u zhvilluan në sallën e Kinemasë së qytetit, tek Galeria e Arteve Shkodër, ambjentet e Art House, në rrugën e Shirokës dhe Bed Station duke sjellë produksione filmike e videoart të cilesisë së lartë të prodhuar në vitet e fundit. Risi e edicionit të këtij viti ishte organizimi i bisedave e diskutimeve rreth filmave të shfaqur me të ftuar special nga vendi dhe bota, ndër ta edhe autorë të filmave të shfaqur. Programacioni u ndoq nga shumë artdashës të cilët mbushën sallën e kinemasë duke krijuar kështu edhe imazhin e duhur si vendi projektimit të filmave.

Organizim i workshop-it me tre shkolla 9-vjeçare në Itali e Shkodër në dialog me veprën e njerës nga artistët më të rëndësishme të artit bashkëkohor italian Mariza Merz duke realizuar kështu për të dytin vit radhazi bashkëpunimin e suksesshëm ndërkombëtar mes shkollave 9-vjeçare.

Organizim i studio vizitave dhe dialogut të artistëve e kuratorëve ndërkombëtare me artistë të rinj nga Shqipëria Kosova e Maqedonia e Veriut ishte ndër aktivitetet e realizuara në ditët e Ekranit të Artit duke u dhënë kështu mundësinë artistëve të rinj të mund të krijojnë kontakte dhe të prezantojnë punimet e tyre tek artistët ndërkombëtar.

Prezantim i librit “Memory of the Air” i artistëve italianë Chiaralice Rizzi e Alessandro Laita, i cili flet mbi historitë njerëzore të familjeve shqiptare të fotografuara nga fotografët e arkivës Marubi dhe me pjesëmarrjen e autorëve.

Ekrani i Artit ka gërshtuar gjithmonë filmin me artin e muzikës, duke sjellë edhe këtë vit DJ dhe një grup muzikor për natën e fundit të festivalit.

P08220.Q1.O3.A4. Çmimi “Pjetër Gaci”.

Çmimi “Pjetër Gaci” është një takim interpretuesish të rinj në fushën e muzikës së kultivuar.

Nga viti 2000 e në vazhdim, ky aktivitet organizohet çdo vit në qytetin e Shkodrës dhe mbështetet financiarisht nga Bashkia Shkodër dhe menaxhohet nga Qendra Kulturore Pjetër Gaci”. Dimensionohet si një konkurs ndërkombëtar, i cili nga viti në vit është konsoliduar.

Juria e çdo kategorie përbëhet nga personalitete të muzikës klasike,nga brenda dhe jashtë vendit. Juritë të cilat përbëhen nga 15 persona, mbledhen në finale për të dhënë Çmimin “Pjetër Gaci”. Këtë vit ky aktivitet erdhi në edicionin e tij të XXII,i cili u zhvillua nga datat 1-4 qershor 2023.

Audicionet u zhvilluan ne Teatrin’’Migjeni’’si dhe në ambjentet e Bibliotekës Publike’’Marin Barleti’’. Morën pjesë rreth 200 konkurentë të shpërndarë në 5 disiplinat e konkursit.

Drejtor artistik i aktivitetit ishte Klevis Gjergji dhe Konsulent artistik dhe Kryetar jurie Paçalin Pavaci.

Për secilen disiplinë si piano, harqe, kanto, frymore dhe kitarë audicionët u zhvilluan sipas kategorive (A,B,C,D,E,F, G,H), duke u përzgjedhur për në finale 18 konkurënte të disiplinave dhe kategorive të ndryshme.

Nata finale e Çmimit “Pjetër Gaci” u realizua me datë 4 qershor 2023, ora 19:00 në teatrin Migjeni.

Fituese e Çmimit “Pjetër Gaci” u shpall konkurentja nga Mali I zi Lucija Uliçević (Piano)

P08220.Q1.O3.A19. Dita ndërkombëtare e Muzikës.

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzikës, Orkestra Frymore e Bashkisë Shkodër realizoi koncert “”*Mbrëmje muzikore e Orkestrës Frymore*””.

Këtë vit Koncerti-Premierë u zhvillua me dt:22 qershor në orën 20.00 në sheshin pranë Bashkisë Shkodër. Përveç dirigjentit permanent të orkestrës, Admir Lekaj, orkestra u drejtua edhe nga dirigjentja e re Fjoralba Duli. Solistë të ftuar në koncert ishin këngëtarët Klodiana Naku[Ibrahimi] e cila luajti edhe rolin e regjizores, Megi Toma, Briken Burgija, Ajdis Hasani si dhe Grupi’’Karajfilat që ka Shkodra’’ me këngëtarë Ermis Piranaj, Arben Jubani, Agron Grami, Fatjon Tanazi etj. Moderatore e aktivitetit ishte aktorja e mirënjohur i Teatrit ’’Migjeni’’ Rajmonda Markja .

P08220.Q1.O3.A16. Koncertet e Verës:

Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” me mbështetjen e Bashkisë Shkodër, organizuan "Mbrëmje muzikore me këngë shkodrane".

Ky aktivitete erdhi në kuadër të ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, me qëllim edukimin brezit të ri me bukurinë e këngës shkodrane duke e transmetuar brez pas brezi si trashëgimi shpirtërore e popullit tonë.

Ishte përzgjedhur me kujdes repertori i aktivitetit duke sjellë shumë gjallëri tek publiku, të cilët shoqeruan pothuajse të gjithë këngëtarët në interpretimin e këngëve.

Drejtues orkestre dhe dirigjent ishte Gazmend Kraja.

"Mbrëmje muzikore me këngë shkodrane" u zhvillua me datë 18.7.2023, në orën 20:00, tek sheshi “Nënë Tereza”.

P08220.Q1.O3.A20. “Festa e Trashëgimisë Kulturore”.

“Festa e Trashëgimisë Kulturore”, u zhvilluan në datat 21-22-23 Korrik 2023 në Shkodër . Organizatorët e këtij aktiviteti artistik ishin: Bashkia Shkodër dhe Qendra “ZA”.

Aktiviteti I titulluar “Za Fest” nga subjekti, ishte një kombinim i muzikës, artit pamor, si dhe nxitje te interesit te popullsisë për të vizituar vende të reja me oferta të pasura natyrore dhe kulturore, duke shndërruar sot turizmin në një ndërsektorët kryesor të zhvillimit ekonomik në botë. Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore ka qenë gjithmonë një prioritet për Bashkinë e Shkodrës.

Data 21.07.2023 - Nata e parë e aktivitetit ZaFest u zhvillua tek Kulla e Inglizit, një natë dedikuar jares shkodrane, e cila erdhi nën interpretimin e artistëve shkodran Jozefina Simoni dhe Antonio Fjerca. Nuk munguan bisedat në ZaFest, ku i ftuar ishte gazetari Marin Mema. Në këtë bisedë të hapur u prek një ndër çështjet më të ndjeshme sociale siç është emigrimi i të rinjve nga Shqipëria. Natën e parë të ZaFest e mbylli filmi i regjizore Blerta Basholli me filmin e saj “Zgjoji”. Filmi “Zgjoji” rrëfeu historinë e vërtetë të Fahrijes, një grua nga Kosova dhe përpjekjet e saj për mbijetesë si nënë e vetme në Kosovën e pasluftës.

Data 22.07.2023 - Nata e dytë e aktivitetit ZaFest u zhvillua në Kalanë e Rozafës. Ne skenën e Za Fest u ngjiten artistë të rinj dhe të afirmuar kombëtar dhe ndërkombëtar si :Gala Dragot, Divanhana, Vlashent Sata, Shkodra Elektronike. Aktiviteti filloi në orën 21:00 dhe zgjati deri në orët e para të mëngjesit. Skena ishte e përmasave të mëdha dhe e ndërtuar në stil të veçantë, ndërkohë përreth mureve të kalasë u projektuan me ndriçim dhe figura artistike. Pjesëmarrja e publikut ishte e mirë.

Data 23. 07.2023 - Nata finale e aktivitetit ZaFest u zhvillua në Kalanë e Rozafës. Të ftuar në naten permbylëse të aktivitetit ishin : Çun Lajçi, i cili interpretoi në lahutë pjesë nga rapsodi shqiptar, Isabel Sorling, Davide Shorty, Gipsy Groove dhe në fund Dj Secret 47. Aktiviteti filloi në orën 21:00 dhe zgjati deri në orët e para të mëngjesit.

P08220.Q1.O3.A15. Festival Jazz- i:

Organizatorët e këtij aktiviteti artistiko-kulturor janë: Bashkia Shkodër, Shoqata Kulturore “Rrok Jakaj”. “Festival Jazz-it” projekt i titulluar “Shkodra Jazz Festival” nga subjekti fitues, u zhvillua në datat 7 gusht – 27 gusht 2023.

“Rrok Academy”, për të shtatin vit me radhazi , u drejtua nga muzikantë të shkëlqyer, "Rrok Academy Jazz" nga Markelian Kapidani dhe "Rrok Academy, Classic" nga Paçalin Pavaci, "Rrok Academy Accordion " nga Bardh Jakova , “Rrok Academy Junior” nga Brixhilda Martini dhe Dega Neë Technology nga Fajton Çeliku.

“Rrok Academy” solli në Shkodër mbi 60 studentë nga Shqipëria, Kosova, Italia, Rumania, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbi dhe Colombi, të cilët për 14 ditë me radhë ndoqën leksione nga të gjithë artistët e ftuar në "Shkodra Jazz Festival".

Data 13 gusht 2023, në kuadër të Shkodra Sounds i cili vjen i atashuar në “Shkodra Jazz Festival”, e hapi klasa e fizarmonikës.

Studentët e Rrok Academy realizuan një prekoncert për të përshëndetur dy nga studentët nga Maqedonia të cilët mbyllën ciklin masterklaseve. Koncerti kishte një repertor klasik dhe ballkanik dhe u shoqërua nga maestro Bardh Jakova.

Data 19 gusht 2023 , pas 14 ditësh intensive masterclass-i dhe provash, studentët e "Rrok Academy Accordion " nën drejtimin e Maestro Bardh Jakova.

Tingujt magjik të 10 fizarmonikave performuan një repertor nga pjesë të huaja si :Vals Brillant , Tico- Tico ,Suite Bullgare, Libertango dhe pjesë nga repertori shqiptarë si : Valle Tiranse, Baresha , Pranvera filloi me ardhe etj.

Koncert filloi në orën 20:30 dhe zgjati për rreth 1 orë e 30 minuta, në oborrin e Muzeut Historik, banesa “Oso Kuka”. Në fund të performancës artistike studentët u pajisen me çertifikata pjesëmarrje.

Datë 20 gusht 2023- Muzeut Historik, banesa “Oso Kuka” u “pushtua” nga tinguj e harqeve të klases “Rrok Academy Junior” dhe “Rrok Academy Classic” .

“Rrok Academy Junior” ishte një formacion sestetto, me artistët me të rinj të akademisë, të cilët pas dy javësh prova dhe masterclase performuan për publikun. Repertori i koncertit ishte zgjedhura me kujdes nga profesoresha Brixhilda Martini, me pjesë klasike por dhe shume argëtuese. Në fund të performancës artistike studentët e “Rrok Academy” Junior, u pajisen me çertifikata.

Datë 20-21-22 dhe 27 gusht 2023 - Studentet e kursit jazz për katër net rradhazi patën mundësinë dhe fatin të luajnë në JamSession me artistët të ftuar në “Shkodra Jazz Festival”.

Klasa e frymës, të shoqëruar nga trombetisti me famë ndërkombëtare Gabriel Oscar Rosati, klasa e bass-it me Flavio Piantoni, klasa e perkusionit nga bateristi Pablo Della Maggiora, klasa e kantos nga Laura Ghirardi, nën shoqërimin e kompozitorit Markelian Kapidani, dhuruan për publikun një spektakël të vërtetë Jazzi.

Datë 24 gusht 2023 - Në sheshin para Bashkisë Shkodër, me datë 24 gusht, ora 20:30, performoi grupi austriak “Znap”. Për këtë koncert, treshja bashkëpunon me këngëtare me famë ndërkombëtare Patricia Moreno.

Datë 25 gusht 2023- Në sheshin para Bashkisë Shkodër, me datë 25 gusht performoi grupi rumun Popfolklorica. Zgjedhja e menyrës së krijimtarisë të grupit Popfolklorica nisët nga pasuria e jashtëzakonshme etnomuzikore rumune për ta pasuruar atë me gjetje interesante të frymëzuara nga stilet jazz, blues, motoën ose vintage soul. Koncerti I grupit Popfolklorica krijoi një aktomoshere të jashtëzakonshme për publikun prezent.

Datë 26 gusht 2023 - Koncerti i datës 26 gusht ishte rezultat i bashkëpunimit të katër muzikantëve të jashtëzakonshëm të muzikës Jazz.

Markelian Kapidani - Djale Shkodre, pionier i xhazit shqiptar, improvizues me një imagjinatë të pashtershme, por rigoroz në kërkimin e strukturave dhe kurioz në kërkim të veçorive muzikore nga rajone të tjera të botës.

Flavio Piantoni - Një basist me shumë eksperiencë, që ka luajtur me emra të mëdhenj të muzikës jazz bluz dhe rock.

Gabriel Oscar Rosati, trompetist - Një lojtar eklektik që pershtatet rrjedhshëm e me elegancë në çdo stil muzikor. Një qëndrim i gjatë në Shtetet e Bashkuara e kanë afruar në mënyrë të veçantë në jazz-in latin.

Laura Ghirardi - Një këngëtare që e jeton artin e saj me çdo qelizë të trupit, e apasionuar pas stileve të ndryshme dhe një zë të fuqishëm e depërtues.

Pablo Della Maggiora - Perkusionist i gjithanshëm dhe kozmopolit kureshtar për fenomenet më të largëta muzikore.

Nga kjo përzierje kulturore shumëngjyrëshe lindi projekti i këtij koncerti të freskët dhe spontan, i përbërë nga krijime origjinale dhe standarde të njohura, por i pasuruar me fantazinë dhe përvojën e muzikantëve të jashtëzakonshëm të mbledhur për këtë shfaqje.

Datë 27 gusht 2023 - “Shkodra Sounds” – Koncert nga "Skanderbeg Chamber Orchestra" nën drejtimin e maestro Paçalin Pavaci. Pas 14 ditësh intensive masterclass-i dhe provash, studentët e "Rrok Academy, Classic" performuan koncert për rreth 1 orë e 45 minuta, me një program të përzgjedhur të muzikës klasike. Përveç kryeveprave botërore të muzikës klasike, këtë vit Maestro Pavaci ka dashur të bëjë një homazh edhe për 65-vjetorin e operës Mrika, duke luajtur disa pjesë nga kjo operë të autorit Simon Gjoni. Koncerti i kësaj mbrëmje ishte rezultat i bashkëpunimit të muzikantëve të rinj shqiptarë, italianë, romun, dhe kolumbian. Në fund të performancës artistike studentët e “Rrok Academy Classic”, u pajisen me çertifikata pjesëmarrje.

P08220.Q1.O3.A33. “Personazh i ftuar”- Ekspozitë personale e një personaliteti të artit pamor shqiptar, të ftuar nga Galeria e Arteve e Shkodrës.

Galeria e Arteve në kalendarin e aktiviteteve të saj, rreket të afroje pranë publikut zëra me peshe në artin dhe kulturën shqiptare, që lenë vazhdimisht gjurmë dhe shquhen për angazhimin e tyre artistik në rang kombëtar e jo vetëm. Me datë 12.04.2023 u hap ekspozita në fjalë në kuadër të aktivitetit kryesor të Galerisë së Arteve siç është dhe Personazhi I Ftuar.

Ekspozita u ndoq gjerësisht dhe ngjalli interes edhe përtej Bashkisë Shkodër, duke marrë vëmendjen e dhe të mediave kombëtare. Artisti Aleksander Filipi I perket asaj plejde artistesh të pas viteve 90’ I cili arriti të ruajë kodin piktorik të extraditës shqiptare dhe duke ekzercituar vepren e artit në funksion të një qëndrimi disi kritik për fenomenet e shoqërisë shqiptare të periudhës së tranzicionit

Kesaj radhe per publikun ju prezantojme Biografine e ktij artisti me origjine nga Shkodra I cili e respektoj ftesen dhe qasjen ndaj publikut te shkodres sin je respect I origjines s e vet. Artisti ne fjale esht enje nder zerat e rendesishem te artit bashkohor shqiptar dhe ne rrugetimin e tij perafrimi I tij dhe veprese tij me publikun e Shkodres eshte vlere e shtuar per Galerine ne radhen e aktivitetve te saja.

Ekspozita qendroi e hapur deri me 10.05.2023

P08220.Q1.O3.A34. Programe të edukimit artistik në partneritet individë dhe shoqata kulturore:

Këtë vit si teme te programeve te Edukimit kemi zgjedhur si gjini te shprehjes artistike dhe jo vetem, MOZAIKUN. Për nga filozofia e ndërtimit ku pjesëza të vogla, me elemente të përveçëm identifikues, vinë e bëhen pjese organike e sëtërës, nxiti si motiv të parë të përzgjedhjes së kesaj gjinie artistike kaq e vjeter në kohë.

Mozaiku nuk është element I panjohur i historisë dhe trashëgimisë kulturore të hapsirës së Shkodrës. Citojmë këtu mozaikun e shek II-III-të e.s., i një vile romake që ekspozohet sot ne Muzeun e Kalasë Rozafa.

Periudha Bizantine dhe ajo Osmane I qasen po me të njëjtin qëllim, herë evokues, e herë dekorativ nisur edhe nga karakteristika e një lloj fryme harmonie që përcjell realizimi I tij. Studentet që do kenë mundesi të marrin pjesë do i ofrohet nga specialisti I trashëgimisë Z .Petrit Bilali, jo vetem aspekti historik , por çka është me e rëndësishme, të mësuarit e teknikës së realizimit të këtij elementi artistik kaq të bukur.

Bashkia Shkodër, Galeria e Arteve Shkodër, DRTK-Shkodër, Universiteti “Luigj Gurakuqi”- departamenti i arteve bashkëpunuan për këtë aktivitet krijimtarie artistike, me studentë pjesëmarrës si: Alfred Dopalaj, Adriana Ruci, Jamina Brucaj, Mbaresa Agaj, Erjon Baculi, Nedat Derguti.

Ne kuader te aktivitetit “Programet të edukimit artistik në partneritet individe dhe shoqata kulturore”, me datat 03-07 Korrik 2023 u mbajt puntoria MOZAIK 23 ,udhehequr nga skulptori Z.Petrit Bilali . Per 5 dite rresht ,u trajnuan dhe ne perfundim te aktiviteti u ekspozuar mozaiku i punuar nga studentet pjesmarres ne bashkepunim me kuratirin e ftuar Z.Bilali.

Ne fund te aktivitetit ,ekspzita u shoqerua me katering/sherbim ushqimore

Eshte realizuar procedura per blerjen e materialeve te realizomit te ketij aktiviteti/ekspozite

Eshte realizuar procedura e transportit/udhetimit

P08220.Q1.O3.A41: Ekspozitë Fotografike

Fotografia e ka shtepine ne Shkoder. Nën petkun konceptual e Po aq letraresk te kuratores, Rozafa Shpuza !

Ekspozita Fotografike “PËRHANSHËM” u hap me datë 10 Gusht 2023.

“Kur fjalët bahen të paqarta, kam me u fokusue te fotografitë. Kur fotografitë bahen të pamjaftueshme, kam me u kënaqë me heshtjen” Ansel Adams.

Në vorbullat emocionale të së përditshmes, një artist e gjen vedin tue ecë përhashëm përgjatë stacioneve që ka destinue fati për të, e te secili prej tyne ai ndalet dhe fikson atë çka ndjen. Bash këto ndjesi ka për qëllim me përcjellë tek artdashësit ekspozita “Përhanshëm” e fotografëve shkodranë: Anila Milani, Elisa Berdica, Eniko Mosi, Enza Rripaj, Ergys Vela, Fatjeta Muriqi, Jon Mithi, Leonora Milani, Selma Alija, Senad Xhexhovi.

Projekti drejtohet nga Bashkia Shkodër në rolin e liderit të projektit dhe ka afat zbatimi 24 muaj që nga nënshkrimi i kontratës. Me partneritet prej 2 organizatash: Terres des Hommes dhe Rajoni Emilia-Romagna, qëllimi i përgjithshëm i projektit është të rikonstruktojë dhe të kthejë godinën e ish-shkollës “Veterinare” në një qendër multi-funksionale për komunitetin duke ofruar shërbime të tilla si qendër shëndetësore, kopsht, çerdhe, ambjente të përbashkëta për aktivitete apo zyra administrative. Për shkak të ndërthurjes së punimeve është bërë shtyrja e kontratës deri me datë 27.05.2022. Me progresin e punimeve, vazhdon dhe zhvillimi i aktiviteteve sipas planit të punës dhe kalendarit të aktiviteteve nga partneri TDH në bashkëpunim me stafin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik të Bashkisë Shkodër ku janë kryer konsultimet me grupet e interesit: Komunitet, shoqëri civile dhe drejtues të shkollave, kopshteve & çerdheve, qendrës shëndetësore, inspektorë dhe administratorë social

të lagjes nr. 1. Takimet kanë qënë pikë kyçe për hartimin e 1. Udhëzuesit për përfshirjen e komunitetit dhe 2. Udhëzuesit për strukturën menaxheriale dhe programatike.

Gjate kesaj periudhe eshte punuar ne drejtim te mbylljes te te gjitha punimeve ne godine, furnizimit me materiale pune te kopshtit dhe te cerdhes qe do te vendosen ne kete godine, si dhe pregatitjes se fillimit te punes se tyre ne kete godine.

Çdo muaj raportohet në Ministrinë e Financave mbi shpenzimet e kryera.

Ne muajin korrik eshte mbyllur projekti dhe jane kthyer fondet donatorit.

Supervizim & Kolaudim Rikonstruksion shkolla Skenderbeg- TE TRASHEGUARA

Eshte procedure e realizuar. Foondet e trasheguara gjendje plani ,nuk kane dokumentacion te rregullt ligjor per tu paguar.

P09230.Q2.O1.A13.Organizimi i panairit të shkollave te mesme profesionale në Bashkinë Shkodër"

Nuk eshte realizuar.

FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE

Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Ky program përfshin institucione dhe konkretisht:

1. Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik.
2. Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike.
3. Drejtorinë e Kopësht – Çerdheve.

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i I i programit të **“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”**.

Q1. Planifikimi, informimi dhe zhvillimi i shërbimeve sociale multisektoriale dhe të qendrueshme duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit. Gjithashtu synojmë mbulimin sa më të plotë të territorit, të Bashkisë Shkodër, duke promovuar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, gjinisë, origjinës, minoritetit etj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2023 janë:

O1 Mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit.

O2 Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese në nivel vendor që lidhen me shërbimet e kujdesit shoqëror në bashkërendim dhe harmonizim me strategjitë dhe politikat kombëtare.

O3 Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë.

Qëllimi i II i programit të **“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”**.

Q2. Krijimi, ndërtimi dhe administrimi i qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2023 janë:

O1 Ndërtimi dhe administrimi i qendrave që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e këtyre shërbimeve.

O2 Konsolidimi i shërbimeve pranë qendrës rinore "Atelie" për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive në formim profesional e edukim, aktivitete artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër.

Qëllimi i III i programit të **“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”**.

Q3. Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, donatorët, shoqërinë civile, për krijimin e fondeve për financimin e shërbimeve sociale sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2023 janë:

O1 Krijimi i fondit të dedikuar për financimin e shërbimeve sociale në bashkërendim Bashki - Ministri - Donatorë / Shoqëri Civile.

O2 Identifikimi i individëve dhe familjeve në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore.

Qëllimi i IV i programit të **“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”**.

Q4. Administrimi, rregullimi dhe zhvillimi i shërbimeve të sistemit parashkollor për mirërritjen e fëmijëve 0-3 vjeç.

Objektivat e programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2023 janë:


O1 Krijimi, zgjerimi dhe zhvillimi i shërbimeve për fëmijët e moshës 0-3 vjeç.

Në kuadër të mbulimit sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke siguruar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësive të kufizuara, gjinisë, origjinës, minoritetit etj., Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka planifikuar dhe zbaton një sërë aktiviteteve të shpërndara përgjatë të gjithë vitit.

Realizimi i Buxhetit të planifikuar


Programi: **“Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”**.

| Programi 10430 | Paga & sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | Totali |
|------------------------|-----------------|---------------------|------------|-----------|-----------|
| PBA 2023 | 64,764 | 20,722 | 1,026,560 | 10,400 | 1,122,446 |
| Plani fillestar 2023 | 81,288 | 27,506 | 1,029,951 | 22,168 | 1,160,913 |
| Plani i rishikuar 2023 | 81,258 | 27,345 | 850,047 | 22,168 | 980,818 |
| Realizimi viti 2023 | 37,373 | 6,500 | 577,793 | 2,353 | 624,019 |
| % e realizimit | 46.0% | 23.8% | 68.0% | 10.6% | 63.6% |



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 63.6 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

| | |
|--|--------------|
| Shpenzimet korrente (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime) | 64.8% |
| Shpenzimet kapitale | 10.6% |



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

Fondet e planifikuara janë realizuar në masën 63.6 %.

Realizimi i treguesve të performancës:

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 8 Mujori 2023

| Kodi i Programit | 10430 | Emertimi i programit: | Kujdesi social për familjet dhe fëmijët | | | | | | Komente |
|----------------------------------|--|--|---|----------------------------------|--------------------------------------|-------------------------------------|---------------------------------------|---|---------|
| Qellimi 1 | Planifikimi, informimi dhe zhvillimi i shërbimeve sociale multisektoriale dhe të qendrueshme duke u harmonizuar me interesat dhe nevojat e komunitetit. Gjithashtu synojmë mbulimin sa më të plotë të territorit, të Bashkisë Shkodër, duke promovuar gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen, krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, gjinisë, origjinës, minoritetit etj. | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| *Objektivat e politikës*: | | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emërtimi i Treguesit të Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhës | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishiku ar ne vitin korent | Niveli faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| Objektivi 1.1 | Mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime sociale duke u harmonizuar me nevojat dhe interesat e komunitetit. | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|--|--|----|---|-----|-----|-----|-----|------|--|
| | | 1 | Numri i fëmijëve të trajtuar në situatë rruge | 50 | 50 | 60 | 60 | 100% | |
| | | 2 | Numri i familjeve në situatë rruge të mbështetura; | 20 | 20 | 20 | 20 | 100% | |
| | | 3 | Numri I fëmijëve me masë mbrojtëse të mbështetur nga NJMF | 5 | 5 | 5 | 2 | 40% | |
| | | 4 | Numri i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje të përfshirë në programet e përfshirjes sociale | 33 | 70 | 70 | 78 | 111% | |
| | | 6 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere për promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe parandalimin e formave të keqtrajtimit ndaj të miturve. | 20 | 10 | 10 | 6 | 60% | |
| | | 7 | Numri i rasteve të identifikuar / të referuara të dhunës në familje-Trendi vjetor ne % | 108 | 80 | 80 | 57 | 71% | |
| | | 8 | Numri i përfituesve nga funksionimi i sistemit të referimit - Trendi vjetor ne % | 324 | 180 | 180 | 171 | 95% | |
| | | 9 | Numri i takimeve të organizuara të ekipit Teknik i Ndërdisciplinor (ETN) | 8 | 10 | 10 | 6 | 60% | |
| | | 10 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere për dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. | 43 | 35 | 35 | 0 | 0% | |
| | | 11 | Numri i femijeve qe ndjekin klasat passhkollore | 0 | 15 | 15 | 15 | 100% | |
| | | 12 | Numri I viktimeve te dhunes me baze gjinore te mbeshtetura | 0 | 150 | 150 | 50 | 33% | |

| | | | | | | | | | |
|--------------------------|---|----|---|-----|-----|-----|-----|------|--|
| Objektivi 1.2 | Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe promovuese në nivel vendor që lidhen me shërbimet e kujdesit shoqëror në bashkërendim dhe harmonizim me strategjitë dhe politikat kombëtare. | | | | | | | | |
| | | 13 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere të organizuara në kuadër të ditës së familjes. | 7 | 7 | 7 | 7 | 100% | |
| | | 14 | Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet e organizuara në kuadër të ditës së familjes | 290 | 350 | 350 | 320 | 91% | |
| | | 15 | Numri i organizatave pjesëmarrëse në ditën e familjes | 10 | 25 | 25 | 25 | 100% | |
| | | 16 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.. | 5 | 3 | 3 | 0 | 0% | |
| | | 17 | Numri i fëmijëve pjesëmarrës | 198 | 200 | 200 | 0 | 0% | |
| | | 18 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere për "1 Qershorin" | 2 | 5 | 5 | 0 | 0% | |
| | | 19 | Numri i fëmijëve pjesëmarrës. | 300 | 250 | 250 | 0 | 0% | |
| | | 20 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere në kuadër të 8 Marsit. | 13 | 17 | 17 | 16 | 94% | |
| | | 21 | Numri i pjesëmarrësve në aktivitete –ne numer | 250 | 250 | 250 | 270 | 108% | |
| | | 22 | Numri i pjesëmarrësve vajza/gra në aktivitete –ne numer | 290 | 200 | 200 | 165 | 83% | |
| | | 23 | Numri partneriteteve me shoqërinë civile, | 5 | 5 | 5 | 5 | 100% | |

| | | | | | | | | | |
|----------------------|---|----|---|-----|-----|-----|----|------|--|
| | | | organizatat jo-fitimprurëse, | | | | | | |
| | | 24 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere në kuadër të ditës ndërkombëtare të PAN. | 7 | 7 | 7 | 0 | 0% | |
| | | 25 | Numri i përfituesve të shërbimeve ekzistuese | 250 | 250 | 250 | 0 | 0% | |
| | | 26 | Numri partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, - | 5 | 7 | 7 | 0 | 0% | |
| | | 27 | Përmirësimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimi i praktikave të mira ndërmjet partnerëve të huaj dhe aktorëve vendas në fushën e trashëgimisë kulturore. (numer takime koordinuese me partneret) | 0 | 5 | 3 | 3 | 100% | |
| Objektivi 1.3 | Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë. | | | | | | | | |
| | | 28 | Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki. | 25 | 12 | 12 | 12 | 100% | |
| | | 29 | Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e tryezave konsultative: Numri i takimeve periodike të tryezës konsultative. | 14 | 12 | 12 | 12 | 100% | |
| | | 30 | Numri i organizatave pjesëmarrëse në tryezat konsultative. | 25 | 25 | 25 | 21 | 84% | |

| | | | | | | | | | |
|----------------------|--|----|---|------|------|------|------|------|--|
| Qellimi 2 | Krijimi, ndërtimi dhe administrimi i qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. | | | | | | | | |
| Objektivi 2.1 | Ndërtimi dhe administrimi i qendrave që ofrojnë shërbime sociale me orientim promovimin dhe zhvillimin e këtyre shërbimeve. | | | | | | | | |
| | | 31 | Numri i fëmijëve dhe familjeve që marrin shërbim në qendrën e specializuar për diagnostimin e hershëm të fëmijëve me autizëm. | 16 | 20 | 20 | 16 | 80% | |
| | | 32 | Numri i qendrave sociale komunitare funksionale; | 13 | 13 | 13 | 13 | 100% | |
| | | 33 | Numri I përfituesve të shërbimeve në qendrat komunitare “Për Familjen”. | 6000 | 6600 | 6600 | 2889 | 44% | |
| | | 34 | Të moshuar të trajtuar në vit në qendrat e shërbimeve sociale. Trendi vjetor ne % | 50 | 50 | 50 | 50 | 100% | |
| | | 35 | Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese | 12 | 3 | 3 | 0 | 0% | |
| | | 36 | Numri i partneriteteve me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse- ne numer | 4 | 4 | 4 | 4 | 100% | |
| | | 37 | Shërbime Alternative të ofruara.- ne numer | 7 | 7 | 7 | 7 | 100% | |
| | | 38 | Numri I fëmijëve dhe familjeve përfituese. | 23 | 65 | 65 | 20 | 31% | |
| | | 39 | Numri i familjeve përfituese | 23 | 45 | 45 | 0 | 0% | |

| | | | | | | | | | |
|----------------------|---|----|--|------|------|------|-----|------|--|
| | | 40 | Fëmijë pa përkujdes prindëror që kanë përfituar nga shërbimet e shërbimit social Numri i jetimëve përfitues | 5 | 8 | 8 | 6 | 75% | |
| | | 41 | Numri i jetimëve të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit; | 37 | 50 | 50 | 0 | 0% | |
| | | 42 | Numri i familjeve që do të marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare për Rom dhe Egjiptian | 420 | 500 | 500 | 450 | 90% | |
| Objektivi 2.2 | O2 Konsolidimi i shërbimeve pranë qendrës rinore "Atelie" për nxitjen dhe promovimin e pjesëmarrjes aktive në formim profesional e edukim, aktivitete artistike, kulturore dhe sociale për të rinjtë e Bashkisë Shkodër. | | | | | | | | |
| | | 43 | Numri i të rinjve përfitues në shërbimet e Qendrës Rinore. | 3482 | 1200 | 1200 | 950 | 79% | |
| | | 44 | Numri i shërbimeve të ofruara në qendër për të rinjtë si: muzikë, kërcim, kurse profesionale, teatër, arte pamore, biznes social, etj. | 6 | 6 | 6 | 6 | 100% | |
| Qellimi 3 | Bashkëpunimi dhe bashkërendimi me ministrinë përgjegjëse për mirëqënien sociale, donatorët, shoqërinë civile, për krijimin e fondeve për financimin e shërbimeve sociale sipas mënyrës së përcaktuar me ligj | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|--------------------------|--|----|---|-----|-----|-----|-----|------|--|
| Objektivi 3.1 | Krijimi i fondit të dedikuar për financimin e shërbimeve sociale në bashkërendim Bashki - Ministri - Donatorë / Shoqëri Civile. | | | | | | | | |
| | | 45 | Numri i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor. | 25 | 30 | 30 | 0 | 0% | |
| | | 46 | Numri i fëmijëve në nevojë që marrin pjesë dhe performojnë në aktivitetin artistiko-kulturor. | 25 | 25 | 25 | 32 | 128% | |
| | | 47 | Përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale: Numri i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAK. | 8 | 8 | 8 | 8 | 100% | |
| | | 48 | Përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale: Numri i përfituesve Opera Madonnina del Grapa + Projekti Shpresa- | 77 | 77 | 80 | 80 | 100% | |
| | | 49 | Shërbimet e ofruara për PAK në shtëpi-familje;- | 5 | 5 | 5 | 5 | 100% | |
| | | 50 | Përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuar në qendrat rezidenciale: i) Eficienca buxhetore për mbështetjen e personave PAK: Shpenzimet totale në qendrat e shërbimeve | 476 | 484 | 506 | 279 | 55% | |

| | | | | | | | | | |
|----------------------|---|----|--|---------|---------|---------|---------|------|--|
| | | | PAK kundrejt numrit total të personave të akomoduar në këto qendra; | | | | | | |
| | | 51 | Numri i familjeve përfituese Trendi vjetor në përqindje. | 130 | 200 | 200 | 165 | 83% | |
| | | 52 | Numri i fëmijëve përfitues që jetojnë në institucionet rezidenciale; - | 63 | 80 | 80 | 80 | 100% | |
| Objektivi 3.2 | Identifikimi i individëve dhe familjeve në nevojë të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. | | | | | | | | |
| | | 53 | Numri i personave të asistuar me pagesë paaftësie | 3808 | 4500 | 4043 | 3765 | 93% | |
| | | 54 | Përfitimi monetar (në mijë lekë) për paaftësi | 693,093 | 708,980 | 337,824 | 381,507 | 113% | |
| | | 55 | Numri i personave të asistuar me pagesë invaliditeti | 3224 | 3224 | 3388 | 3112 | 92% | |
| | | 56 | Përfitimi monetar (në mijë lekë) për invaliditet | 122,273 | 111,020 | 61,968 | 69,763 | 113% | |
| | | 57 | Numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike | 1833 | 2400 | 2373 | 1673 | 71% | |
| | | 58 | Përfitimi monetar (në mijë lekë) për Ndihme Ekonomike | 191,774 | 160,000 | 82,457 | 100,201 | 122% | |
| Qellimi 4 | Q4. Administrimi, rregullimi dhe zhvillimi i shërbimeve të sistemit parashkollor për mirërritjen e fëmijëve 0-3 vjeç. | | | | | | | | |



| | | | | | | | | | |
|--------------------------|---|----|--|-----|-----|-----|-----|------|--|
| Objektivi 4.1 | O1.Krijimi, zgjerimi dhe zhvillimi i shërbimeve për fëmijët e moshës 0-3 vjeç. | | | | | | | | |
| | | 59 | Përmirësimi i shërbimit në çerdhet: Numri i çerdheve - Ndryshimi vjetor në numër | 6 | 7 | 7 | 6 | 86% | |
| | | 60 | Përmirësimi i shërbimit në çerdhet: Numri i fëmijëve përfitues të shërbimit - Ndryshimi vjetor në numër | 249 | 310 | 249 | 211 | 85% | |
| | | 61 | Raporti vajza që frekuentojnë çerdhet | 114 | 150 | 114 | 98 | 86% | |
| | | 62 | Numri i stafit për fëmijë | 68 | 68 | 68 | 68 | 100% | |
| | | 63 | Numri i Çerdheve të reja dhe të rikonstruara | 0 | 1 | 1 | 0 | 0% | |
| | | 64 | Numri I femijeve te perjashtuar nga tarifa e çerdheve | 0 | 28 | 28 | 0 | 0% | |

Realizimi i produkteve:

ANEXSI nr.3 "Raporti përmblledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| | | | |
|---------------|---|------------------|-------|
| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
| Programi | Kujdesi social për familjet dhe fëmijët | Kodi i Programit | 10430 |

| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2022) | Shpenzi met (sipas vitit 2022) | I | | II | | III | | IV | | Luhatjet në Koston për Njësi | | | Komente | | |
|------|---|------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|--|--|--|--|--|---------------------------|---------------------------------|-------------------------------------|------------|---------|-------------|--------------|
| | | | | | Kosto për Njësi (sipas vitit 2022) | Sasia (sipas planit të vitit 2023) | Shpenzi met (sipas planit të vitit 2023) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2023) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Shpenzi met (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzi met Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2023) | V = IV - I | | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Ndërgjegjësim i komunitetit mbi fenomenin e lypjes | fushatë ndërgjegjësimi | 1 | 98 | 98.0 | 1 | 100 | 100.0 | 1 | 100 | 100.0 | | | | -98.0 | -100.0 | -100.0 | |
| 2 | Numri i fëmijëve me masë mbrojtje të mbështetur nga NJMF | numër | 9 | 0 | 0.0 | 5 | 200 | 40.0 | 5 | 200 | 40.0 | 2 | | 0.0 | 0.0 | -40.0 | -40.0 | |
| 3 | Numri i fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje të përfshirë në programet e kujdesit shoqëror të ofruar nga NJMF dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve. | numër | 33 | 0 | 0.0 | 70 | 100 | 1.4 | 70 | 100 | 1.4 | 78 | | 0.0 | 0.0 | -1.4 | -1.4 | |
| 4 | Fushatë ndërgjegjësimi kundër dhunës me bazë gjinore, promovimi i familjes | fushatë ndërgjegjësimi | 3 | 280 | 93.3 | 1 | 200 | 200.0 | 1 | 200 | 200.0 | | | | -93.3 | -200.0 | -200.0 | |
| 5 | Numri i rasteve të mbështetura nga projekti TVESA | numri rasteve të mbështetura | | | | 150 | 3,220 | 21.5 | 150 | 5,973 | 39.8 | 50 | 2,239 | 44.8 | 44.8 | 23.3 | 5.0 | |
| 6 | Miratimi i Planit Social Vendor | Plan social i miratuar | | | | 1 | | 0.0 | 1 | | 0.0 | | | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|---|--|-----|--------|---------|-----|--------|---------|-----|--------|---------|-----|--------|---------|----------|---------|----------|--|
| 7 | Komunitet i ndërgjegjësuar në nivel vendor në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror. | numër aktivitetelesh | 4 | 208 | 52.0 | 38 | 942 | 24.8 | 38 | 1,934 | 50.9 | 26 | 525 | 20.2 | -31.8 | -4.6 | -30.7 | |
| 8 | Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki. | Numri i studentëve | 25 | | 0.0 | 12 | | 0.0 | 12 | | 0.0 | 12 | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | |
| 9 | Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile (numri i tryezave konsultative të organizuara) | numri i tryezave konsultative të organizuara | 14 | | 0.0 | 12 | | 0.0 | 12 | | 0.0 | 12 | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | |
| 10 | Fëmijë që marrin shërbim në qendrën e specializuar për diagnostimin e hershëm të fëmijëve me autizem. | Numri i fëmijëve që marrin shërbim | 16 | | 0.0 | 20 | 100 | 5.0 | 20 | 100 | 5.0 | 16 | | 0.0 | 0.0 | -5.0 | -5.0 | |
| 11 | Numri i Qendrave sociale komunitare funksionale; | Numri i Qendrave | 13 | 12,615 | 970.4 | 13 | 19,918 | 1,532.2 | 13 | 21,237 | 1,633.6 | 13 | 10,107 | 777.5 | -192.9 | -754.7 | -856.2 | |
| 12 | Promovimi dhe Zhvillimi i Shërbimeve Alternative. | Fushatë ndërgjegjësimi | 1 | 97 | 97.0 | 1 | 100 | 100.0 | 1 | 100 | 100.0 | | | | -97.0 | -100.0 | -100.0 | |
| 13 | Vënia në funksion e strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror | Jetimë përfitues | 5 | 3,553 | 710.6 | 8 | 13,184 | 1,648.0 | 8 | 12,906 | 1,613.3 | 6 | 4,900 | 816.7 | 106.1 | -831.3 | -796.6 | |
| 14 | Jetimë të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit | numri i jetimëve | 37 | 370 | 10.0 | 50 | 400 | 8.0 | 50 | 400 | 8.0 | | | | -10.0 | -8.0 | -8.0 | |
| 15 | Familje Rome dhe Egjiptiane, që marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare | numër individësh të mbështetura | 420 | 83 | 0.2 | 500 | 100 | | 500 | 100 | 0.2 | 450 | | 0.0 | -0.2 | 0.0 | -0.2 | |
| 16 | Shërbime të ofruara në qendër për të rinjtë | numri i shërbimeve | 6 | | 0.0 | 6 | | | 6 | | 0.0 | 6 | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | |
| 17 | Aktivite gjithëpërfshirëse për fëmijë në kuadër të festave të fundvitit | numri i aktiviteteve | 1 | 220 | 220.0 | 1 | 271 | | 1 | 271 | 271.0 | | | | -220.0 | 0.0 | -271.0 | |
| 18 | Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe" | Trupa Muzikore | 1 | 367 | 367.0 | 1 | 369 | | 1 | 449 | 449.0 | 1 | 233 | 233.0 | -134.0 | 233.0 | -216.0 | |
| 19 | Numri i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAK. | numri i shtëpive familje | 8 | 36,367 | 4,545.9 | 8 | 37,233 | | 8 | 40,492 | 5,061.5 | 8 | 22,290 | 2,786.3 | -1,759.6 | 2,786.3 | -2,275.3 | |
| 20 | Përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë | numër personash | 63 | | 0.0 | 80 | | | 80 | | 0.0 | 80 | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | |
| 21 | Të moshuar që marrin shërbim pranë rrjetit të qendrave komunitare për familjen. | numri i të moshuarve | 159 | | 0.0 | | | | | | | | | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | |
| 22 | Mbledhja dhe prezantimi i historive të persekutimeve fetare në Shkodër gjatë periudhës së komunizmit në eventin që do të organizohet. | numri i të rinjve | 22 | 867 | 39.4 | | | | | | | | | | -39.4 | 0.0 | 0.0 | |
| 23 | Komunitet i ndërgjegjësuar në nivel vendor në trashëgiminë kulturore. | numër takimesh | 3 | 872 | 290.7 | | | | | | | | | | -290.7 | 0.0 | 0.0 | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|--|--------------------|-------|---------|-------|-------|---------|----------|-------|---------|----------|-------|---------|-------|--------|-----------|-----------|--|
| 24 | Persona të asistuar me pagesë paaftësie dhe invaliditeti | numër perfituesish | 7,032 | 815,366 | 116.0 | 7,724 | 820,000 | 106.2 | 7,431 | 660,677 | 88.9 | 6,823 | 451,270 | 66.1 | -49.8 | -40.0 | -22.8 | |
| 25 | Familje dhe individë ne nevojë që përfitojnë nga skema e Ndlhmes ekonomike | numër perfituesish | 1,833 | 191,774 | 104.6 | 2,400 | 160,000 | 66.7 | 2,373 | 139,667 | 58.9 | 1,673 | 100,201 | 59.9 | -44.7 | -6.8 | 1.0 | |
| 26 | Fëmijë përfitues të shërbimit të çerdheve | numri i fëmijëve | 249 | 46,496 | 186.7 | 310 | 54,887 | 177.1 | 249 | 55,571 | 223.2 | 211 | 32,254 | 152.9 | -33.9 | -24.2 | -70.3 | |
| 27 | Përmirësimi i infrastrukturës në institucionet e çerdheve | godinë | 1 | 541 | 541.4 | 1 | 10,000 | 10,000.0 | 1 | 19,304 | 19,304.0 | | | | -541.4 | -10,000.0 | -19,304.0 | |
| 28 | Numri fëmijëve të mbeshtetur | numri i fëmijëve | | | 0.0 | 28 | 1,122 | 40.1 | 28 | 1,122 | 40.1 | | | | 0.0 | -40.1 | -40.1 | |

Për vitin 2023 në Programin “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar këto aktivitete.

| Produktet | Aktivitete /Projekte | Institucioni | Statusi I Aktiviteteve | Plani fillestar 2023 | Plani i rishikuar 2023 | Realizimi 8M 2023 |
|--|--|-----------------|------------------------|----------------------|------------------------|-------------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Ndërgjegjësimit i komunitetit mbi fenomenin e lypjes (numer fëmijëve të identifikuar dhe trajtuar në situatë rruge) | P10430.Q1.O1.A1 Masat për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge. | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 100 | 100 | - |
| Numri I fëmijëve me masë mbrojtje të mbështetur nga NJMF | P10430.Q1.O1.A2 Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 200 | 200 | - |
| Nr. i fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje të përfshirë në programet e kujdesit shoqëror të ofruar nga NJMF dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve. | P10430.Q1.O1.A3. Koordinimi i punës për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo nevojë për mbrojtje (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve) | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 100 | 100 | - |
| Numri i rasteve të identifikuar / të referuara dhe të menaxhuara të dhunës në familje | P10430.Q1.O1.A4. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 200 | 200 | - |
| Numri i rasteve të mbështetura nga projekti | P10430.Q1.O1.A5 TVESA@SH– Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër & të trashëguara LLOGARI JASHTE THESARI | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 3,220 | 5,973 | 2,239 |
| | P10430.Q1.O1.A6 Përgatitja, përditësimi dhe miratimi i Planit Social Vendor | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | - | - | - |
| | P10430.Q1.O2.A1. Dita | Bashkia | Realizuar | | | |

| | | | | | | |
|--|--|-----------------|--|-----|-----|-----|
| Komunitet i ndërgjegjësuar në nivel vendor në lidhje me shërbimet e kujdesit shoqëror. (numër aktivitetesh) | ndërkombëtare për familjen – 15 maj | Shkodër | pa efekte financiare | 50 | 50 | - |
| | P10430.Q1.O2.A2. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore. | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 150 | 150 | - |
| | P10430.Q1.O2.A3. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori. | Bashkia Shkodër | Parashikuar për tu realizuar në muajin Nëntor | 50 | 50 | - |
| | P10430.Q1.O2.A4. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori" | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | - | - |
| | P10430.Q1.O2.A5.Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi | Bashkia Shkodër | Realizuar | 100 | 100 | 80 |
| | P10430.Q1.O2. A6. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, më 3 Dhjetor & trashëguar | Bashkia Shkodër | Parashikuar për tu realizuar në muajin Dhjetor | 200 | 207 | - |
| | Projekti: P10430.O6.A2 PEOPLE– Histori personale të diskriminimit dhe persekutimit nën regjimet totalitare të shekullit XX (PEOPLE - Personal stories of discrimination and persecution under the totalitarian regimes of the XX century)- TE TRASHHEGUARA | Bashkia Shkodër | Realizuar | - | 483 | 372 |

| | | | | | | |
|--|--|-----------------|---------------------|--------|--------|--------|
| | P10430.Q1.O2.A7. FARO – Trashëgimi të ndryshme në Qytezat Europiane – Krijimi i një narrative europiane të identiteteve të kontestuara përmes pjesëmarrjes së qytetarëve. (FARO – The Dissonant Heritage in European Towns – Creating a European narrative of contested identities through citizens’ participation) & trashëguar | Bashkia Shkodër | Realizuar | 392 | 894 | 73 |
| Numri i studentëve që zhvillojnë praktikën mësimore në Bashki. | P10430.Q1.O3.A1. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | - | - | - |
| Partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile (numri I tryezave konsultative të organizuara) | P10430.Q1.O3.A2.Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës; | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | - | - | - |
| Fëmijë që marrin shërbim në qendrën e specializuar për diagnostimin e hershëm të fëmijëve me autizem. | P10430.Q2.O1.A1. Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 100 | 100 | - |
| Numri i Qendrave sociale komunitare funksionale; | P10430.Q2.O1.A2. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare “Për Familjen” & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 19,868 | 21,187 | 10,107 |
| | P10430.Q2.O1. A3. Kujdesi social ndaj moshës së tretë | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 50 | 50 | - |
| Promovimi dhe Zhvillimi i | P10430.Q2.O1.A4.Shërbime alternative për | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 100 | 100 | - |

| | | | | | | |
|--|--|-----------------|--|--------|--------|--------|
| Shërbimeve Alternative. | fëmijët dhe familjen. | | | | | |
| Vënia në funksion e strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror | P10430.Q2.O1.A5. Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 13,184 | 12,906 | 4,900 |
| Jetimë të mbështetur me rastin e festave të fundit të vitit | P10430.Q2.O1.A6. Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit | Bashkia Shkodër | Parashikuar për tu realizuar në muajin Dhjetor | 400 | 400 | - |
| Familje Rome dhe Egjiptiane, që marrin shërbime pranë Qendrës Komunitare | P10430.Q2.O1.A7 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 100 | 100 | - |
| Shërbime të ofruara në qendër për të rinjtë (në numër) | P10430.Q2.O2.A1. Qendra Rinore "Atelie" | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | - | - | - |
| Aktivitete gjithëpërfshirëse për fëmijë në kuadër të festave të fundvitit | P10430.Q3.O1. A1. “Asnjë Fëmijë Jashtë” | Bashkia Shkodër | Parashikuar për tu realizuar në muajin Dhjetor | 271 | 271 | - |
| Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi Ndryshe” | P10430.Q3.O1. A2. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi të kufizuar” & trashëguar | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 369 | 449 | 233 |
| Nr. i shtëpive familje funksionale dhe në shërbim të PAK. | P10430.Q3.O1. A3. Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa & trashëguar | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 16,891 | 18,229 | 9,033 |
| | P10430.Q3.O1. A4. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi të kufizuar & trashëguar | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 20,342 | 22,263 | 13,257 |
| Përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë (numër personash) | P10430.Q3.O1.A5. Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë. | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | - | - | - |

| | | | | | | |
|---|--|------------------------------------|---------------------|------------------|----------------|----------------|
| Persona të asistuar me pagesë paaftësie dhe invaliditeti | P010430.Q3.O2.A1. Pagesë PAK dhe Invaliditeti. | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 820,000 | 660,677 | 451,270 |
| Familje dhe individë ne nevojë që përfitojnë nga skema e Ndhimes ekonomike | P010430.Q3.O2.A2. Ndhima ekonomike. | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 160,000 | 139,667 | 100,201 |
| Fëmijë përfitues të shërbimit të çerdheve (në numër) | P10430.Q4.O1.A1. Administrimi dhe funksionimi i çerdheve & të trashëguara | Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve | Në proces realizimi | 54,887 | 55,571 | 32,254 |
| Përmirësimi i infrastrukturës në institucionet e Çerdheve (numër çerdhe) | P10430.Q4.O1.A2. Rikonstruksioni i çerdhes “Manush Alimani”.& të trashëguara | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 10,000 | 19,304 | - |
| Nr. I fëmijeve të mbështetur | P10430.Q4.O2.A3. Subvencionimi për mbështetjen e shërbimit pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve në nevojë dhe fëmijët me aftësi të kufizuar | Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve | Në proces realizimi | 1,122 | 1,122 | - |
| | 10430 Kujdesi social për familjet dhe fëmijet | | | 1,122,446 | 960,903 | 624,019 |
| | Te trashëguara | | | 38,467 | 19,915 | - |
| | Totali | | | 1,160,913 | 980,818 | 624,019 |

P10430.Q1.O1.A1 Masat për Identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge.

Në kuadrin e nënshkrimit të Marrëveshjes Bashkëpunimit midis MMSR, MAS dhe MPB “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge dhe Planit Kombëtar të Veprimit “Ndhimë për Familjet dhe Fëmijët në situatë rruge”, është hartuar dhe vazhdon të zbatohet Plani lokal i veprimit, ku bashkia (NJMF), ka përgjegjësinë kryesore për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve dhe koordinimin e punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse, brenda territorit të qytetit. Vazhdojnë të funksionojnë skuadrat e terrenit me përfaqësues të Bashkisë Shkodër, stafi i qendrave komunitare, përfaqësues të Policisë të cilët janë trajnuar, kanë qenë dhe janë prezent në territor sipas një kalendari të paracaktuar. Në zbatim të ligjit 18/2017 “ Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, Bashkia Shkodër po koordinon Mbledhjet e Grupit Teknik Ndërsektorial me përfaqësues nga të gjitha institucionet publike vendore dhe organizatat partnere ku janë diskutuar rastet për çdo familje të fëmijëve në situatë rruge. Gjithashtu janë hartuar plane individuale ndërhyrjeje për fëmijët në situatë rruge me qëllim mbështetjen dhe përmirësimin e situatës së këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. Nr. i fëmijëve të identifikuar në situatë rruge si dhe të mbështetur

është 45. Për secilën familje të identifikuar janë ofruar ndihma në veshmbathje, ushqime, asistencë ligjore, ndërmjetësim për punësim, ndihmë ekonomike, rregjistrim i fëmijëve në shkollë dhe kopshte, monitorim për frekuentimin dhe ecurinë e fëmijëve në shkollë sipas vlerësimeve dhe planeve individuale të ndërhyrjes. Në ditën ndërkombëtare të fëmijëve në situatë rruge, me datë 12 prill, u zhvilluan aktivitete ndërgjegjësuese, në Qendën Komunitare Multifunkionale “Për familjen”, të cilat kishin si qëllim rritjen e ndërgjegjesimit ndaj fenomenit të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve duke përfshirë dhe fëmijët në situatë rruge. Gjithashtu me datë 8 prill, Dita ndërkombëtare e Romëve, u zhvilluan aktivitete ndërgjegjësuese në Qendrën Komunitare Multifunkionale “Për familjen” dhe në shkolla të ndryshme të qytetit për të promovuar kulturën e traditat rome dhe njëkohësisht për të promovuar integrimin dhe përfshirjen e tyre sociale. Gjatë sezonit të verës janë shtuar skuadrat e terrenit me qëllim identifikim e fëmijëve në situatë rruge në pikat me “hot spot” të qytetit. Me qëllim uljen e numrit të fëmijëve në situatë rruge janë realizuar tryeza me Drejtorinë Vendore të Policisë ku janë përcaktuar nevojat dhe problematikat që janë hasur gjatë monitorimit të terrenit.

P10430.Q1.O1.A2 Fuqizim dhe shtrirje e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Në bashkinë Shkodër vazhdon të jetë funksionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje. Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial, të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.

Gjatë 8 mujorit të vitit 2023 janë organizuar disa mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe janë marrë masa mbrojtëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative. Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” neni 46 pika gj bashkitë janë përgjegjëse për financimin e Planit Individual të Mbrojtjes së Fëmijës dhe Planit për Aftësim Prindëror. Në këtë kuadër për funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, Bashkia Shkodër ka planifikuar të financojë shërbimet sociale mbështetëse, si pako ushqimore dhe higjeno- sanitare, si dhe veshmbathje për fëmijët me masë mbrojtëse dhe familjen me qëllim fuqizimin social ekonomik të familjes si qeliza bazë e shoqërisë.

P10430.Q1.O1.A3. Koordinimi i punës për parandalimin, identifikimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik apo nevojë për mbrojtje (Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve).

Njësitë e qeverisjes vendore kanë autoritetin për ngritjen në nivel bashkie dhe në nivel njësie administrative stuktura të posaçme për mbrojtjen e fëmijëve sipas Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Në bashkinë Shkodër vazhdon të jetë funksionale njësia e mbrojtjes së fëmijëve si një njësi e posaçme brenda strukturës së drejtorisë së shërbimeve sociale dhe ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për

mbrojtje. Për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, drejtori i strukturës përgjegjëse ose punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve mbledh grupin teknik ndërsektorial, të cilët janë aktorët përgjegjës për zbatimin e masave të mbrojtjes së fëmijës si dhe për zbatimin e planit individual të mbrojtjes për ndjekjen dhe menaxhimin e rastit.

Gjatë 8 mujorit të vitit 2023 janë organizuar mbledhje të grupit teknik ndërsektorial me qëllim trajtimin, menaxhimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje si dhe janë marrë masa mbrojtëse për fëmijët në nevojë për mbrojtje, duke vendosur fëmijën pranë një strukture të përkujdesjes alternative. Në zbatim të Ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” neni 59 pika 4 punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së vendimit për masën përkatëse të mbrojtjes nga drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore, depoziton në gjykatën kompetente kërkesën për vlefshmërinë e masës emergjente të mbrojtjes ose të masës së mbrojtjes për vendosjen e fëmijës në përkujdesje alternative, e cila përmban edhe kërkesën për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Gjykata shqyrton dhe vendos, brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës përkatëse nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës, për vlefshmërinë e masës së mbrojtjes duke shqyrtuar edhe ankimet përkatëse të paraqitura nga palët. Kur gjykata vendos dhënien e masës së mbrojtjes, atëherë ajo vazhdon gjykimin edhe për shqyrtimin e kërkesës për vendosjen e fëmijës në kujdestari, sipas legjislacionit në fuqi. Me qëllim marrjen e vendimit të gjykatës për caktimin e kujdestarisë ligjore të të miturit në nevojë për mbrojtje, kërkohet mendimi i një eksperti psikolog i paanshëm sipas listës të vënë në dispozicion nga ana e Gjykatës që të realizojë vlerësimin lidhur me kujdestarinë ligjore të të fëmijës në nevojë për mbrojtje. Caktimi i shpenzimeve për ekspertët në gjykatë bazohet në Udhëzimin nr 4 datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesat e ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.

P10430.Q1.O1.A4. Zbatimi i sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje.

Njësitë e qeverisjes vendore, si autoritete përgjegjëse në luftën kundër dhunës në familje, kanë detyrim ligjor ngritjen dhe funksionimin e sistemit të referimit të rasteve për viktimat e dhunës në familje. (ligji nr.9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar me ligjin nr.47/2018 dhe VKM nr. 334, datë 17. 02. 2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit tij”, i ndryshuar me VKM Nr.327, datë 02.06.2021). Në bashkinë e Shkodrës, që në shkurt të vitit 2017, nga drejtuesit e institucioneve vendore, rajonale dhe organizatave të shoqërisë civile që veprojnë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje, është arritur firmosja e marrëveshjes së bashkëpunimit për riorganizimin dhe ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Në kuadër të ndërgjegjësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore gjatë kësaj periudhe. Janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Mijeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Krahas këtyre aktiviteteve, fushatat e komunikimit online, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit të komunitetit për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, janë organizuar vazhdimisht përgjatë të gjithë kësaj periudhe me anë të

postimeve në mediat sociale të Bashkisë Shkodër dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik. Bashkia Shkodër për këtë periudhë ka trajtuar, menaxhuar dhe monitoruar 45 raste të reja të pajisura me urdhër mbrojtje nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjithashtu ka vazhduar trajtimi i rasteve nga viti 2022. Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe konsolidimi i tyre. Për të gjithë rastet janë hartuar dhe dërguar raportet përkatëse të monitorimit çdo 60 ditë në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër. Në varësi të nevojave viktimat e dhunës në familje, kanë marrë mbështetjen e duhur psikologjike dhe ligjore nga stafi i Qendrave Komunitare “Për familjen” të Bashkisë Shkodër dhe organizatat partnere që ofrojnë të tilla shërbime në Bashkinë Shkodër.

P10430.Q1.O1.A5 TVESA@SH– Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër & të trashëguara

Projekti: “Konsolidimi i sistemeve për fuqizimin e viktimave në Shqipëri @Shkodër (TVESA@SH)”, zbatohet nga organizata Të Ndryshëm të Barabartë në rolin e Liderit të Projektit, ku Bashkia Shkodër dhe organizata KMOP (Greqi) janë partnerë. Projekti është përzgjedhur për financim në kuadër të thirrjes për propozime: EuropeAid/170610/DD/ACT/AL – “Partneritete në nivel lokal për avancimin e përfshirjes sociale në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian me fonde të programit IPA. Ky projekt sa i takon pjesës së Bashkisë Shkodër parashikon ndërhyrjen në infrastrukturën e qendrës komunitare “Për Familjen” Nj.A. Dajç, fshati Shirq, si dhe fuqizimin e kësaj qendre duke ofruar shërbime në ndihmë të grave dhe fëmijëve viktimat të dhunës të të gjithë bashkisë.

Buxheti total i projektit është 39,651,431.8 Lekë, nga të cilat financimi i Bashkimit Evropian do të jetë në masën 90% të kostove të pranueshme në vlerën 35,686,290.3 Lekë. **Buxheti i dedikuar për Bashkinë Shkodër është në vlerën 8,739,629.5 Lekë nga të cilat 90% në vlerën 7,865,673.7 Lekë do të financohen nga donatori dhe 10% do të jetë bashkëfinancim I Bashkisë Shkodër me anë të burimeve të veta (staf ekzistues).**

Shpenzimet e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve nuk njihen si kosto të pranueshme nga donatori. Fondi me vlerë 447,000 lekë i cili mbulon vlerën e TVSH-së dhe garancisë 5% të punimeve, është marrë nga teprica e fondeve nga buxheti i miratuar tek programi 9240 “Arsimi i mesëm profesional”, artikull 231, me kod projekti 1410562 me emërtim “Rikonstruksioni i objektit të ish-shkollës veterinarë”, kontrata me Nr. 18397/12 Prot., datë 20.12.2021 me vlerë 10,056,694 lekë. Ky fond kalon tek programi 10430 “Kujdesi social për familjet dhe fëmijët”, kod 231, me emërtim “Mbulim i vlerës TVSH dhe 5% garanci”.

Projekti është miratuar me VKB nr. 49, datë 27.09.2022 “Për miratim shtesë plani ne buxhetin e Bashkisë Shkodër”. Gjatë kësaj periudhe janë kryer procedurat e hapjes së llogarisë në bankën e nivelit të dytë, ku është transferuar kësti i parë me vlerë 3,867,458 lek. Me shkresën nr. 17778/1 Prot. Datë 24.10.2022 “Transferim fondi për shpenzime kapitale”, është transferuar nga SASPAC fondi i parashikuar për bashkëfinancim në vlerën 882,205 lekë.

Janë zhvilluar 3 mbledhje të Komitetit Drejtues të projektit ku janë vendosur prioritetet, janë përcaktuar përmbajtjet për materialet promocoionale, janë diskutuar gjetjet nga analiza e nevojave që u është bërë stafit të bashkisë, dhe janë finalizuar disa nga figurat profesionale të punësuar në Shkodër, por të kontraktuar nga organizata Të Ndryshëm Të Barabartë: 1. Punonjës Social 2. Koordinator për Fuqizimin

Ekonomik. Është realizuar procedura e rekrutimit të oficerit të projektit. Kanë përfunduar ndërhyrjet për përmirësimin e infrastrukturës së qendrës komunitare “Për Familjen” Nj.A. Dajç. Ka përfunduar ndërhyrja në infrastrukturën e Klubit Social në Dajç sipas vlerësimit të nevojave të bërë nga Bashkia e Shkodrës dhe Të Ndryshem dhe Të Barabartë

Proçedura për Shpenzime Materiale Didaktike/Lodra për Fëmijë – për objektin e Klubit Social Nj.A. Dajç është në proces prokurimi.

Janë hartuar termat e referencës për rekrutimin e mësueses kryesore dhe mësueses ndihmëse. Gjithashtu janë caktuar datat për zhvillimin e takimeve me nënat dhe aktorët e tjerë në zonë për identifikimin dhe përzgjedhjen e fëmijëve që do të jene pjesë e kujdesit alternativ në Klubin Social Nj.A.Dajç.

P10430.Q1.O1.A6 Përgatitja, përditësimi dhe miratimi i Planit Social Vendor.

Plani Social i Bashkisë Shkodër 2018-2021 ka përcaktuar objektivat dhe prioritetet strategjike për një periudhë katër vjecare me qëllim që të sigurojë dhe ofrojë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Plani Social i Bashkisë Shkodër 2018-2021 është një material strategjik në të cilin janë vendosur dhe po zbatohen vizionet, politikat dhe objektivat e shërbimit social në bashkinë Shkodër. Deri tani një pjesë e rëndësishme e këtij plani është zbatuar, si dhe gjithashtu vazhdon puna për zbatimin e pjesës së mbetur, duke krijuar një nga modelet më të suksesshme të shërbimit social në nivel vendor, në mbarë vendin.

Kemi realizuar një proces vlerësimi të punës së bërë deri tani, të rezultateve dhe të përgatitjes së Planit të ri 5 vjeçar, duke e koordinuar dhe bashkërenduar me Planin 5 vjeçar të Strehimit Social të Bashkisë Shkodër 2023-2027, i cili është përfunduar, duke sjellë synuar për të sjellë kështu përherë të parë nje Plan Social në të cilin do të përfshihet edhe Strehimi Social.

Ky plan social do të udhëheq zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror të bashkisë Shkodër duke ndërtuar mbi eksperiencën dhe tëresinë e shërbimeve ekzistuese dhe duke i pasuruar ato me shërbime të reja të domosdoshme për territorin e mbuluar. Ai është dokumenti kryesor që do të orientojë punën për ngritjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror si dhe do të bashkërendojë përpjekjet e aktorëve të ndryshëm. Zhvillimi i shërbimeve kryhet në përputhje me kornizën ligjore, të politikave apo strategjive kombëtare si dhe ato rajonale e vendore.

Plani Social i zonës përfaqëson një instrument thelbësor nëpërmjet të cilit Bashkia e Shkodrës, në bashkëpunim me të gjithë institucionet publike, individët, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin privat, harton sistemin e integruar të ndërhyrjeve dhe të shërbimeve sociale. Ai është një instrument bazë për vlerësimin e nevojave, planifikimin e aktiviteteve, realizimin e monitorimin e vazhdueshëm të shërbimeve sociale, si dhe për hartimin e politikave lokale sociale dhe planifikimin e projekteve sociale.

Planifikimi strategjik i shërbimeve të kujdesit social në Shkodër është bazuar në prioritetet dhe nevojat kryesore për shërbime të kujdesit shoqëror të përcjella nga vetë komuniteti dhe aktor kyç të bashkisë, në funksionet e bashkisë në fushën e shërbimeve sociale, në llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në

analizën e të dhënave aktuale të bashkisë dhe shërbimeve ekzistuese, në praktikat më të mira ndër vite, të cilat çojnë drejt përbushjes së vizionit të përcaktuar nga Bashkia Shkodër. “Shërbime sociale multisektoriale të qëndrueshme dhe të standartizuara pranë komunitetit në mbështetje dhe fuqizim të familjes si qeliza bazë e shoqërisë”.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 6 takime me përfaqësues të grupeve target. Aktualisht jemi në proces buxhetimi të draftit të parë të këtij plani.

Me tërësinë e veprimtarisë së detajuar në Planin Social Vendor do të përbushen nevojat për mbrojtje, përkujdesje, rehabilitim, përfshirje sociale dhe riintegrim të individëve në përbushje të përgjegjësive të reja që rrjedhin për bashkitë në respektim të legjislacionit në fuqi.

P10430.Q1.O2.A1. Dita ndërkombëtare për familjen – 15 maj

Në Ditën Ndërkombëtare të Familjes në gjithë botën organizohen aktivitete në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, që kanë në fokus familjen, duke e përqëndruar vëmendjen tek proceset shoqërore, ekonomike dhe demografike që prekin familjet. Gjithashtu fokusi i kësaj dite është promovimi i vlerave të familjes, nxitja e barazisë midis grave dhe burrave në familje, mbrojtja e familjes si njësi bazë e shoqërisë dhe mundësia për të ndihmuar familjet për të përbushur përgjegjësinë e tyre për komunitetin ku bëjnë pjesë. Në territorin e bashkisë së Shkodrës, ekziston një numër i madh familjesh në vështirësi të theksuara sociale e ekonomike. Situata në të cilën ndodhen këto familje vjen si shkak i ndikimit të një sërë faktorësh si: niveli i ulët arsimor, kulturor, ekonomik, etj. Si pasojë të faktorëve të lartpërmendur, këto familje shpesh herë kanë mungesë informacioni, nuk marrin interesim për shërbimet sociale që ofrohen në territor dhe jetojnë në kushte ekstreme varfërie. Duke qenë se Bashkia e Shkodrës që nga viti 2016, arriti ngritjen dhe vënien në funksion të qendrave komunitare të quajtura ”Për Familjen”, duke parë familjen si qeliza bazë për zhvillimin e komunitetit, sivjet në kuadër të ditës ndërkombëtare për familjen janë planifikuar një javë me aktivitete nën moton ”Me familjen, Për familjen”. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare “Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

P10430.Q1.O2.A2. Zbatimi i kartës evropiane për barazi gjinore.

Barazia e grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë dhe një vlerë thelbësore për çdo demokraci. Për t’u arritur kjo e drejtë, duhet që ajo jo vetëm të njihet me ligj, por edhe të zbatohet me efektivitet në të gjitha sferat e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipave të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë. Janë aq të shumta fushat e jetës në të cilat mund të veprohet, përmes përdorimit të një qasjeje të re dhe realizimit të ndryshimeve strukturore. Për këtë, Bashkia e Shkodrës, pas nënshkrimit të kartës evropiane për barazi gjinore, është angazhuar në hartimin dhe miratimin e planit vendor gjinor si një mjet i rëndësishëm i zbatimit në

praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Shkodër në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, si dhe vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet e shoqërisë. Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar, organizuar dhe zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuere në kuadër të 8 marsit, ditës ndërkombëtare të gruas dhe në zbatim të kartës evropiane për barazi mes burrave dhe grave, të nënshkruar në vitin 2017, sipas një kalendari të paracaktuar. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare "Për Familjen", shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka "Marin Barleti", Muzeu "Oso Kuka", Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative.

P10430.Q1.O2.A3. Aktivitet ndërgjegjësuere në kuadër të ditës ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntori.

20 Nëntori "Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve" synon të promovojë mirëqenien e fëmijëve, të parandalojë çdo formë dhune apo abuzimi ndaj fëmijëve. Janë parashikuar disa aktivitete ndërgjegjësuere që kanë qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e fëmijëve. Fëmijët janë një target grup që shumë lehtë mund të jenë pre e keqtrajtimit dhe dhunës e për këtë është e nevojshme që të informohen në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të tyre.

P10430.Q1.O2.A4. Dita ndërkombëtare e fëmijëve, "1 Qershori"

Një Qershori është dita ndërkombëtare e fëmijëve. Këtë ditë fëmijët e të gjitha moshave kërkojnë që të jenë të lumtur e të festojnë me familjen, me prindërit, me vëmendjen dhe përkujdesjen e nevojshme për realizimin e dëshirave tyre. Kjo ditë përveç se është një ditë festive, është një ditë sensibilizimi për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve. Bashkia e Shkodrës ka organizuar aktivitetin festive dhe ndërgjegjësuere që lidhet me mirëqenien e fëmijëve, njohjen dhe respektimin e të drejtave në familje, shkollë, shoqëri dhe në të gjitha shërbimet që ofrohen për fëmijët. Në këtë aktivitet morën pjesë shkollat e qytetit të cilat përformuan përpara bashkisë performanca që lidhen me rëndësinë e aktivitetit fizik në mirërritjen e fëmijëve, ndikim në shëndetin mendor dhe në zhvillimin e aftësive fizike, shoqërore dhe emocionale.

Me anë të aktiviteteve festive me në qëndër fëmijën transmetojmë mesazhe sensibilizuese për fëmijët që janë e ardhmja e shoqërisë sonë.

P10430.Q1.O2.A5. Dita ndërkombëtare e gruas, 8 marsi.

8 Marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Në këtë ditë reflektohet mbi kurajon dhe veprimet e grave të thjeshta të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në historinë e të drejtave të grave. Në Ditën Botërore të Gruas, në ditët e sotme, ashtu si në të shkuarën, punohet për barazinë gjinore të gruas, pavarësinë e saj, eliminimin e padrejtësive politike, për kushte më të mira pune dhe jetese. Për herë të parë 8 Marsi në Shqipëri u kremtua në vitin 1942 të shekullit të XX-të në grupe të vogla grash. Në kuadër të 8 marsit, Ditës Ndërkombëtare të gruas u realizua një fushatë ndërgjegjësuere e shtrirë përgjatë të gjithë javës. Janë organizuar aktivitete sensibilizuese, informuese, të shpërndara në Qendrat Komunitare

“Për Familjen”, shkollat e Bashkisë Shkodër, Qendrën Rinore Atelie dhe institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër si: Biblioteka “Marin Barleti”, Muzeu “Oso Kuka”, Teatri Migjeni, Galeria e Arteve etj. Aktivitetet janë zhvilluar si në qytet ashtu dhe në njësitë administrative. Synimi i kësaj fushate ishte promovimi i rolit të gruas në shoqëri.

P10430.Q1.O2. A6. Aktivitet ndërgjegjësues në kuadër të ditës ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, më 3 Dhjetor & trashëguar.

3 Dhjetori - Dita Botërore e Personave me Aftësi të kufizuar, synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integritit të personave me aftësi të kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore. Në kuadër të ditës ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuar janë parashikuar disa aktivitete. Qëllimi ynë është mposhtja e të gjitha barrierave, jo vetëm barrierat fizike të betonit, por ato kulturore dhe sociale të cilat pengojnë integritin e personave me aftësi të kufizuara në fusha të ndryshme të jetës. Kjo ditë synon ndërgjegjësimin e institucioneve, shoqërisë civile, donatorëve, por edhe të mbarë komunitetit për t’u bërë pjesë dhe për t’u përfshirë në procesin e integritit të personave me aftësi të kufizuar në jetën politike, sociale, ekonomike e kulturore.

P10430.O6.A2 PEOPLE – Histori personale të diskriminimit dhe persekutimit nën regjimet totalitare të shekullit XX (PEOPLE - Personal stories of discrimination and persecution under the totalitarian regimes of the XX century) & trashëguar

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak VKB Nr. 58, datë 06.12.2021 “Për shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër” dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Shkodër (partner) dhe Shoqatës ATRIUM (partner lider) me Nr. 16891 Prot., datë 05.10.2021, po zbatohet projekti PEOPLE– Histori personale të diskriminimit dhe persekutimit nën regjimet totalitare të shekullit XX, i cili financohet nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programit “Europa për Qytetarët” - EACEA/52/2019: Përkujtimi Europian 2020.

Projekti drejtohet nga Shoqata ATRIUM - Arkitektura e Regjimeve Totalitare të Shekullit XX në Kujtesën Urbane të Europës, në rolin e Liderit të Projektit dhe zbatohet në një partneritet prej 5 palësh të përfshira (Shoqata ATRIUM, Bashkia Shkodër, Bashkia Labin, Bashkia Dimitrovgrad, Shoqata e Refugjatëve Politikë Portugezë).

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përfshirja e të rinjve, në rolin e grupit të punës, në mbledhjen dhe prezantimin e historive të persekutimeve fetare në Shkodër gjatë periudhës së komunizmit në eventin që do të organizohet dhe faqen ëeb që do të krijohet, i cili do të nxisë reflektimin e kësaj historie të përbashkët midis vendeve të ndryshme dhe do të rrisë ndërgjegjësimin mbi kuptimin e diversitetit dhe mbi rëndësinë e të pasurit dije të gjithanshme.

Bashkia Shkodër, si partnere e projektit të sipër përmendur, ka zbatuar projektin sipas planit të punës të dakordësuar me liderin e projektit dhe bazuar në buxhetin përkatës të vënë në dispozicion për këtë qëllim. Buxheti i Projektit për Bashkinë Shkodër do të jetë 12.445 Euro (1.511.944 Lekë) për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të bëhet në tre këste: 30% e buxhetit do të transferohet pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit, kështu i cili ka mbërritur me datë 14.12.2021 me vlerën 438,679.65 Lekë; 30% e buxhetit do të transferohet pas fazës kërkimore/përgatitore, kështu I cili ka mbërritur me datë 05.05.2022 me vlerë 436,025.03 Lekë; dhe 40% e buxhetit do të transferohet pas raportimit final.

Gjatë periudhës së raportimit në fjalë, është transferuar shuma e plotë e parashikuar në marrëveshjen e bashkëpunimit nga e cila janë likuiduar kontratat e mbetura me vlerë 40%.

Projekti ka përfunduar dhe është zbatuar 100% duke arritur objektivat dhe qëllimin e përcaktuar.

P10430.Q1.O2.A7. FARO – Trashëgimi të ndryshme në Qytezat Europiane – Krijimi i një narrative europiane të identiteteve të kontestuara përmes pjesëmarrjes së qytetarëve.

(FARO – The Dissonant Heritage in European Toëns – Creating a European narrative of contested identities through citizens' participation) & trashëguar

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak VKB Nr. nr. 17 datë 31.03.2022 “Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Shkodër” dhe marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Dimitrovgrad (partneri lider) dhe Bashkisë Shkodër, me Nr. 3758 Prot, datë 21.02.2022., po zbatohet projekti FARO – Trashëgimi të ndryshme në Qytezat Europiane – Krijimi i një narrative europiane të identiteteve të kontestuara përmes pjesëmarrjes së qytetarëve, i cili financohet nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programit “Europa për Qytetarët” - EACEA 36/2018: Rrjetëzimi i qytezave.

Projekti drejtohet nga Bashkia Dimitrovgrad, në rolin e Liderit të Projektit dhe zbatohet në një partneritet prej 10 palësh të përfshira (Bashkia Dimitrovgrad, Bashkia Shkodër, Shoqata ATRIUM, Bashkia Nova Gorica, Bashkia Lousada, Bashkia Stei, Bashkia Carbonia, dhe Poëiat Piotrkoëski).

Qëllimi i përgjithshëm i projektit është përfshirja e të rinjve dhe qytetarëve, në rolin e grupit të punës, në organizimin e eventit 2-ditor, i cili do të nxisë reflektimin e kësaj historie të përbashkët midis vendeve të ndryshme.

Buxheti i Projektit për Bashkinë Shkodër do të jetë 14,600 Euro (1,766,000 Lekë) për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit.

Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të bëhet në dy këste: 60% e buxhetit do të transferohet pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit, kështu i cili ka mbërritur me datë 17.03.2022 në vlerën 1,041,564 lekë; 40% e buxhetit do të transferohet pas raportimit final.

Aktivitetet për 4-mujorin në fjalë përfshijnë: dy takimet e fundit koordinuese ndërmjet partnerëve në projekt, ku Bashkia Shkodër ka dërguar nga dy përfaqësues në secilin takim.

Takimet për vitin 2023 janë bërë në Slloveni dhe Rumania. Me takimin e Rumanisë është përmbyllur projekti.

Ka ardhur edhe transhi i fundit 40% mbas mbarimit të projektit.

P10430.Q1.O3.A1. Partneriteti me departamentin e psikologji-punës sociale dhe departamentin e infermierisë.

Në universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në degët e psikologjisë, punës sociale, fizioterapisë dhe infermierisë, çdo vit regjistrohen rreth 50 studentë në secilën degë. Në vitin e tretë të studimeve bachelor, gjatë gjithë vitit akademik, studentët zhvillojnë lëndën e “Praktikumit”. Një lëndë e tillë është me shumë rëndësi për përfitimin e njohurive praktike në fushat përkatëse. Gjithashtu pas përfundimit të studimeve në ciklin bachelor, ka shumë rëndësi praktika e njohurive të marra gjatë viteve të studimit. Bashkia e Shkodrës ka arritur një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ku pjesë e kësaj marrëveshje ka qenë bashkëpunimi për ofrimin e një praktike sa më profesionale dhe të vlefshme për zhvillimin akademik e profesional të studentëve. 25 studentë; 18 të nivelit bachelor dhe 7 të nivelit master kanë zhvilluar praktikën profesionale pranë shërbimeve sociale dhe kanë kontribuar në

aktivitetet e planifikuara pranë qendrave komunitare “Për Familjen”. Një eksperiencë e tillë ka rezultuar shumë pozitive për të dyja palët. Nëpërmjet institucionalizimit të këtij bashkëpunimi, studentët ofrojnë njohuritë e tyre në shërbim dhe në përputhje me nevojat e komunitetit, duke filluar kështu të fitojnë aftësitë bazë të profesionit të tyre.

P10430.Q1.O3.A2. Tryeza konsultative me organizatat që veprojnë në sektorin social në Bashkinë e Shkodrës;

Në qytetin e Shkodrës, ndodhen e funksionojnë një sërë organizatash të shoqërisë civile që ofrojnë shërbim në mbështetje të grupeve sociale në nevojë; fëmijëve, të rinjve, grave e burrave, personave me aftësi ndryshe, komunitetit rom dhe egjiptian, moshës së tretë, etj. Viti 2016 ishte një vit i rëndësishëm i fillimit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionalizimit të partneritetit me to. Gjatë këtyre viteve është konsoliduar aktiviteti i tryezave konsultative dhe zhvillimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile. Me synim koordinimin e aktiviteteve dhe shërbimeve në territorin e Bashkisë së Shkodrës, janë planifikuar dhe organizuar tryeza konsultative me shoqërinë civile. Gjatë kësaj periudhe tryezat konsultative janë organizuar për planifikimin e aktiviteteve në kuadër të zbatimit të kartës evropiane për barazinë gjinore, 8 marsit, 8-12 prillit, planit social dhe në zbatim të projekteve të reja që po zbatohen në Bashkinë e Shkodrës nga organizatat partnere. Tashmë ka një proces të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të konsultimit përmes takimeve ku qëllimi i këtyre tryezave ka qenë ndërhyrja e integruar në ofrimin e shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe mbulimi i territorit me shërbime.

P10430.Q2.O1.A1. Shërbime mbështetëse dhe riaftësuese për integrimin e fëmijëve me aftësi ndryshe në sistemin edukativ

Autizmi është një sëmundje e cila karakterizohet nga çrregullime të marrëdhënieve sociale, të komunikimit dhe sjellje e lëvizje stereotipike. Autizmi po përhapet në mënyrë të shpejtë duke u shndërruar në një sfidë për shëndetin publik në mbarë botën për shkak të kostove shoqërore dhe ekonomike. Njohuritë për autizmin në shërbimin shëndetësor e më tepër në popullatën shqiptare janë shumë të pakta dhe nuk është e qartë se rritja e rasteve është rezultat i shtimit real të rasteve apo diagnostikimit më të mirë. Në Shqipëri shifrat janë në rritje, por nuk ka të dhëna të sakta. Specialistët e shëndetësisë bëjnë thirrje për sensibilizimin e opinionit publik për diagnostikimin e hershëm, përkrahjen ndaj fëmijëve autikë dhe integrimin e tyre në shoqëri. Në Shkodër nuk ka pasur një shërbim të specializuar për trajtimin e fëmijëve me autizëm që të mundësojë mbështetjen dhe ofrimin e shërbimeve integruese në moshë sa më të hershme në shërbimet edukuese parashkollore dhe shkollore. Kanë përfunduar punimet për përshtatjen e ambjenteve fizike për ofrimin e shërbimeve, është siguruar mobilimi i ambjenteve, përzgjedhja e stafit dhe trajnimi i tij nga Fondacioni “Fëmijët Shqiptarë”, si enti më me eksperiencë në ofrimin e një ekspertizë të tillë. Qendra Harmonia tashmë ka filluar punën dhe ofron shërbime për spektrin e autizmit. Përgjatë kësaj periudhe kanë marrë shërbim rreth 16 fëmijë të diagnostikuar me spektrin e autizmit.

P10430.Q2.O1.A2. Ngritja, vendosja në funksion dhe konsolidimi i Qendrave Komunitare “Për Familjen”.

Në vitin 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet. Për herë të parë u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. Në vazhdim të krijimit dhe zgjerimit të rrjetit për ofrimin e shërbimit social në territor, janë ngritur dhe vënë në funksion në total 13 qendra komunitare “Për Familjen”, të shtrira në territorin e Bashkisë së Shkodrës. Gjatë kësaj periudhe, sa i përket konsolidimit të shërbimit komunitar në qendrat komunitare “Për Familjen”, janë rritur shërbimet e ofruara, aktivitetet dhe përfituesit, pranë këtyre qendrave. Duke u mbështetur në shërbimet e ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

P10430.Q2.O1. A3. Kujdesi social ndaj moshës së tretë.

Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve është një ditë e veçantë për personat e moshës së tretë në të gjithë botën. Pleqëria është një prej rregullave të pandryshueshme të krijimit dhe një nga periudhat e rëndësishme të ciklit të jetës. Diskutimet janë përqëndruar në tema të tilla si: plakja e popullsisë dhe ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat e kësaj moshe, puna vullnetare, kujdesi social dhe gjetja e mënyrave sa më përfshirëse për personat e moshuar, në fuqinë punëtore. Një problem shqetësues në vendin tonë është ndryshimi i dinamikave brenda familjes shqiptare, ku si pasojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve social-ekonomike, kulturore, etj, fëmijët kanë prirje për të jetuar vetëm, për të emigruar dhe për t’u shkëputur nga familja. Një ndryshim i tillë në konceptin dhe traditën e familjes shqiptare, ka bërë që të kemi një rritje të të moshuarve që jetojnë vetëm, pa përkujdesjen dhe vëmendjen e nevojshme. Nuk ka të dhëna mbi numrin e saktë të moshuarve që jetojnë në territorin e bashkisë së Shkodrës. Një pjesë e madhe e kësaj kategorie jetojnë në shtëpi, vetëm, shpesh pa përkujdesje të veçantë dhe në varfëri e në kushte shumë të papërshtatshme. Pranë qendrës komunitare “Për Familjen” Nr.4, Bashkia e Shkodrës ofron shërbime ditore, të cilat konsistojnë në: informim, këshillim për problemet shëndetësore kryesore që prekin moshën e tretë, mundësi për kohën e lirë, ofrim çaji, kafeje, shtyp i ditës, pjesëmarrje në aktivitete social-kulturore, etj. Të moshuarit marrin rregullisht këshilla mjekësore dhe bëjnë vizita periodike për matjen e presionit të gjakut dhe të glicemisë në gjak. Festojnë rregullisht ditëlindjen duke organizuar festa ose dreka në ambjentet e qendrës dhe jashtë saj.

P10430.Q2.O1.A4. Shërbime alternative për fëmijët dhe familjen.

Sigurimi i mbrojtjes shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe i të drejtave të tyre është një ndër sfidat më të rëndësishme për Bashkinë e Shkodrës, por edhe për shoqërinë civile, duke kërkuar një vëmendje më të veçantë për këtë target grup. Gjatë kësaj periudhe janë identifikuar familje me fëmijë në rrezik institucionalizimi dhe po punohet për fuqizimin e tyre dhe paralelisht po punohet me fuqizimin e familjeve që kanë fëmijë në institucione rezidenciale, me synim deinstitutionalizimin e tyre. Janë realizuar fushata ndërgjegjësuese me aktorë të ndryshëm publik dhe jo publik, por edhe me komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin dhe informacionin mbi shërbimin e kujdestarisë ligjore si mundësia më e mirë për fëmijët pa kujdes prindëror. Fokusi i këtij shërbimi është zgjerimi i formave alternative me bazë familjen për fëmijët, drejt deinstitutionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes. Në kuadër të 15 majit

“Ditës ndërkombëtare të Familjes” Bashkia Shkodër ka realizuar një sërë aktivitetesh për rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për shërbimin e kujdestarisë aktivitetet janë shtrirë edhe në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit me qëllim rritjen e sensibilizimit dhe informacionit në lidhje me funksionimin e familjes kujdestare me qëllim lehtësimin e procesit të kalimit të fëmijëve nga kujdesi rezidencial në atë alternativ, me bazë familjen.

Fokusi i këtij shërbimi është zgjerimi i formave alternative me bazë familjen për fëmijët, drejt deinsitucionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes. Informimi mbi këtë shërbim dhe advokimi i familjeve kujdestare të interesuara, vazhdon të jetë sfidë e cila do të ketë vëmendjen e veçantë të Bashkisë Shkodër, në mënyrë që paralelisht ky shërbim të sigurojë mbrojtjen shoqërore për fëmijët pa kujdes prindëror dhe respektimin e të drejtave të tyre.

P10430.Q2.O1.A5. Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror

Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën Nr. 4307 Prot., datë 10.12.2021 për Fondin Social për Shërbime me Bazë Komunitare 2022 me projekt – propozimin “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së financimit të Strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror, strukturë e ngritur nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me ACLI-IPSIA.

E përzgjedhur si bashki fituese dhe e vlefshme për financim përmes shkresës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) Nr. 1134/19 Prot., datë 04.05.2022 “Njoftim për përzgjedhjen fitues të projekt propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror””, Strehëza filloi funksionimin e saj të plotë më 01.06.2022.

Me anë të këtij shërbimi të ri dhe alternativ synojmë të ofrojmë një mundësi për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët nuk mund të rriten në një mjedis familjar, duke synuar gjithashtu përfshirjen brenda procesit të deinsitucionalizimit dhe të decentralizimit të nisur në Shqipëri, kryesisht referuar Planit Kombëtar të De-Institucionalizimit 2020-2022 të miratuar së fundmi me VKM Nr. 706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinsitucionalizimit të Fëmijëve 2020-2022” dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij. Struktura përmbush standartet për shërbimet e përkujdesit shoqëror të përcaktuar në VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

Strehëza përdor një model marrëdhëniesh, që paraqitet si alternativë e përkohshme ndaj modeleve institucionale të qendrave rezidenciale dhe në përgjithësi, ndaj institucioneve të mëdha, modele që fatkeqësisht vazhdojnë të funksionojnë në vendin tonë. Organizimi i strukturës, duke filluar prej hapësirave fizike deri te veprimtaritë ditore, janë pjesë përbërëse e ndërhyrjes edukative dhe synojnë riparimin e dështimeve të mëparshme ambientale. Gjithashtu, ky shërbim synon të ofrojë edhe strehim emergjent të sigurtë dhe rehabilitues për fëmijët në situata emergjente apo në rrezik të lartë deri në rehabilitimin e plotë të fëmijëve dhe të familjes biologjike me qëllim që të minimizohet koha e qëndrimit të të miturit në Strehëz.

Në strehëz është planifikuar që të ofrohet shërbim deri në kapacitet maksimal për 8 fëmijë të moshës 6 deri në 18 vjeç. Aktualisht pranë kësaj strukture janë sistemuar 5 fëmijë, me vendim të Komisionit Multidisiplinar të Bashkisë të datës 30.03.2022. Shërbimi ofrohet nga 8 (tetë punonjës) i përbërë nga 6

specialistë (në rolin e edukatorëve të cilët punojnë me tre turne) sipas standartit 1 edukator për 4 fëmijë, 1 kuzhinier/sanitar dhe 1 koordinator i Strehëzës, personel pjesë e strukturës së Bashkisë Shkodër.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka transferuar fondin për projektin fitues të Bashkisë Shkodër më datë 11.05.2022, përmes shkresës me Nr. 2084 Prot., “Transferim fondesh për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki për vitin 2022” dhe shkresës Nr. 69/43 Prot., datë 16.05.2022 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Akordim i fondeve për financimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki për vitin 2022”. Deri në datë 31.05.2022 financimi dhe vënia në funksion e strehëzës është siguruar nga financimi i projektit “Komunitetit të së ardhmes: ndërhyrje të përfshirjes sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodrës”.

Sipas aplikimit kohëzgjatja e projektit është 36 muaj (Janar 2022 – Dhjetor 2024), dhe transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër është planifikuar të bëhet në tre këste:

Financimi i vitit të parë në masën 90% të totalit të kostove të ofrimit të shërbimit, ku në fakt ky financim është disbursuar në maj të vitit 2022 në shumën 7,841,995 lekë që përkon në mënyrë përpjësimore me 7 muaj shërbim.

Viti i dytë i zbatimit të projektit do financohet në masën 60% të vlerës së projektit.

Viti i tretë i zbatimit të projektit do financohet në masën 30% deri sa shërbimi do të mbulohet 100% nga Bashkia Shkodër.

Për shkak të tipologjisë së shërbimit të strehëzës dhe mirëfunksionimit të saj deri më tani është e domosdoshme që në rastin e vitit të dytë të ofrimit të shërbimit, financimi në masën 60% të vlerës së projektit të transferohet në buxhetin e Bashkisë Shkodër që në fillim të muajit janar 2023 për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimit rezidencial dhe mbulimin e të gjitha kostove operative jetësore të parashikuara me këtë fond sipas linjave të buxhetit më poshtë.

Ndaj Bashkia Shkodër i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale me shkresën Nr.18419 Prot, datë 09.12.2022 me lëndë “Vënie në dijeni dhe kërkesë për kalim fondi”.

Streheza për fëmijët pa kujdes prindëror vepron si një komunitet me dimension familjar, me karakter edukativ me qëllim edukimin fëmijëve pa familje ose me familje në vështirësi, me asistencë përkujdesjeje ditë e natë, organizimi dhe ndihma e kohës së lirë, mbështetje arsimore, formimin kulturor, shoqërimin dhe integrimin e fëmijëve nëpërmjet kurseve të ndryshme.

Struktura synon të mbështesë procesin e zhvillimit të fëmijëve, nëpërmjet një organizimi të jetës që lejon marrëdhënie të qëndrueshme dhe emocionalisht të rëndësishme, dhe t'i shoqërojë dhe mbështesë drejt një procesi gradual të autonomisë.

Strehëza ndodhet në lagjen 3 Heronjtë, dhe ka kapacitet të strehojë deri në tetë fëmijë, me dy vende shtesë të rezervuara për rastet emergjente. Aktualisht në Strehëzën për fëmijët pa kujdes prindëror që nga fillimi i muajit shkurt 2023 jetojnë 6 fëmijë. Pesë nga të cilët janë djem dhe e një vajze (nga mosha 9-15 vjeç).

Pesë fëmijë frekuentojnë shkollën 9-vjeçare “Mati Logoreci, ndërsa njëri nga fëmijët frekuenton shkollën 9 vjeçare “Dëshmorët e Prishtinës”.

Organizimi: Organizimi i jetës së përditshme është i strukturuar në mënyrë që:

Të favorizojë realizimin e një përvoja individuale vendimtare për fëmijët për zhvillimin dhe maturimin e tyre personal nëpërmjet një organizimi që lejon marrëdhënie të qëndrueshme mes njeri-tjetrit dhe

edukatorëve. Çdo ditë në shtëpinë familje është intensive: me disa angazhime, momente loje, përgatitja e vakteve, pastrimi, këshillimi dhe bashkëndarje që e bëjnë çdo ditë unike. Jeta e përditshme nuk është vetëm tërësia e veprimeve të kryera nga pjestarët që jetojnë në shtëpinë familje, por gjithashtu ne i kushtojmë rëndësi të madhe arsimit dhe edukimit. Brenda një ditë plotësohen së pari nevojat parësore, si të lahet, ushqehet dhe pushohet, nevoja që shumica prej nesh i marrin si të mirëqena, por të cilat nuk janë gjithmonë automatike. Prandaj dita është e strukturuar në mënyrë treguese si ajo e një fëmijë që jeton në një familje "normale", ku ritmet janë lineare dhe shprehite e fituara të sjelljes së përditshme kanë një rol qetësues, dhe një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien e secilit. Qëllimi i këtij organizimi është që në një të ardhme fëmijët të kenë arritur autonominë dhe vendosjen e marrëdhënieve më të shëndetshme me familjet biologjike.

Të inkurajojë pjesëmarrjen e të gjithëve, secili në raport me rolin që luan, me organizimin dhe rregulloren e brendshme për menaxhimin e jetës së shtëpisë, duke shfrytëzuar në maksimum momentet e takimit me njëri tjetrin për një dialog autentik edukativ.

Të favorizojnë arritjen e përvojave të rëndësishme që mbështesin zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe ta shoqërojnë atë drejt një përvetësimi gradual të mjeteve dhe burimet që synojnë promovimin e autonomisë së tij në një të ardhme.

Dosja personale: për çdo fëmijë është mbajtur dhe përditësohet dosja personale, e cila përbëhet nga sa vijon, seksionet:

Administrative - për dokumentacionin e regjistrimit, vendimet e Komisionit Multidisipinar si dhe vendimet e gjykatës.

Sociale dhe psikologjike - për raportet e ndryshme psiko-sociale, si: formular i informacionit të domosdoshëm, raport për vlerësimin e nevojave dhe ecurisë (RVNE), plani i kujdesit, raporte psikologjike.

Në muajin prill janë mundësuar seanca këshillimi/terapie për njërin nga fëmijët, të rekomanduara nga Neuropediatria. Seancat zhvillohen 2 herë në javë online.

Arsimore - për dokumentimin e punës edukative; Plani i arsimit që është bërë në bashkëpunim me shkollën, Rishikimi i planit të Arsimit, Raport mujor i arsimit nga edukatorët, dëftesat etj., relacionet nga takimet e shkollës me mësuesit përkatës.

d) Shëndetësore – Kartela shëndetësore për çdo njërin nga fëmijët për dokumentimin e kontrolleve shëndetësore, vizitat rutinë, vaksinimet, fletoret shëndetësore për raportimin nga edukatorët të medikamenteve të administruara në rastet e rekomanduara nga mjekja.

Gjatë këtij 8 mujori i gjithë personeli është angazhuar për ri-shikimet e planeve të kujdesit, planet e punës dhe të arsimit për çdonjërin nga fëmijët.

Në muajin Prill një pjesë e personelit kanë qenë pjesë e ëorkshopit 2 ditor, për rritjen e njohurive të aktorëve lokal në lidhje me shërbimin e kujdestarisë në Bashkinë Shkodër, ëorkshop i realizuar nga SOS-Fshatrat e Fëmijëve në Shqipëri. Po ashtu disa nga personeli i Shtëpi familje ka marrë pjesë në konferencën: Së bashku për një botë të ndryshme. Sfidat të ndërhyrjes në autizëm. Në fund të muajit mars në Shtëpinë familje kemi patur kontroll nga Drejtoria e Inspektimit të Standarteve të Shërbimeve Shoqërore. Në muajin mars është marrë kujdestaria ligjore për njërin nga fëmijët.

Në muajin Gusht personeli i Strehëz kanë marrë pjesë në trajnimin 1 ditor me teme: Procedurat Standarte të vëprimit për mbrojtjen e viktimave potenciale të trafikimit.

Shëndeti: Fëmijet përveç simptoma të virozave sezonale. Njëri nga fëmijët R.B, i cili është 9 vjeç ka pas problematika shëndetësore; ku është hospitalizuar nga dt 14.08.2023- 17.08.2023, dhe me pas i është nënshtruar mjekimit të rekomanduar nga mjekja në shtëpi. Disa prej tyre gjatë këtyre muajve u janë bërë vizita tek mjeku i familjes, nga kardiologjia si dhe doktoresha italiane Dr.P.Pressuti. Dy prej tyre kanë

bërë vizitë mjekësore tek neuropediatria. Dhe njërit nga fëmijët i është mundësuar një vizitë tek kardiologia dhe një elektrokardiogramë ku rezultoi shumë mirë. Po ashtu njërit nga fëmijët i është bërë dhe një vizite nga neuropsikiatria për fëmijë, vlerësim që i nevojitet për tek shkolla pasi fëmija ka nevojë për mësuese mbështetëse. Krahas vizitave janë marrë recetat dhe ilaçet e rekomanduara.

Aktivitetet e ndryshme: Momentet rikrijuese të përfaqësuara nga udhëtimet dhe shëtitjet konsiderohen jashtëzakonisht të rëndësishme dhe pasuruese si nga pikëpamja e marrëdhënies ndërmjet fëmijëve me njëri tjetrin po ashtu edhe nga pikëpamja e marrëdhënies edukator- fëmijë. Gjatë këtyre muajve, janë organizuar dalje të ndryshme ku fëmijet janë argëtuar, kanë mësuar gjëra të reja dhe janë përfshirë në një realitet ndryshe nga ai i shtëpisë familje. Fëmijët janë regjistruar në aktivitetet të ndryshme për të promovuar argëtimin dhe socializimin.

Disa nga aktivitetet jashtë shtëpisë:

Fëmijet përveç aktiviteteve shkollore masdite janë të përfshirë në disa kurse:

- Dy prej tyre 2 here në javë frekuentojnë mbasdite kursin e pikturës. (Gjatë muajve Korrik-Gusht nuk i kanë frekuentuar pasi kanë qenë pushim)
- Njëri nga djemtë tre herë në javë shkon në stërvitje futbollit me skuadrën e Don Boskos.
- Ndërsa vajza është pjesë e skuadrës së volejbollit dhe tre herë në javë zhvillon stërvitje.
- Të gjithë fëmijët së bashku me edukatorët e turnit ditën e mërkurë dhe të premte kalojnë çaste argëtimi tek oratori Don Bosko.

Në muajin Qershor – Korrik fëmijet kanë marrë pjesë të gjithë fëmijët në kampet verore të organizuara nga qendra Don Bosko. Per ditën e femijeve me dt 1 Qershor kemi bere nje shetitje te gjithë se bashku tek lojrat ne Shkodra park

Po ashtu nga datat 20- 29 Gusht femijet kane qene ne plazh ne Velipoje ku jane akomoduar te Shtepia e Sherbimit Social Shteteror, ku kane kaluar dite plot argetim

Disa nga aktivitetet të tjera të organizuara gjatë këtij 8 mujori janë :

- Pjesëmarrja në aktivitetin e Shoqatës “Shpresë për Botën”.
- Një ditë në pishina në muajin korrik të ofruara nga “Shpresë për Botën”.
- Shirokë, aktivitet dhe vizita në azilin e të moshuarve, të motrave Stigmatine, momente bashkëndarje dhe argëtimi së bashku me të moshuarit e qendrës.
- 2 fëmijët më të rritur 1 herë në javë nga 1 orë ofrojnë shërbim vullnetar në Azilin e motrave Stigmatine në Shirokë.
- 2 herë në muaj në parkun e lojrave për fëmijë tek Blu Sky.
- 2 herë në muaj shëtitje tek Shkodra Park.
- Aktivitet 2 herë në muaj nga grupi “LER”, grupi i nxënësve të shkollës “Atë Pjetër Meshkalla”, të cilët vizitojnë shtëpinë familje dite të premtesh.(gjate muajit Qershor, Korrik Gusht) nuk është zhvilluar ky aktivitet për të rifilluar në muajin tetor.
- Çdo të martë një grup nga shoqata Shpresë për botën zhvillon aktivitetet me fëmijët në shtëpinë familje.
- Kamp 3 ditor në Razëm, vajza 14 vjece, me Oratorin Don Bosko.
- Animacion në mjediset e shtëpisë familje, nga grupi i animatorëve të Qendrës Don Bosko.
- Vizita nga familjarët e tyre.

Deri më tani janë kryer procedurat e prokurimeve për zërat:

- Ushqime,
- Materiale pastrimi,

- Dizinfektim,
- Mjete kancelarike,
- Veshmbathje,
- Vaj dhe Karburant.

P10430.Q2.O1.A6. Shpërblim për jetimët me rastin e festave të fundvitit.

Në territorin e Bashkisë së Shkodrës ofrojnë shërbim rezidencial për fëmijë pa përkujdes prindëror 3 institucione të ndryshme të ndara sipas grupmohave. Këto institucione ofrojnë shërbime për të rinjtë deri në moshën 18 vjeçare. Bashkia e Shkodrës në vitin 2017 ka aplikuar, fituar dhe zbatuar projektin për ristrukturimin e godinës së ish konviktit të shkollës pyjore, pranë MZHU, me qëllim strehimin dhe ofrimin e kushteve sa më të mira banimi për jetimët e dalë nga strukturat rezidenciale dhe që jetojnë në konviktet e shkollave të mesme të qytetit. Aktualisht janë të gatshme dhe janë vënë në funksion 24 apartamente sociale për strehimin e jetimëve dhe grave kryefamiljare. Gjithashtu, në ndihmë të kësaj shtrese është shpërndarë ashtu si vitet parardhëse shpërblimi i jetimëve të dalë nga strukturat rezidenciale dhe jo vetëm, banorë të Bashkisë Shkodër, me rastin e festave të fundvitit. Qëllimi i kësaj ndihme është lehtësimi i situatës së tyre ekonomike dhe krijimi i një atmosfere sa më të mirë festive.

P10430.Q2.O1.A7 Fuqizimi socio – ekonomik i komunitetit rom dhe egjiptian.

Ka vazhduar edhe gjatë vitit 2023 ofrimi i shërbimeve sociale, integruese dhe mbështetëse pranë Qendrës Komunitare Multifunksionale “Për Familjen” për komunitetin rom dhe egjiptian.

Qendra Komunitare Multifunksionale “Për Familjen” për komunitetin rom dhe egjiptian është vënë në funksion të plotë që nga muaji tetor i vitit 2018 dhe ofron shërbime specifike për këtë komunitet siç janë :

- Regjistrimi civil dhe mbështetje në nevojat administrative,
- Arsimimi dhe promovimi i dialogut,
- Kujdesi shëndetësor,
- Strehimi dhe integrimi,
- Punësimi,
- Mbrojtja sociale.

Qendra Multifunksionale bashkëpunon që prej vitit 2018 me Fondacionin “Shpresë për Botën” dhe Foodbank për ofrimin e shërbimeve integruese për këtë komunitet. Numri total i përfituesve të shërbimeve në këtë qendër është 200 përfitues, nga të cilat 170 i përkasin komunitetit rom dhe 30 komunitetit egjiptjan.

Fëmijët që përfitojnë shërbime integruese gjatë frekuentimit ditor të qendrës Multifunksionale janë 50 fëmijë, të cilët mbështeten çdo ditë me :

- Lehtësues në komunitet,
- Transport në shkollë/kopësht,
- Vakt ushqimor në qendër,
- Klasa passhkollore dhe përgaditore
- Canta mjete didaktike dhe rroba për përdorim të përditshëm,
- Aktivitete dhe lojra psiko- sociale

- Ogranizimi dhe festimi i ditëlindjes për cdo fëmijë.
- Janë dhuruar afërsisht 15 karroca për bebe bashkë me mbulesa për bebe.

Në dispozicion të fëmijëve të komunitetit rom gjatë 8 – mujorit të 2023 janë vënë dy mjete transporti të cilët kanë shoqëruar fëmijët nga vendqëndrimet rome me intinerar:

- Mjeti 1 – K/Prokurori – shkolla 9 vjecare “Salo Halili” / Kopshti “Ngjyrat” - Qkmf- dhe kthimi në vendbanim e tyre.
- Mjeti 2 – K/Dubai, Bahcallek – shkolla 9 vjecare “Isuf Tabaku”Ajasëm / Kopshti “Mjelmat” – Qkmf dhe kthimi në vendbanimin e tyre.

(Kostot e transportit mbulohen nga Fondacioni “Shpresë për Botën”

Higjena është elementi i rëndësishëm që lehtëson integrimin e fëmijëve rom, duke marrë në konsideratë faktin se shpesh është shkak për qëndrime diskriminuese.

Për këtë pranë qendrës komunitare multifunkionale janë në funksion dushe, makina larëse për fëmijët që frekuentojnë këtë qëndër.

Për vitin shkollor 2022 – 2023 janë rregjistruar gjithsej 141 fëmijë R/E në shkollë dhe 41 fëmijë në kopshte. Të gjithë fëmijët e rregjistruar në shkollë janë mbështetur në fillim të vitit shkollor me çanta dhe materiale shkollore, nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me organizatat partnere.

Ka vazhduar rregullisht edhe gjatë periudhës janar – gusht 2023 koordinimi ndërinstitucional për identifikimin e fëmijëve që rezikojnë të braktisin shkollën ose e kanë braktisur atë duke përfshirë takime në insitucione dhe vizita në terren të grupit të edukimit që përfshijnë drejtorë të institucioneve arsimore, përfaqësues të ZVA-së, mësues kujdestar, psikolog, punonjës social, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, staf Qendra Multifunkionale.

Skuadrat e terrenit kanë vazhduar intensivisht punën për identifikimin dhe referimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge të cilët shfrytëzohen për lypje.

Në Qendrën Multifunkionale çdo vit festohet 8 Prilli, Dita Ndërkombëtare e Romëve. Në kuadër të feste, Bashkia në bashkëpunim me aktorët e tjerë vendor organizon aktivitete të ndryshme përgjatë një jave.

“Mos Dhuro Para, Dhuro Kujdes!” është slogani i serisë së aktiviteteve që organizohen çdo vit nga Bashkia dhe Qendra Multifunkionale në kuadër të javës rome.

Temat dhe mesazhet që përcojnë janë të ndryshme, por të gjitha synojnë promovimin e diversitetit dhe dialogut ndërkulturor.

Aktivitetet që organizohen çdo vit:

- 1- 8 Marsi – Festa e gruas
- 2- 8 Prillin “Ditën Ndërkombëtare të Romëve”
- 3- 12 Prilli “Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve në Situatë Rruge”
- 4- 1 qershorin “Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve”,
- 5- Java e Familjes.
- 6- Festat e fundvitit, etj.

Fushatat dhe aktivitetet ndërgjegjësuere organizohen nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publike në bashkëpunim me partnerët jo vetëm në ditët e shënuara ndërkombëtare apo kombëtare, por janë pjesë e vazhdueshme e planeve të punës të Drejtorisë dhe Qendrave Komunitare “Për familjen”, me synim rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit në lidhje me të drejtat e tyre, por edhe me qëllim njohjen dhe promovimin e shërbimeve që ofrohen për mbështetjen e grupeve vulnerabël.

Në këtë qendër zhvillohen takime ku diskutohen dhe trajtohen tema në përshtatje me problematikat e hasura më shpesh nga ky komunitet si : braktisja e shkollës, martesat e hershme, trafikimi, prindërimi pozitiv.

Gjatë periudhës 8 mujore (janar – gusht) të 2023 familjet e komunitetit rom/egjiptjan kanë vizituar ambjente dhe kënde lojrash si: Art Center Blue Sky, Bar Blini, Rec- Malësi e Madhe. Janë zhvilluar edhe aktivitete edhe në shkolla ku frekuentojnë fëmijët rom.

Nr. i përfituesve të klasave të prindërimit është 40 prindër të komunitetit rom dhe egjiptjan.

Gjithashtu fëmijë janë pjesë e aktiviteteve sociale dhe argëtuese, lojra psiko sociale që zhvillohen në qendër dhe jashtë saj, por jo vetëm pasi Bashkia Shkodër në bashkëpunim edhe me organizatat partnere organizon çdo vit aktivitetin kampin veror, i cili ka synim dhe qëllim gjithëpërfshirjen sociale dhe integrimin e tyre.

Gjatë muajt korrik 2023 rreth 70 fëmijë rom janë bërë pjesë e kampit veror i cili këtë vit u zhvillua në kompleksin sportiv Bahcallek Arena.

Çdo muaj në Qendrën Multifunkionale organizohet së paku 1 (një) aktivitet me fëmijët dhe prindërit që frekuentojnë qendrën.

Familjet rome/egjiptjane, fëmijët e të cilave frekuentojnë rregullisht shkollën/kopshtin mbështeten çdo muaj me pako ushqimore. Mesatarisht përfitojnë pako

ushqimore 10 - 15 familje rome në muaj.

Gjatë periudhës janar- gusht 2023 janë mundësuar 120 pako ushqimore për familjet përfituese të Q.Multifunkionale:

- 100 pako ushqimore nga Fondacioni “Shpresë për Botën” dhe FoodBank;
- 10 pako ushqimore nga Kisha Ungjillore “Shpresë për Shkodrën”;
- 10 nga YEA.

Janë menaxhuar dhe ndjekur 6 raste (të mitur me UM jane trajtuar deri më 14 shkurt 2023) dhe 3 raste (gra) me urdhër mbrotje janë monitoruar dhe menaxhuar nga Qendra Multifunkionale duke iu ofruar mbështetjen e nevojshme.

Të gjithë rastet e kanë përfituar pagesën e UM. Janë referuar për shërbime specifike pranë organizatave tjera 2 raste (nëna kryefamiljare).

Gjatë muajt korrik – gusht 2023 është bërë i mundur regjistrimi i fëmijëve rom në shkollat më afër vendbanimit tyre dhe listat janë referuar në ZVA me rekomandimet përkatëse. Në

total janë 109 fëmijë në shkollë, nga të cilët 9 janë rregjistrim në klasën e parë ndërsa pjesa tjetër janë vazhdimësi nga vitet e kaluara.

P10430.Q2.O2.A1. Qendra Rinore "Atelie".

Në 8-mujorshin e parë të vitit 2023 në Qendrën Rinore “Atelie”, u realizuan iniciativat rinore të përmuajshme “Kinerinore”, aktiviteti “Ne dhe gjysherit”, vizitat studimore në “Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës”, në stadiumin Loro Boriçi, në muzeun Oso Kuka, Art House.

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Arsimit u zhvillua sesioni informues me pedagogë nga fakultete të ndryshme të universitetit “Luigj Gurakuqi” mbi mundësitë që këto fakultete ofrojnë.

U zhvillua sesioni informues “Kanceri i qafës së mitrës”. Në Qendrën Rinore “Atelie” u zhvillua takimi informues për RinTalk si dhe u diskutua cili është ndikimi i medias te të rinjtë dhe si media i perfshin ata. U zhvillua trajnimi “Emocionet përmes Artit”, nisma rinore që bëri bashkë të rinj e të reja në Qendrën Rinore “Atelie”. Nëpërmjet kësaj nisme të mbështetur nga projekti RAYS, të rinjtë u prezantuan me terapinë e artit si metodë pune në eksplorimin & komunikimin e emocioneve. U zhvillua trajnimi “Edukimi ligjor dhe demokracia përfaqësuese/ direkte si mjet për aktivizimin e shoqërisë në vendimmarrjen publike”. U realizua aktiviteti për orientim karriere organizuar nga Caritas Dioqezian. Të rinjtë e Qendrës Rinore “Atelie” patën mundësi të studiojnë më shumë mbi artistët e huaj dhe shqiptar fotograf, si dhe të mësojnë konceptet e artit të fotografisë. Ky trajnim u mbështet nga @Rays në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Në kuadër të konkurseve për sipërmarrjen u zhvilluan trajnimet brainstorming & #idea, si pjesë e një serie ëorkshop-esh të cilat do të përgatisin dhe përmirësojnë projekt idetë dhe planet e nxënësve pjesëmarrës në YEA! Aëards 2023, që organizon YoungEntrepreneursAlbania-YEA!

Në Qendrën Rinore "Atelie" është hapur ekspozita me punime piktore të krijuara nga nxënësit e shkollave të Shkodrës dhe njërive të ndryshme administrative. U zhvillua një cikël trajnimesh për vajza, gra dhe nëna të reja me temë "Të vërtetat e thjeshta". Ky cikël me gjashtë takime, do të synojë të ftojë auditorin në një mënyrë të re të komunikimit me fëmijët, të qasjes me mëmësinë dhe dilemat e edukimit të tyre. Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas, 8 Marsit u organizua kampionati tre ditor “Lojë pa gjini”. Të rinjtë nëpërmjet lojrave sportive kanë për qëllim të ndergjëgjësojnë dhe të nxisin komunitetin ku jetojmë në lidhje me kauzën e barazisë gjinore, ku djem dhe vajza luajten sëbashku dhe fuqizuan marrëdhëniet duke promovuar vlerat e solidaritetit, paqes dhe barazisë, më fokus të veçantë vleren e gruas në komunitet.

Qendra Rinore “Atelie” mirëpriti parlamentin evropian rinor në kuadër të Konferencës së 15-të Kombëtare të Përzgjedhjes së “EYP Shqipëri”, titulluar "Premtimet dhe mundësitë". “Të shikojmë drejt së ardhmes duke njohur të tashmen tonë” ishte tema e përzgjedhur për të reflektuar mbi situatat më problematike që drejtohet nga natyra jonë njerëzore. U zhvillua sesioni informues me temë “Sistemi zgjedhor në Shqipëri”, që ka si qëllim të ndergjëgjësojë të rinjtë për sistemin zgjedhor në Shqipëri, konkretisht për dy aspekte të sistemit, ndarja e votës në 12 zona zgjedhore dhe listat e mbyllura. Sesioni informues organizohet nga Kongresi Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Qendrën Rinore “Atelie”, Bashkia shkodër. Në Qendrën Rinore “Atelie” po zbatohet cikli i trajnimeve për “Zhvillim Personal”, ku synohet zhvillimi i aftësive jetësore dhe profesionale dhe orientimi i të rinjve drejt zgjedhjes së karrierës dhe mendësisë sipërmarrëse. Ky cikël trajnimesh organizohet nga Save the Children Albania në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër dhe Qendrën Rinore Atelie, si pjesë e projektit “Rrugëtimi i adoleshentëve dhe të rinjve drejt mirëqenies, fuqizimit dhe qëndrueshmërisë” i cili financohet nga Bulgari dhe zbatohet nga Save the Children in Albania në partneritet me Fondacionin Ndhimë Për Fëmijët - Help for Children Foundation. U zhvillua aktiviteti në kuadër të projektit “Ndhimë juridike falas si një domosdoshmëri për riintegrimin e të kthyerve”, ku të rinjtë u mësuan për ofrimin dhe garantimin e aksesit në drejtësi për të kthyerit shqiptarë si dhe për emigrantët potencialë apo ata që kanë tendencë për të emigruar në mënyrë të parregullt. Ky aktivitet u realizua nga Qendra Europiane me mbështetjen e qeverisë Gjermane përmes GIZ Albania, Programi Migracioni për Zhvillim dhe me mbështetjen e Qendrës Rinore “Atelie”, Bashkia Shkodër. U shfaq filmi “The grave of the Fireflies”, kutërinjtë “Transformues” u argëtuan dhe kaluan kohë së bashku. Aktiviteti “Njëkohë me ty” u realizua në kuadër të projektit “Transformers” i cili organizohet nga @ëorldvisionalbania dhe @kongresi_rinor_kombetar

me mbështetjen e Qendrës Rinore “Atelie”, Bashkia Shkodër në kuadër të Kryeqytetit European të Rinisë 2022. U realizua cikli i trajnime për aftësitë e buta, organizuar nga Save the Children në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. Janë zhvilluar trajnime për sipërmarrjen, në kuadër të thirrjes për grante të organizatës Save the Children. U zhvilluan kurset pashkollore në 10 lëndë të ndryshme, organizuar nga YEA në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. U realizua cikli i trajnimeve mbi prindërimin pozitiv organizuar nga fshatrat SOS në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër. U realizua cikli i trajnimeve në kuadër të projektit për Children & Adolescent, i cili është duke punuar në fuqizimin e 14 grupeve të të rinjve IMPACT të cilët trajnohen në mënyrë periodike për të qenurit qytetar aktiv dhe rritur influenceën e tyre në komunitetet ku jetojnë. U zhvillua trajnimi për punonjësit e INSTAT.

Pranë qendrës rinore u zhvillua sesioni informues për Bursat nga Ambasada Amerikane, trajnime për “Nxitja e Perfshirjes Sociale dhe Zhvillimit të Komunitetit”, “Fuqizimi i të rinjve”, Edu Lab picture i cili u zhvillua gjate muajve të verës dhe “Dizenjimin e karrierës personale dhe zhvillimi i mentalitetit sipërmarrës” nga Save the Children. U zhvillua kampi veror “Bibliotech Champ në bashkëpunim me UNICEF Albania. U zhvillua trajnimi nga Eorld Vision “Të rinjtë dhe institucionet, zbatues të politikave rinore”, u zhvillua trajnimi “E folura në publik në bashkëpunim me Cartisin Dioqezan. U prezantua projekti zhvillimi i faqes ËEB të shkolles 9 vjecare "Ndre Mjeda", Shkoder. U zhvilluan kurset pas shkollore “Afterschool YEA”, konkursi YEA Aëards.

Qendra Rinore “Atelie” mbështeti “Idromeno Film Fest” dhe “Ekran i Artit film Festival”, mbështeti nismën rinore zhvillimin e një koncerti në tarracën e Qendrës Rinore “Atelie” si dhe xhirimin e video klipit të bandës “Blitz”. Të rinjtë e qendrës rinore organizuan në tarracën e qendrës koncertin “Familja” në kuadër të ditës ndërkombëtare të familjes. Gjatë verës pranë qendrës u zhvillua shkolla verore për muzik “Rrok Academy” si dhe kurset e organizuara nga të rinjtë për të rinjtë e qytetit “Edu Lab Filozofi” dhe kursi i kërcimit. Në kuadër të ditës së rinisë u zhvillua aktiviteti në Razëm “Efektet e ndryshimeve Klimatike” në bashkëpunim me Save the Children.

P10430.Q3.O1. A1. “Asnjë Fëmijë Jashtë”.

“Asnjë fëmijë jashtë” është një aktivitet social-kulturor që organizohet që nga viti 2005, me rastin e festave të fundvitit. Protagonistë të këtij aktiviteti janë fëmijët e familjeve në vështirësi social-ekonomike. Ky aktivitet përfshin të gjitha kategoritë e fëmijëve të familjeve në vështirësi të theksuara social-ekonomike, gjithashtu përfshin aktivisht PAK-të, fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian, fëmijët e ngujuar, fëmijë të institucioneve rezidenciale, fëmijë në situatë rruge duke përfshirë edhe fëmijë nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Fëmijët përgatiten dhe performojnë në fusha të ndryshme artistike si: muzikë, recitim, vegla muzikore, teatër, etj duke synuar gjithëpërfshirjen e fëmijëve në fusha të ndryshme të artit duke qenë vetë ata protagonistët. Mesazhi i kësaj nisme është që asnjë fëmijë nuk duhet të përjashtohet, por duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë.

P10430.Q3.O1. A2. Mbështetja e trupës muzikore të Personave me Aftësi të kufizuar.

Që nga viti 2005 në qytetin e Shkodrës zhvillon veprimtarinë e saj trupa muzikore The DOOR Albania, e vetmja në rajonin e Ballkanit. “Trupa muzikore e PAK-ve” përbëhet nga një grup të rinjsh me aftësi të kufizuara, të gjithë ish nxënës të shkollës speciale “3 Dhjetori”. Kjo trupë muzikore angazhohet në aktivitete të ndryshme që realizohen në territorin e bashkisë Shkodër, por jo vetëm. Kursi synon integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar të cilët janë shumë të aftë në veglat frymore dhe përmes angazhimit përcjellin mesazhin: Mundësi integrimi për të gjithë. Trupa Muzikore përbëhet nga 32 të rinj

me aftësi të kufizuar. Gjatë kësaj periudhe kjo bandë ka punuar dhe vazhduar provat dhe ka arritur të marrë pjesë dhe të performojë në aktivitete të ndryshme.

P10430.Q3.O1. A3. Shtëpi Familje për persona me aftësi të kufizuar nga Opera Madonnina del Grappa.

Opera Madonnina del Grappa, është një organizatë e licencuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK të braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1992 ku filloi aktivitetin e saj në mbështetje të personave dhe familjeve më në nevojë. Në vitin 1994 filloj rristurimin i plotë i ish spitalit psikiatrik të fëmijëve në Shkodër, duke sjellë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimit të fëmijëve, por në mënyrë të veçantë ky projekt realizoi krijimin për herë të parë në Shqipëri të Qendrës Ditore për fëmijët më aftësi të kufizuar dhe të krijimit të Shtëpisë Familje. Aktualisht në shtëpinë familje të Opera Madonnina del Grappa marrin shërbim 18 persona me aftësi të kufizuar. Qëllimi i kësaj strukture është rehabilitimi dhe përfshirja në jetën sociale e komunitare nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme me karakter edukativ e integruar duke ju ofruar përfituesve të saj shërbim rezidencial konform standarteve të miratuara nga Ministria e Linjës. Mbështetja e shtëpive – familje të “Opera Madonnina del Grappa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuara dhe përmbushjen e nevojave sipas rasteve specifike. Me qëllim sigurimin e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shoqata “Opera Madonnina del Grappa”, i është drejtuar vazhdimisht për mbështetje Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Shkodër me kërkesën për financim të shërbimeve, në mbështetje të ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Në përgjigje të këtyre kërkesave Bashkia Shkodër, i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me kërkesën për fonde për mbështetje të “Opera Madonnina del Grappa”, për fond për paga dhe sigurime shoqërore për punonjës, si kujdestar social dhe figura profesionale në fusha të ndryshme si: drejtor, ekonomist, psikolog, punonjës social, fizioterapist, infermier dhe kuzhinier, punëtor mirëmbajtës etj. Përveç pagesës për personelin, Bashkia Shkodër mbështet “Opera Madonnina del Grappa” duke mbuluar kuotën ushqimore për personat me aftësi të kufizuar të sistemuar pranë “Opera Madonnina del Grappa”, energjinë elektrike, ujë, gaz, karburant, shpenzime mjekësore etj. sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Shkodër dhe “Opera Madonnina del Grappa”.

P10430.Q3.O1. A4. Projekti “Shpresa” për personat e braktisur dhe me aftësi të kufizuar.

Projekti Shpresa, është një organizatë e licencuar që ofron shërbim të përkujdesit social të tipit shtëpi-familje, për PAK-të e braktisur nga familja dhe të deinstitutionalizuar. Kjo organizatë, është krijuar dhe vepron në qytetin e Shkodrës që prej vitit 1995. Projekti “Shpresa” ka 7 shtëpi-familje, të shpërndara në komunitet dhe aktualisht marrin shërbim 62 persona me aftësi të kufizuara. Projekti “Shpresa”, duke ofruar shërbime alternative për personat me aftësi të kufizuara, të cilët janë pa asnjë përkujdes dhe interesim familjar, dhe me problematika të ndryshme, ka nevojë për mbështetje financiare dhe vëmendje të shtetit. Mbështetja e projektit “Shpresa” është një domosdoshmëri, për të ofruar shërbimin sipas standarteve të përcaktuara në ligj për personat me aftësi të kufizuar dhe përmbushjen e nevojave sipas

rasteve specifike. Në këto qendra përfitojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, rehabilituese dhe shëndetësore 62 individë me aftësi të kufizuara.

P10430.Q3.O1.A5. Bashkëpunimi me Fondacionin “Shpresë për botën”, për përmirësimin e cilësisë së jetesës për personat që jetojnë në institucionet rezidenciale dhe familjet në nevojë.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit me organizatën “Shpresë për botën”, që ka si qëllim mbështetjen e 3 institucioneve rezidenciale; Shtëpisë së foshnjës, Shtëpisë së fëmijës shkollor dhe Qendrës së zhvillimit, është arritur që të përmirësohet cilësia e jetës së fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në institucionet rezidenciale, si dhe është rritur pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe sportive, me qëllim integrimin e tyre. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar festimet e ditëlindjeve për fëmijët në këto institucione rezidenciale. Vazhdon të ofrohet mbështetje me transport për të mundësuar takimet e fëmijët me prindërit biologjikë me qëllim mbajtjen dhe fuqizimin e lidhjeve afektive mes tyre. Këto aktivitete janë organizuar gjatë 4 muajve të vitit 2023 në të tre institucionet rezidenciale të Bashkisë Shkodër. Për disa fëmijë është mundësuar të realizohet takimi me familjet biologjike pranë banesave të tyre në qytete të tjera të Shqipërisë.

P010430.Q3.O2.A1. Pagesë PAK dhe Invaliditeti.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr.8626 datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar; Ligjit nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit” i ndryshuar, Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Statusi i invalidit” të ndryshuar.

Numri i personave të trajtuar me pagesë paaftësie ka qenë: në muajin Janar 3578, në Shkurt 3660, në Mars 3757, në Prill 3815, në Maj 3841, në Qershor 3910, në Korrik 3781, në Gusht 3830.

Numri i invalidëve të punës të trajtuar me shtesë kempit ka qenë: në muajin Janar 3056, në Shkurt 3138, në Mars 3144, në Prill 3143, në Maj 3064, në Qershor 3095, në Korrik 2838, në Gusht 2986.

Për kryerjen e këtyre pagesave mujore fondet e çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:
PAK: Janar-Shkurt 134 400 000 Lekë, Mars-Prill 134 252 000 Lekë, Maj-Qershor 131 140 000, Korrik-Gusht 130 700 000

Mbetet detyrimi i papaguar për muajin Dhjetor 2022 për mungesë fondi 4 545 226 lekë. Kjo diferencë është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2023.

P010430.Q3.O2.A2. Ndhimja ekonomike.

Në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr 597, datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Përfitues të skemës së ndihmës ekonomike kanë qenë:

Në muajin Janar - 1829 familje, nga të cilat: 1626 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 203 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Shkurt - 1863 familje, nga të cilat: 1658 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Mars - 1867 familje, nga të cilat: 1663 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 204 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Prill - 1872 familje, nga të cilat: 1666 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 206 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Maj - 1900 familje, nga të cilat: 1692 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 208 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Qershor - 1848 familje, nga të cilat: 1645 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 203 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Korrik - 1846 familje, nga të cilat: 1641 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Në muajin Gusht - 1833 familje, nga të cilat: 1628 familje janë trajtuar nga sistemi elektronik Kombëtar dhe 205 nga fondi i kushtëzuar i bllok ndihmës deri në 6%.

Duhet të theksojmë faktin se pagesa e muajit Dhjetor 2022, për familjet që trajtohen me fondin e kushtëzuar të bllok ndihmës deri në 6%, për 196 familje në vlerën 782 762 Lekë, është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2023.

Për kryerjen e këtyre pagesave fondet mujore të çelura nga Shërbimi Social Shtetëror janë si më poshtë:

Ndihma Ekonomike: Janar – Shkurt 27 100 000 Lekë, Mars-Prill 26 832 000 Lekë,

Maj-Qershor 28 525 000 Lekë, Korrik-Gusht 28 700 000 Lekë

Mbetet detyrimi i papaguar për muajin Dhjetor 2022 për mungesë fondi 965 286 lekë. Kjo diferencë është paguar me çeljen e fondeve të reja të viti kalendarik 2023.

P10430.Q4.O1.A1. Administrimi dhe funksionimi i çerdheve.

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjat që frekuentojnë këto çerdhe dhe gjithashtu familjet e tyre. Në bashkinë e Shkodrës, ofrojnë shërbim për foshnjat dhe familjet e tyre 6 çerdhe. Numri i foshnjeve që frekuentojnë këto çerdhe është 222.

1. “Shpenzime për paga e sigurime“

Fondi i planifikuar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe sigurime është **43,209 mijë lekë** është realizuar për 8 mujorin 2023 në vlerën **27,865 mijë lekë**.

2. “Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera“

Fondi i planifikuar për këtë zë është **11,241 mijë lekë** dhe realizimi i këtij artikulli paraqitet me vlerën **4,015 mijë lekë**.

Në zërin “**Materiale zyre dhe të përgjithshme**“, fondi i planifikuar është **100 mijë lekë** për blerje kancelarie parashikuar gjate vitit.

Në zërin “**Materiale për pastrim**“ fondi i planifikuar është **600 mijë lekë** është realizuar plotësisht. Blerje lënde djegëse gaz me vlerë **300 mijë lekë** për tu realizuar gjate vitit.

Në zërin “**Furnizime me ushqime**“ për 6 Çerdhe fondi i planifikuar është **7,000 mijë lekë**, është lidhur kontrata në muajin Mars, likuidimi i faturave bëhet në bazë të frekuentimit të fëmijëve në Çerdhe dhe fakti është **1,585 mijë lekë**. Nga periudha Janar-Mars është mbuluar me gjendjen e ushqimeve në magazinë nga kontrata e vitit 2022.

Në zërin “**Blerjeve të materialeve të tjera**” si batanije, çarcafë, enë kuzhine etj fondi i planifikuar është **195 mijë lekë** për tu realizuar gjate vitit.

Në zërin **“Shërbime nga të tretë”** fondi i parashikuar është **1,800 mijë lekë**. Kjo vlerë përdoret për likuidimin e faturave të energjise elektrike dhe ujit ku janë likuiduar faturat për 4 mujorin 2023 për energjinë elektrike në vlerën **730 mijë lekë** dhe furnizimi me ujë në vlerën **222 mijë lekë**. Për vlerën **46 mijë lekë** të parashikuar për internet është lidhur kontrata në Shkurt dhe fakti për 8 muaj në vlerën **23 mijë lekë**. **“Blerje e lëndëve djegëse”** dru zjarri fondi i parashikuar prej **300 mijë lekë** është realizuar.

Shërbimi **për dezinfektimin** e ambjenteve të Çerdheve është parashikuar në vlerën prej **40 mijë lekë**. Është realizuar për vlerën **32 mijë lekë**.

Në zërin **“Shpenzime Transporti”** fondi i parashikuar përfshin vlerën prej **200 mijë lekë** në të cilën përfshihen shpenzimet që janë për blerje karburanti parashikuar për tu realizuar gjatë vitit. Në zërin **“Mirëmbajtje e zakonshme ljerje me boje”** me vlerë 500 mijë lekë është realizuar në vlerën **443 mijë lekë**. **Mirëmbajtje e aparateve dhe paisjeve teknike** në vlerën prej **40 mijë lekë** është realizuar dhe **30 mijë lekë** për mirëmbajtje të paisjeve të zyrës përdoren për t’u realizuar sipas nevojës.

Në zërin **“Shpenzime për sigurimin e ndërtesave”** fondi i planifikuar është **40 mijë lekë** është realizuar.

3. **“Transferta Buxhetore për individë”** që akordohet për rastet e daljes në pension dhe raste fatkeqësish, realizimi në vlerën 30 mijë lekë.

4. Në zërin **“Investime”** fondi i planifikuar është **400 mijë lekë** për **Blerje paisje orendi** është realizuar në vlerën **344 mijë lekë**.

P10430.Q4.O1.A2. Rikonstruksioni i Çerdhes “Manush Alimani”.

Gjatë vitit 2020, Bashkia Shkodër ka vlerësuar dhe analizuar gjëndjen infrastrukurore të çerdheve në territorin e saj dhe ka lindur nevoja për rikonstruksionin e plotë të godinës së çerdhes ”Manush Alimani” për shkak të gjëndjes së saj të amortizuar.

Në bazë të verifikimeve që janë bërë ka rezultuar që kjo çerdhe ka nevojë të theksuar për rikonstruksion të plotë, pasi godina është në gjëndje shumë të amortizuar të dyshemesë, mureve, dyerve, tavanit dhe dritareve. Për vitin 2023 është planifikuar ndërhyrja infrastukurore pranë kësaj çerdheje. Është kryer procedura e prokurimit për projektimin e objektit “Rikonstruksioni i Çerdhes “Manush Alimani”.

P10430.Q4.O2.A3. “Subvencionimi për mbështetjen e shërbimit pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve në nevojë dhe fëmijët me aftësi të kufizuar”.

Subvencionimi për mbështetjen e shërbimit pa pagesë në çerdhe për fëmijët e familjeve me aftësi të kufizuar me fond 1,122 mijë lekë. Përdoret për rastet e familjeve në nevojë dhe fëmijëve me AK.

Programi 10661: Strehimi Social

Realizimi i qëllimit dhe objektivave të politikës së programit.

Qëllimi i I i programit të “Strehimi social”.

Q1. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Objektivi i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2023 është:

O1. Përmiresimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë

Qëllimi i II i programit të “Strehimi social”.


Q2. Administrimi i programeve të strehimit social.

Objektivi i programit buxhetor për përmbushjen e këtij qëllimi për vitin 2023 është:

O1. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm


Realizimi i Buxhetit të planifikuar
Programi “Strehimi social”.

| Programi 10661 | Paga+ sigurime | Shpenzime operative | Transferta | Investime | 000/leke |
|------------------------|-------------------|------------------------|------------|-----------|----------|
| | | | | | Totali |
| PBA 2023 | | 1,150 | 8,000 | | 9,150 |
| Plani fillestar 2023 | | 2,082 | 11,616 | 4 | 13,702 |
| Plani i rishikuar 2023 | | 2,082 | 9,644 | 4 | 11,730 |
| Realizimi viti 2023 | | 291 | 5,258 | | 5,549 |
| % e realizimit | 0% | 14.0% | 54.5% | 0.0% | 47.3% |



Realizimi i shpenzimeve korrente dhe kapitale për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin është në total 47.3 %, sipas zërave kryesorë më poshtë:

Shpenzimet korrente (paga+sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferime) **47.3%**
Shpenzimet kapitale **0 %**



Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e fondeve të planifikuara.

Një arsye e mosrealizimit të fondeve të planifikuara është vonesa e kthim pergjigjes shkresore e Ministrise se Financave dhe Ekonomisë, nepermjet komunikimit edhe me poste elektronike si dhe depozitimi i vonuar i nr. të llogarive bankare të qiradhënësve, nepermjet te cileve kalon subvencioni i qerases. Lëvrimi i fondit është kryer në muajin maj 2023.

Realizimi i treguesve të performancës:

Aneksi nr.4 Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit

Periudha e Raportimit: 8 Mujori 2023

| Kodi i Programit | 10661 | Emertimi i programit: | Strehimi social | | | | | | Komente |
|-----------------------------|---|--|---|----------------------------------|--------------------------------------|------------------------------------|---|---|---------|
| Qëllimi 1 | Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. | | | | | | | | |
| | | | **Treguesit e performancës/Produktet: | | | | | | |
| | *Objektivat e politikës*: | Kodi i Treguesit te Performances/Produktit | Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit | Niveli faktik i vitit paraardhës | Niveli i planifikuar ne vitin korent | Niveli i rishikuar ne vitin korent | Niveli i faktik ne fund te vitit korent | % e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit | |
| <i>Objektivi Specifik 1</i> | O1.Përmirësimi i kushteve të banimit për shtresat në nevojë | | | | | | | | |
| | | 1 | Numri personave të mbështetur me strehim social sipas kategorive | 125 | 500 | 500 | 137 | 27% | |
| | | 2 | Numri I njesive të banimit pranë banesave sociale funksionale si pjesë e fondit të banesave sociale me qira të bashkisë | 79 | 120 | 79 | 79 | 100% | |
| | | 3 | Rritja e të ardhurave nga shërbimi i banesave sociale të bashkisë: Të ardhurat nga qeraja e banesave | 98 | 200 | 150 | 150 | 100% | |

| | | | | | | | | | |
|---------------------------------|---|----|---|-----|-----|-----|----|------|--|
| | | | sociale | | | | | | |
| | | 4 | Numri i individëve/familjeve që përfitojnë banesa sociale me qira | 69 | 79 | 79 | 74 | 94% | |
| | | 5 | Numri i aplikimeve pranë qeverisë dhe donatorëve për programet sociale të strehimit në vit, | 1 | 6 | 3 | 1 | 33% | |
| | | 6 | Nr i zonave të vlerësuara për zhvillim dhe pajisje me infrastrukturë me qëllim strehimin; | 0 | 2 | 4 | 4 | 100% | |
| | | 7 | Numri i aplikimeve për permiresimin e kushteve të banesave ekzistuese; | 2 | 7 | 7 | 1 | 14% | |
| <i>Objektivi Specifik 2</i> | O2. Vlerësimi, planifikimi dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme të banimit, për individët dhe familjet në nevojë, përmes ofrimit të alternativave për njëstrehim të gatshëm, të arritshëm, të përballueshëm dhe të përshtatshëm | | | | | | | | |
| | | 8 | Numri i aplikimeve për subvencionim qiraje | 70 | 55 | 55 | 19 | 35% | |
| | | 9 | Numri i familjeve që përfitojnë bonus strehimi, | 54 | 65 | 65 | 61 | 94% | |
| | | 10 | Numri i aplikimeve për subvencionimin e interesave të kredisë | 147 | 100 | 100 | 36 | 36% | |
| | | 11 | Numri i familjeve përfituese nga subvencionimi i interesave të kredive nga shteti për familjet në nevojë (kredi të buta për shtëpi) | 0 | 40 | 40 | 0 | 0% | |

| | | | | | | | | | |
|--|--|----|---|----|----|----|---|-----|--|
| | | 12 | Numri i aplikimeve për banesa sociale me qira | 36 | 78 | 78 | 9 | 12% | |
|--|--|----|---|----|----|----|---|-----|--|

Realizimi i produkteve:

ANEKSI nr.3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit"

| | | | |
|---------------|-----------------|------------------|-------|
| Emri i Grupit | Bashkia Shkodër | Kodi i Grupit | 141 |
| Programi | Strehimi Social | Kodi i Programit | 10661 |

| Kodi | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (sipas vitit 2022) | Shpenzi met (sipas vitit 2022) | I | | II | | III | | IV | | Luhatjet në Koston për Njësi | | | Komente | | |
|------|--|---------------------------------|----------------------------------|--------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|--|--|--|--|--|---------------------------|---------------------------------|-------------------------------------|------------|---------|-------------|--------------|
| | | | | | Kosto për Njësi (sipas vitit 2022) | Sasia (sipas planit të vitit 2023) | Shpenzi met (sipas planit të vitit 2023) | Kosto për Njësi (sipas planit të vitit 2023) | Sasia (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Shpenzi met (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Kosto per Njësi (sipas planit të rishikuar vitit 2023) | Sasia Faktike (viti 2023) | Shpenzi met Faktike (viti 2023) | Kosto për Njësi Faktike (viti 2023) | V = IV - I | | V = IV - II | V = IV - III |
| 1 | Persona të mbështetur me strehim social në banesa sociale me qira | numri i familjeve | 69 | 985 | 14.3 | 160 | 1,150 | 7.2 | 79 | 1,467 | 18.6 | 74 | 291 | 3.9 | -10.3 | -3.3 | -14.6 | |
| 2 | Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara | numër projektesh | 1 | 0 | 0.0 | 6 | | 0.0 | 3 | | 0.0 | 1 | | 0.0 | 0.0 | 0.0 | | |
| 3 | Persona të mbështetur me subvencionim qiraje në tregun e lire dhe perfitues të subvencionimit të interesave të kredisë për banesa me kosto të ulët | numri i personave që përfitojnë | 54 | 8,655 | 160.3 | 65 | 8,000 | 123.1 | 65 | 8,581 | 132.0 | 61 | 5,258 | 86.2 | -74.1 | -36.9 | -45.8 | |
| 4 | Rikonstruksion i godinave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social | numri i banesave sociale | 28 | 15,385 | 549.5 | | | | | | | | | | -549.5 | 0.0 | 0.0 | |

Për vitin 2023 në Programin “**Strehimi social**”, në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara, janë parashikuar këto aktivitete.

| Produktet | Aktivitete/Projekte | Institucion i | Statusi I Aktiviteteve | Plani fillestar 2023 | Plani i rishikuar 2023 | Realizimi 8M 2023 |
|--|--|-----------------|------------------------|----------------------|------------------------|-------------------|
| | | | | Totali | Totali | Totali |
| Persona të mbështetur me strehim social në banesa sociale me qira (në numër) | P10661.Q1.O1.A1 Administrimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 1,150 | 1,467 | 291 |
| Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara (në numër) | P10661.Q1.O1.A2 Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | - | - | - |
| Persona të mbështetur me subvencionim qiraje në tregun e lire dhe perfitues të subvencionimit të interesave të kredisë për banesa me kosto të ulët (në numër) | P10661.Q2.O1.A1 Zbatimi i programeve të strehimit social & të trashëguara | Bashkia Shkodër | Në proces realizimi | 8,000 | 8,581 | 5,258 |
| | 10661 Strehimi social | | | 9,150 | 10,048 | 5,549 |
| | Te trashëguara | | | 4,552 | 1,682 | - |
| | Totali | | | 13,702 | 11,730 | 5,549 |

P10661.Q1.O1.A1 Administrimi i banesave sociale me qira si pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë & të trashëguara

Fondi publik i banesave sociale me qira në pronësi të Bashkisë Shkodër përbëhet nga dy godina të dala jashtë funksionit dhe të përshtatura për strehim social, si dhe ndërtime të reja me kontejner, të cilët, aktualisht janë funksionale.

Bashkia Shkodër administron tre Banesa Sociale me Qira, pjesë e fondit publik të banesave sociale me qira në pronësi të bashkisë, të cilat, kanë 79 njësi banimi në total, ku përfitojnë rreth 76 familje të sistemuara pranë këtyre banesave sociale.

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. 2691 prot., datë 07.03.2016 që Bashkia Shkodër ka lidhur me Ministrinë e Zhvillimit Urban është realizuar rikonstrukcioni i ish- konviktit të shkollës Pyjore, me qëllim përshtatjen në banesa sociale me qira për strehimin e jetimëve që kanë dalë nga institucionet e përkujdesit shoqëror dhe aktualisht jetojnë në konviktet e qytetit, si dhe familjeve njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë dhe ndodhen në situatë të vështirë social-ekonomike.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 26, datë 10.05.2022 “Për disa shtesa në VKB-në nr. 49, datë 30.10.2020 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6” (pranë ish-konviktit të shkollës Pyjore) janë miratuar listat e përfituesve që kanë nënshkruar kontrata qiraje 1-vjeçare.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër”, është miratuar lista shtesë me 2 (dy) familje përfituese.

Përfituesit pranë këtyre banesave përfitojnë edhe shërbime integruese dhe zhvilluese, me qëllim fuqizimin social-ekonomik, shërbime që ofrohen nga Qendra Komunitare “Për Familjen” nr. 6. Janë rreth 24 njësi banimi me qira ku përfitojnë rreth 24 individë/familje, mes të cilave një familje në kushtet e nevojës emergjente për strehim, miratuar me VKB nr. 60, datë 07.11.2022.

Ka përfunduar projekti i strehimit social “Rikonstrukcion i godinave në pronësi të njësisve të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontejner 1+1 dhe 2+1)”, që synon përmirësimin e kushteve të banimit të minoritetit kombëtar Rom për 27 familje të këtij minoriteti në Bashkinë Shkodër.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 29, datë 03.06.2021 “Për miratimin e listës përfundimtare të përfituesve për programin e banesave sociale të ngritura për komunitetin Rom dhe për miratimin e “Rregullores së administrimit të banesave sociale me qira të ngritura për komunitetin Rom”, është miratuar lista e përfituesve dhe kanë nënshkruar kontratat e qirasë me afat 1-vjeçar.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër”, është miratuar lista shtesë me 3 (tre) familje përfituese.

Aktualisht, janë sistemuar pranë këtyre godinave sociale 26 familje përfituese.

Ka përfunduar projekti i adaptimit të ish-konviktit të shkollës Veterinare në banesa sociale.

Bashkia Shkodër ka aplikuar për programin social të strehimit “Banesa sociale me qira“, adaptim i objektit ekzistues, sepse objekti kishte nevojë emergjente për rikonstrukcion. Nga ky projekt, janë rikonstruktuar 28 banesa sociale. Ky projekt është miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëfinancim me Bashkinë Shkodër.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 24, datë 10.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve pranë banesave sociale me qira tek ish-konvikti i shkollës Veterinare dhe të “Rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër”, është miratuar lista e përfituesve dhe kanë nënshkruar kontratat e qirasë me afat 1-vjeçar.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 20.2.2023 “Për miratimin e listës shtesë të përfituesve pranë banesave sociale me qira, të administruara nga Bashkia Shkodër”, është miratuar lista shtesë me 2 (dy) familje përfituese.

Aktualisht, janë sistemuar 26 familje pranë këtyre banesave sociale.

Është paraqitur për miratim në Këshillin Bashkiak Shkodër projekt-vendimi “Për miratimin e masës së qirasë mujore për Banerat Sociale me Qira, në administrimin e Bashkisë Shkodër”, me nr. 4146 prot., date 23.3.2023, i cili, për mungesë kuorumi të numrit të këshilltarëve nuk është miratuar ende. Niveli i qirasë për BSQ miratohet çdo vit dhe është i vlefshëm deri më 31 janar të vitit pasardhës.

Me vendime të Këshillit Bashkiak janë miratuar Rregulloret përkatëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër, për zbatimin dhe funksionimin e këtyre programeve sociale të strehimit, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet përfituesve dhe strukturës përgjegjëse administruese.

P10661.Q1.O1.A2 Projekte që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komuniteteve të pafavorizuara të financuara nga buxheti i shtetit

Programet sociale të strehimit janë programe, të cilat kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballoshëm për individët dhe familjet që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave.

Bashkia Shkodër prej disa vitesh, po zbaton projekte me synim rritjen e fondit të banesave sociale për familjet dhe individët më në nevojë, duke rikonstruktuar dhe vënë në përdorim objekte publike, pronë të Bashkisë Shkodër, si në ish-konviktin e shkollës Pyjore dhe në ish- konviktin e shkollës Veterinare.

Projekti parashikohet të realizohet në një godinë ekzistuese, e cila është rikonstruktuar dhe përshtatur në banesë sociale si rezultat i financimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pas aplikimit e në bashkëfinancim me Bashkinë Shkodër në vitin 2020. Aktualisht janë ndërtuar 28 njësi banimi, pjesë e fondit publik të banesave sociale në pronësi të Bashkisë.

Projekti shtesë i një kati, në një godinë publike dhe funksionale, do të rriste më tej efektivitetin e godinës, duke rritur numrin e njësisve të banimit dhe numrin e individëve dhe familjeve përfituese që nuk mund të sigurojnë strehim të përshtatshëm dhe të përballoshëm.

Aktualisht, janë sistemuar 26 familje përfituese, të cilët përfitojnë strehim të përshtatshëm brenda standardeve të përcaktuara.

Nga vlerësimet e specialistëve, rezulton se në këtë objekt është e mundur të realizohet një shtesë kati dhe të përfitohen edhe 14 njësi banimi të tjera, duke e kthyer këtë godinë në një pallat me 42 apartamente e duke shtuar me tej kontigjentin e banesave sociale me qira në Bashkinë Shkodër.

Në zbatim të shkresës me nr. 23964 prot, datë 28.12.2022 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Mbi fondet për programet e strehimit social për vitin 2023“, lidhja nr. 1, për të përfituar nga fondet për programet e strehimit të shpallura nga Ministria e Financave, kërkohet ndër të tjera “Deklaratë për bashkëfinancimin, miratuar parimisht me Vendim të Këshillit Bashkiak, e shprehur në përqindje sipas Udhëzimit nr. 31 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Me VKB nr. 11, datë 31.1.2023 është miratuar në parim bashkëfinancimi në zbatim të fondeve të planifikuara për programet e strehimit social për vitin 2023, për realizimin e një kati shtesë në objektin: Banesa sociale me qira (ish-konvikti i shkollës Veterinare) dhe me shkresën nr. 1420 prot., datë

30.1.2023, kemi aplikuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2023”.

P10661.Q2.O1.A1 Zbatimi i programeve të strehimit social & të trashëguara

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, Bashkia Shkodër po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

“Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë” si një instrument financiar i programit social të strehimit “Banesa sociale me qira”, mbështet individë/familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë. Subvencionimi i qirasë realizohet nga Bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg. Masa e subvencionit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes. Subvencioni mund të mbulojë deri në 100 për qind të qirasë sociale, për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe ato që janë në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, pavarësisht nëse nuk e kanë përfituar atë dhe që strehohen në banesa sociale me qira.

Për këtë instrument financiar, në zbatim të programit të banesave sociale me qira, aplikimet kanë qenë të hapura deri në muajin nëntor 2022.

Lista e aplikuesve në këtë program social të strehimit i është përcjellë në nëntor të 2022, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me kërkesën për parashikimin e fondeve për financim për vitin 2023, sipas nenit 35, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, dhe sipas Shtojca A “Formati i aplikimit për fonde nga buxheti i shtetit, kriteret përkatëse dhe informacioni për kategoritë, numrin e aplikimeve dhe planifikimin e fondeve nga NJVV”.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 12, datë 31.01.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë, për vitin 2023”, është miratuar lista me 61 individë/familje përfituese.

Në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, përfituesit dorëzojnë kontratën e qirasë brenda afateve kohore ligjore pas miratimit të listës së përfituesve nga Komisioni i Strehimit për të përcaktuar dhe vlerën e subvencionimit të qirasë.

Llogaritja e vlerës së subvencionimit të qirasë bazohet në VKM nr. 362, datë 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, shtojca “A”, dhe realizohet në varësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës mesatare të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB.

Vlerat konkrete të subvencionimit të qirasë për çdo përfitues, përcaktohen sipas kontratave të qirasë, të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas shtojcës “A” të VKM-së 362, datë 20.05.2019.

Referuar Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave “*Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (mijë lekë) financohen deri në 80% nga buxheti i shtetit.*”

Sa më sipër, Bashkia Shkodër bashkëfinancon për këtë instrument financiar të strehimit jo më pak se 20% të vlerës totale të subvencionimit të qirasë në treg të lirë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 4091/1 prot., datë 7.3.2023 me lëndë: Miratim transferim fondesh për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për vitin 2023, ka transferuar për llogari të Bashkisë Shkodër për subvencionim të qirasë fondin buxhetor me vlerë 4,027,601 lekë.

Bashkia Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, VKM-së nr. 384, datë 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKB nr. 12, datë 31.1.2023 “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë, për vitin 2023”, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara, kryen procedurën e likuidimit të subvencionimit të qirasë së pronarit social.

Meqënëse fondi i transferuar/akorduar nga buxheti i shtetit ka qënë i pamjaftueshëm , në mënyrë që të realizohet e plotë procedura e likuidimit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë, për vitin 2023, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të parashikuara në funksion të pronarit social dhe individëve/familjeve përfituese, të cilët, kanë depozituar kontratat e qirasë të kërkuara në zbatim të detyrimeve ligjore është kërkuar mbështetje financiare me shkresat 6804 datë 15.05.2023 dhe 6804/1 datë 05.06.2023 .

Aktualisht Bashkia Shkodër ka konsumuar fondin e akorduar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë në shumë 4 027 601 leke dhe për këtë arsye ieshte ridërguar kërkesa me nr.11206 prot dt. 9.8.2023 për shtesë fondi për mbulimin e subvencionit të qirasë për pjesën që mbulohet nga buxheti I shtetit për periudhën në vazhdim deri me mbylljen e e vitit buxhetor 2023 .

“Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti”, është një instrument financiar në zbatim e mbështetje të programit social të strehimit “Banesa me kosto të ulët”.

Familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtë të përfitojnë kredi me kushte lehtësuese që jepet në formën e subvencionimit të interesave të kredisë për ato familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesat e kredisë të ofruara nga institucionet financiare për blerjen e një banese me vlerë jo më të madhe se mesatarja e vlerave të tregut në Njësinë e Vetëqeverisjes Vendore dhe me sipërfaqe jo më të madhe se normat e strehimit të përcaktuara.

Në zbatim të VKM nr. 384, datë 12.6.2019 ndiqen procedurat e parashikuara për zbatimin e programeve sociale të strehimit. Informacioni në lidhje me programet sociale të strehimit në zbatim është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë si dhe janë shfrytëzuar mediat lokale për promovimin dhe shpërndarjen e këtij informacioni sa më shumë tek qytetarët. Gjithashtu, specialisti i strehimit pranë Bashkisë ka qënë i gatshëm për ofrimin e informacionit dhe mbështetjes së nevojshme për qytetarët, ku çdo ditë pranë Zyrës me Një Ndalesë, janë bërë aplikime nga qytetarët. Janë miratuar nga me vendim të Këshillit Bashkiak çdo vit sistemet e pikëzimit për programet sociale të strehimit që zbatohen nga Bashkia Shkodër.

Kuotat e vëna në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për këtë instrument financiar për vitin 2020, janë 100.

Gjatë tre viteve të zbatimit të këtij instrumenti financiar, janë miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak tre lista përfituesish. Listat e përfituesve, sipas marrëveshjes trepalëshe ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bashkisë Shkodër dhe tre institucioneve financiare/bankave (BKT, Intesa Sanpaolo dhe Raiffeisen Bank), në zbatim të procedurave ligjore u janë dërguar për zbatim institucioneve financiare dhe Entit Kombëtar të Banesave, Drejtoria Rajonale Shkodër.

Deri tani ka disa përfitues të kredituar nga bankat dhe disa përfitues në proces të kreditimit. Ndërsa disa përfitues të Listës së fundit rezervë të miratuar nga Bashkia kanë paraqitur kërkesë për shtyrje afati në

zbatim të dispozitave ligjore dhe u janë dërguar institucioneve financiare për t'u trajtuar dhe për të lidhur kontratat e kredisë.

Meqënëse Bashkia Shkodër kishte në dispozicion 100 kuota të miratuara, dhe këto kuota nuk janë plotësuar akoma edhe pse janë miratuar tre lista përfituesish nga Bashkia Shkodër, pas rakordimit me bankat zbatuese, në lidhje me kuotat në dispozicion për vitin aktual, **Bashkia ka shpallur përsëri Thirrje.**

Bashkia Shkodër ka shpallur në faqen zyrtare ëeb të internetit njoftimin me listën e aplikuesve për instrumentin financiar “Subvencionimi i interesave të kredisë, të lehtësuara nga shteti” dhe ka vijuar me procedurën e njoftimit shkresor për të gjithë aplikuesit, për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit pranë sporteleve të Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë.

Pas plotësimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga qytetarët/aplikuesit, vijon procedura e shqyrtimit, vlerësimit, pikëzimit dhe miratimit të dokumentacionit me listën e përfituesve, e cila dërgohet për miratim pranë Komisionit të Strehimit dhe me vendim të Këshillit Bashkiak, shpallet lista e përfituesve.

Procedura vijon të jetë në proces tashmë duke iu referuar ndryshimeve të reja që ka pësuar Ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; ligjit nr. 22/2018

“Për Strehimin Social”, i ndryshuar, VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM-së nr. 268, datë 29.4.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave tëkredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, mekredi të lehtësuara nga shteti”, në fillim të muajit Korrik Bashkia Shkodër bën

“Njoftim për shpallje në faqen web për aplikime për të përfituar nga programet sociale të strehimit që zbaton Bashkia Shkodër”, programe që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

Aplikimet kryhen në mënyrë manuale pasi Sistemi online i Strehimit nuk është në proces funksionimi, çdo ditë të premte të javës, nga ora 09.00-12.00, pranë sporteleve të Zyrës me Një Ndalesë të Bashkisë Shkodër dhe janë të hapura deri në muajin nëntor.